

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI

“AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”

BASHKIA TEPELENË

TIRANË, KORRIK 2022

PËRMBAJTJA:

Nr.	Titulli	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-9
I.a	Përshkrim i shkurtër i Projektraportit të Auditimit	3-3
I.b	Përmbledhje e gjetjeve kryesore	3-5
I.c	Opinionit i auditimit	5-9
II	HYRJA	9-14
II.1	Titulli, Marrësi	9-9
II.2	Objektivat dhe qëllimi	9-9
II.3	Identifikimi i çështjes	9-10
II.4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10-10
II.5	Përgjegjësitë e audituesve	10-11
II.6	Kriteret e vlerësimit	11-12
II.7	Standardet e auditimit	12-13
II.8	Metodat e auditimit	13-14
II.9	Dokumentimi i auditimit	14-14
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14-82
III.1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	14-15
III.2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejttimeve të auditimit	15-82
III.2.1	Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.	15-27
III.2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHö, i ndryshuar; ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2020 dhe 2021, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.	27-45
III.2.3	<u>Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare të vitit 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshmeë i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022.</u>	45-52
III.2.4	Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 për Prokurimin Publikë i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 162/2020 për prokurimin publikë dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publikë.	52-78
III.2.5	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.	79-82
III.2.6	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.	83-85
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	85-98
V	ANEKSE	98-121

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Përshkrim i shkurtër i Projektraportit të Auditimit:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òMbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Tepelenë, në bazë të Programit të Auditimit, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 261/1, datë 09.03.2022, me ndryshime, me afat auditimi deri në datën 13.05.2022, për auditimin financiar dhe të përputhshmërisën Bashkinë Tepelenë. Projektraporti i Auditimit u hartua bazuar në Letrat e punës, Akt Konstatimet, Akt Verifikimet, vërejtjet e bëra nga subjekti òBashkia Tepelenë, etj., sipas drejtimeve të auditimit të përcaktuara në Programin e Auditimit. Projekt Raporti i Auditimit u dërgua në subjekt me shkresën nr. 261/6, datë 06.07.2022, si dhe është konfirmuar njohja dhe janë dërguar objeksionet nga subjekti i audituar, me shkresat përcjellëse nr. 261/7 datë 15.07.2022 dhe 261/8, datë 18.07.2022.

I.b. Përmbledhje e gjetjeve kryesore:

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në RPA	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi mbi shlyerjen e detyrimeve që subjektet e tregtimit të naftës kanë kundrejt Bashkisë Tepelenë rezultoi sedhe pas angazhimit të Bashkisë Tepelenë me lidhjen e akt marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve, nga posedimi i licencën për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, 6 subjekte nuk kanë likuiduar detyrimin e plotë sipas tarifave në vlerën 3,930,000 lekë të cilat janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave Vendore, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj ò i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa òbò, dhe pika 10, i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa òbò dhe pika 9, si dhe pika 15.2, të këtij akti normativ.	Pika III.2.2 Faqe 27-45	E lartë	Bashkia Tepelenë të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej 3,930,000 lekë , për 6 subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pajisur me autorizim/licencë, për tregtimin e karburanteve kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr.970, datë 02.12.2015 ndryshuar me VKM nr.344 datë 19.04.2017.
2	Nga auditimi rezultoi se, Drejtoria e Taksave të të Ardhurave Vendore Bashkia Tepelenë, nuk ka vepruar, për të arkëtuar tarifën e pastrimit, të ndriçimit dhe tarifën e gjelbërimit për 9 nga 11 subjektet e ndërtimit, të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues, në procedurat e prokurimit me fonde publike, për periudhën e auditimit 2020-2021 sipas paketës fiskale të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.88 datë 28.12.2019, Vendimin nr.74 datë 28.12.2018 òPër Miratimin e Paketës Fiskale	Pika III.2.2 Faqe 27-45	E lartë	Bashkia Tepelenë të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej 984,000 lekë , referuar kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues, për subjektet e ndërtimit, të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike, për periudhën 2020-2021 dhe që nuk janë ngarkuar me detyrimet për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.88 datë 28.12.2019 dhe Vendimit nr.74

	Vendoreö,Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit përkatës nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar 43.1. Këto 9 subjekte si në aneksin II.2.2.3.4 bashkëlidhur këtij projekt raporti, janë debitorë në vlerën 984,000 lekë , gjë që ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Tepelenë.			datë 28.12.2018 òPër Miratimin e taksave dhe Tarifave Vendoreö.
3	Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave të dhënies me qira të aseteve, ka rezultuar se në disa rastenuk janë zbatuar kushtet e kontratës që përcakton mënyrën, kohën e pagesës së qirasë, si dhe pasojat kur shkelin detyrimet e përcaktuar në kontratë, për mos shlyerjen në kohë të qirasë, si dhe nuk është aplikuar sanksion për ndërprerjen e njëanshme të saj në rastet e parashikuar nga kontrata konkrete, veprime të cilat kanë sjellë të ardhura të munguara të pamatshme në buxhetin e bashkisë. -Në disa kontrata nuk është zbatuar penaliteti i parashikuar në kontratë për kamatë vonesën në rastet kur qiramarrësi nuk likuidon në kohë detyrimin, nga 0.01% në ditë, por jo më shumë se 10% e vlerës së detyrimit përkatës. -Nga Bashkia Tepelenë nuk është zbatuar neni 13.2, për zgjidhjen e njëanshme të kontratës, pasi rezulton se 8 subjekte sipas tabelës anekse II.2.2.3.5 bashkëlidhur këtij projekt raporti, nuk kanë derdhur në arkën e bashkisë, detyrimin e qerasë vjetore, siç është parashikuar në nenin 5, pika 5.1 të kontratës së lidhur me Bashkinë Tepelenë nga momenti i lindjes së detyrimit dhe deri në 31.12.2021 vlerën prej 394,372 lekë , e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, (prej të cilave 358,520 lekë detyrim qira, dhe35,852 lekë kamatë vonesë).	Pika III.2.2 Faqe 27-45	E lartë	Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për zbatimin e të gjitha procedurave me qëllim arkëtimin e detyrimit prej 394,372 lekë , nga subjektet debitorë, të cilësuar si detyrimeve kontraktore të shfrytëzimit me qira të aseteve të bashkisë.
4	Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Tepelenë në cilësinë e palës qiradhënëse të aseteve në pronësi të saj, nuk ka miratuar programe pune për monitorim nga njësia e inspektimit në terren, lidhur me zbatimin e termave kontraktore si: mbjelljet e kulturave sipas llojit të përcaktuar në planet e biznesit dhe respektimit të afatit kohor të mbjelljeve, shoqëruar me kontrollin e shlyerjes së detyrimeve financiare për secilën kontratë. Gjithashtu, Bashkia Tepelenë nuk ka aplikuar në asnjë nga rastet e 31 kontratave efektive penalitetet e mos respektimit të termave kontraktor, si dhe nuk ka dërguar asnjë njoftim të zgjidhjes së njëanshme të kontratës së qiradhënies së aseteve në	Pika III.2.2 Faqe 27-45	E lartë	Kryetari i Bashkisë Tepelenë të marrë masa për të miratuar programe pune për kryerjen e monitorimeve nga njësia e inspektimit në terren lidhur me zbatimin e termave kontraktor si: mbjelljet e kulturave sipas llojit të përcaktuar në planet e biznesit dhe respektimit të afatit kohorë të mbjelljeve shoqëruar me kontrollin e shlyerjes së detyrimeve financiare për secilën kontratë. -Bashkia Tepelenë në rastet e dhënies me qira të aseteve të aplikoj në kontratë në mënyrë eksplicite penalitetet e mos respektimit të termave kontaktor nga palët. -Në rastet e mos respektimit të termave kontraktual, Bashkia Tepelenë të

	pronësi të saj.			dërgojë njoftim të zgjidhjes së njëanshme të kontratës së qiradhënies së aseteve në pronësi të saj.
5	Nga auditimi i procedurave të prokurimit, të zhvilluara në vitin 2020, mbi sigurimin e oponencës teknike, për objektet e përcaktuara në Ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 6, dhe VKM nr.1055, datë 22.12.2010 "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit", pika 3, ka rezultuar se për procedurën, me objekt òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonatò dhe òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmbjan, Bashkia Tepelenë, me vlerë kontrate 105,375,894 lekë pa TVSH, oponenca teknike e kërkuar nga AK, në cilësinë e investitorit, me shkresën nr. 2979, datë 29.12.2020 dhe e realizuar nga Instituti i Ndërtimit bazuar në Aktmarrëveshjen nr. 2033/1, datë 23.12.2020, nuk është kryer në kohën e duhur dhe në funksion të asaj ç'ka kërkon ligji dhe VKM. Kërkesa për marrjen e këtij shërbimi nga Bashkia Tepelenë, është përtej afateve kohore, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve, në masën e pagesës së këtij shërbimi.	Pika III.2.4 Faqe 52-78	E lartë	Titullari i Bashkisë, të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësi, si dhe me qëllim shmangien e rasteve të tilla, të marrë masa për hartimin e gjurmës së auditimit/hartës së proceseve, për òPërcaktimin dhe miratimin e procedurave mbi marrjen e oponencave teknikeò për objektet që do të ndërtohen në vazhdimësi, ku të përcaktohen qartë, strukturat përgjegjëse, grupet apo specialistët përkatës që do të kryejnë këtë proces, si dhe të përcaktohen qartë periudha kohore mbi kërkesën dhe marrjen e këtij shërbimi, nga të tretët.
6	Nga auditimi mbi vlerësimin e ofertave ka rezultuar se në 3 procedura prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) ka kualifikuar, Operatorët Ekonomikë (OE), të cilët kanë paraqitur ofertë ekonomike anomalisht të ulët. KVO, nuk e ka identifikuar këtë fakt, nuk ka kërkuar sqarime nga OE, si dhe nuk ka lënë gjurmë në procesverbalin përkatës, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 285/2021, nenin 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 4.	Pika III.2.4 Faqe 52-78	E mesme	Titullari i Autoriteti Kontraktor, të marrë masa që gjatë zbatimit të këtyre kontratave, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, të ndjekë me rigozitet zbatimin e tyre, me qëllim shmangien e problematikave eventuale si në zbatimin e afateve, po ashtu dhe të cilësisë së punimeve.

I.c. Opinioni i auditimit.

Në përfundim të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, të ushtruar në Bashkinë Tepelenë, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 21.12.2021, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 261/1, datë 09.03.2022, me ndryshime, Grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se, përse i përket përputhshmërisë subjekti i audituar përgjithësisht **ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore**, të cilat kanë shërbyer si kritere vlerësimi, të fushave të audituara si: prokurimet publike, menaxhimi urban, realizimi i të ardhurave dhe menaxhimi i buxhetit, menaxhimi i aktiveve, etj, me përjashtim të disa mangësive të cilat janë materiale, por jo të përhapura. Po ashtu edhe përse i përket auditimit financiar, nga ana e subjektit të audituar, përgjithësisht janë zbatuar në mënyrën e duhur udhëzimet për mbylljen e pasqyrave financiare, pasqyra financiare e vitit 2021, paraqet në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Bashkisë Tepelenë më 31.12.2021, me përjashtim të disa

rasteve të cilat janë përshkruar në bazën për opinionin, pasi kanë rezultuar materiale, por jo të përhapura.

Opinionin i auditimit

Mbi auditimin financiar:

Për drejtimin e Bashkisë Tepelenë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Tepelenë, për vitin ushtrimor 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të Pasqyrave Financiare.

Opinionin me rezervë (ISA-705/ISSAI-2705)¹

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e 6 Bazës për Opinionin me rezervë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të shoqërisë më 31 dhjetor 2021, referuar Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin me rezervë:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA-700/ISSAI-2700)². Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Tepelenë, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar Bashkia Tepelenë, përveç rasteve të përshkruara më poshtë, ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit, shkeljet e evidentuara janë materiale, por jo të përhapura.

Përshkrimi i çështjeve:

Nga auditimit rezultoi se, objektet inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 391,047,353 lekë, objektet nuk janë pajisur me titull pronësie, nuk janë regjistruar në hipotekë, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë:

llog. 210 òToka troje terreneo, 9 elementë në vlerën neto 74,573,778 lekë

llog. 211 òPyje plantacioneo, 2 elementë në vlerën neto 196,200 lekë,

llog. 212 òNdërtesa e konstruksioneo, 77 objekte me vlerën neto 316,277,375 lekë

llog. 213 òRrugë, rrjete, vepra ujoreo, 85 objekte me vlerë neto 727,482,471 lekë

Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në

¹ISA 705, "Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur"; *Llojet e Opinioneve të Modifikuara, sipas "Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, faqe 84*

²ISA 700, "Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur"

inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

Aktivet Afatgjata Financiare me llogarinë 26 ÷Pjesëmarrje në kapitalin e vetë, paraqitet në vlerën zero në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të viteve 2019 dhe 2020 edhe pse Bashkia Tepelenë zotëron 100% aksione në pjesëmarrje në ÷Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë SHA, me vlerë 510,086,359 lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Tepelenë:

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Tepelenë, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf i drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme³ për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Opinionit i auditimit mbi përputhshmërinë:

Për drejtimin e Bashkisë Tepelenë:

Ne kemi audituar veprimtarinë e Bashkisë Tepelenë, në lidhje me zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore (kriteret e vlerësimit), për procedurat e prokurimit publik të zhvilluara, si dhe zbatimin e kontratave të realizuara; planifikimin dhe zhvillimin urbanistik; planifikimin, realizimin e të ardhurave, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit; zbatimin e rekomandimeve, transaksionet financiare, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, gjatë periudhës objekt auditimi nga 01.01.2020-31.12.2021.

Auditimi, ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e aktivitetit të Bashkisë Tepelenë, mbështetur në analizë risku, si dhe duke

³ISA-ISSAI/IFPP-2230 "Evidenca e auditimit" dhe ISSAI/IFPP 2500 "Dokumentimi i auditimit".

vlerësuar paraprakisht funksionimin e menaxhimit financiar dhe sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi, etj.

Opinion i cilësuar/kualifikuar⁴:

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e 6 Bazës për Opinionin e cilësuar, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Bashkia Tepelenë ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative të fushës së prokurimeve, menaxhimit urbanistik, planifikimit dhe realizimit të buxhetit, zbatimit të rekomandimeve etj.), gabimet dhe shkeljet e evidentuara, janë materiale, por jo të përhapura.

Baza për opinion e cilësuar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Tepelenë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e përputhshmërisë, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme⁵ për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI/IFPP 400 & ISSAI/IFPP 4000).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar Bashkia Tepelenë, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit, sipas përshkrimit në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve:

Mbi auditimin e procedurave të prokurimit është evidentuar se:

Në 2 raste, nuk është kryer oponenca teknike;

Në, 6 raste, nuk janë argumentuar në mënyrën e duhur kriteret e vlerësimit;

Në 3 raste, është kualifikuar nga KVO, operatorë ekonomikë me vlerë (oferë ekonomike) anomalisht të ulët.

Mbi hartimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit të bashkisë.

Nga auditimi i hartimit të programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitin 2021, arrijmë në konkluzionin se, nga auditimi i programimit të buxheteve afatmesëm dhe i procedurave për përgatitjen PBA 2019-2021 dhe 2020-2022, mungon Urdhri i Titullarit, për organizimin dhe mbledhjen e këtij grupi për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve.

Mbi realizimin e të ardhurave si rezultat i punës së pamjaftueshme të strukturave përkatëse u evidentuan të ardhura të munguara në shumën

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Tepelenë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Tepelenë, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Tepelenë janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet.

⁴*Opinion i cilësuar/kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të cilësuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.*

⁵ISSAI/IFPP-400, "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", paragrafi 48 dhe 58.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme⁶, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ.

II. HYRJA

II.1. Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 261/1, datë 09.03.2022, ndryshuar me shkresën nr. 261/2, datë 04.05.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 09.03.2022 deri në datë 13.05.2022 në subjektin Bashkia Tepelenë për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2020 deri në 31.12.2021, u krye auditimi mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë nga **Grupi i Auditimit me përbërje:**

- B. Z., Përgjegjës Grupi
- M. B., audituese
- E. M., audituese
- E. Rr., auditues

Titulli. Auditim Financiar dhe Përputhshmërie

Marrësi. Bashkia Tepelenë

II.2. Objektivat dhe qëllimi.

- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, për të arritur objektivin e këtij auditimi që është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2020 dhe 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt, me synim dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbime e investimeve.

Ky projekt auditimi do të shtrihet për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2020 deri në datë 31.12.2021, si dhe do të ketë si fushëveprimi zbatimin e rekomandimeve,

⁶ISSAI/IFPP 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", paragrafi 40 dhe 41.

auditimin e pasqyrave dhe transaksioneve financiare, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimin e brendshëm, procedurat e prokurimit me fonde publike të zhvilluara gjatë periudhës së veprimtarisë nën auditim, përputhshmërinë me kriteret e paracaktuara në fushën e planifikimit urban dhe dhënien e lejeve të ndërtimit.

II.3. Identifikimi i çështjes.

Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm, si dhe nuk ka rishikim të tij.

Sa më sipër, fushat me risk të lartë u përcaktuan si drejtimet e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit nr. 216/1 datë 09.03.2022, si më poshtë:

- Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar; ligjet vjetore òPër buxhetin e shtetitò të vitit 2020 dhe 2021, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.
- Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare të vitit 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshmeò i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022.
- Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 òPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 162/2020 òPër prokurimin publikò dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò.
- Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.
- Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Tepelenë, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për të fushat e veprimtarisë. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve.

Për auditimin financiar:

- Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe

për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

- Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Për auditimin e përputhshmërisë:

- Përgjegjësi e audituesit, lidhen me faktin e marrjes së sigurisë së arsyeshme, në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

II.6. Kriteret e vlerësimit.

- Standardet e Auditimit:
 - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit;
 - Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
 - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
 - Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
 - Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
 - Manuali mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin;
 - Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Akte ligjore:
 - Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
 - Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin;
 - Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò i ndryshuar;
 - Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"
 - Ligji nr. 139/2015 òPër vetëqeverisjen vendore;
 - Ligji nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore;
 - Ligji nr. 114/2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, etj.
- Akte nënligjore
 - VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar;
 - VKM nr. 285, datë 19.05.2021 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò;

- VKM nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit";
- VKM nr. 360, datë 29.5.2019 "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territoriale të njëjësive të vetëqeverisjes vendore";
- VKM nr. 1162, datë 24.12.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi";
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme, etj.
- Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore:
- Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
- Udhëzimi MF nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njëjësive të vetëqeverisjes vendore";
- Udhëzimi MF nr.10/1, datë 28.02.2017 "Për përgatitjen e buxhetit vendor, etj.
- Rregullore e Brendshme "Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH^{së}", miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH^{së} nr.85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme "Mbi Procedurat e auditimit në KLSH^ö", miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH^{së} e ndryshuar;
- Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tepelenë, etj.

II.7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës. Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë "Parimet INTOSAI-të ku përfshihet: ISSAI-P-1 "Deklarata e Limësë", ISSAI-P-10 "Deklarata e Meksikosë"; Nivelin e dytë "Standardet e INTOSAI-të ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 "Parimet bazë të auditimit financiarë, ISSAI 400-499 "Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë".

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

ISSAI-140 "Sigurimin e cilësisë"

Gjatë auditimit, ka funksionuar sistemi i mbikëqyrjes dhe sigurimit të cilësisë, për të marrë siguri të arsyeshme, për dhënien e opinionit:

- Grupi i auditimit, ka vepruar në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore;
- Grupi i auditimit, në mënyrë individuale dhe kolektive ka patur kompetencën e nevojshme profesionale për të kryer auditimin;
- Grupi i punës, është mbikëqyrur nga Përgjegjësi i Grupit, Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit, për të siguruar që auditimi është kryer në përputhje me standardet përkatëse profesionale.

ISSA 130 "Kodin Etik"

Grupi i auditimit, gjatë punës audituese në terren vepruar në përputhje me Kodin Etik, duke reflektuar:

- Integritet.
- Pavarësi, objektivitet, paanshmëri.
- Ruajtjen e sekretit profesional.

- Kompetencat dhe kujdesin e duhur.
- Sjelljen profesionale.

ISSAI 2315 “Risku”

Gjatë fazës së planifikimit dhe auditimit në terren, është kryer vlerësimi i riskut, si dhe u identifikuan fushat më risk më të lartë, mbi të cilat u fokusua auditimi. Nga Grupi i auditimit u vlerësua RA ($RA=RB*RKB*RMZ$), ku u vlerësua:

- Kuptimi i subjektit dhe mjedisit i tij;
- U identifikua dhe vlerësua risku i brendshëm;
- U vlerësua funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm;
- U përcaktua e rreziku i mos zbulimit;
- U aplikua Modeli i sigurisë, (Më hollësisht të trajtuara në Letrat e punës).

ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”

Nga Grupi i auditimit është përcaktuar sipas zonave të llogarisë niveli i materialitetit, i cili ka rezultuar si sasior, po ashtu edhe cilësor (kryesisht në auditimin e përputhshmërisë);

ISSAI 2500 “Dokumentimi”

Nga Grupi i auditimit është siguruar dokumentimi i gjetjeve të auditimit, duke u bazuar kryesisht në një evidencë të plotë, të saktë, të besuar, të mjaftueshme, duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- Mjaftueshmërinë e evidencës së auditimit
- Rëndësia e evidencës së auditimit
- Burimet e evidencës së auditimit
- Llojet e evidencës së auditimit, etj.

II.8. Metodave të auditimit.

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji si dhe funksionimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm nga njësia e audituar, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të Riskut të Auditimit (RA).

Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista me shkrim dhe verbale, ka kryer teste kontrolli, të cilat në mënyrë analitike janë të përshkuara në Letrat e punës. Nga vlerësimi i riskut në fazën e planifikimit dhe në fazën e auditimit në terren, ka rezultuar se sistemi i kontrollit të brendshëm, konkretisht 5 komponentët përbërës si: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi/komunikimi, si dhe Monitorimi, përgjithësisht kanë funksionuar në mënyrën e duhur, si dhe janë konsideruar me risk të mesëm, për këtë arsye:

- Për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe korrektësisë (në auditimin e përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar në lidhje me zhvillimin e procedurave të prokurimit publik (zona e llogarisë 23), bazuar në analizën e riskut, u gjykua që të kryhen teste thelbësore (të detajeve) për 2 procedura nga 4 të zhvilluara në vitin 2020, ose 93 % të fondit limit dhe për 5 procedura nga 7 të zhvilluara në vitin 2021, ose 95 % e fondit limit, si dhe me zgjedhje për procedurat e prokurimit mbi 100,000 lekë.

Përzgjedhja e metodës u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efijencës së auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Meqenëse RA u vlerësua i mesëm, numri i transaksioneve për procedurat mbi 1,000,000 lekë ishte i kufizuar (12 procedura për dy vite) por që përfaqësojnë vlerë të lartë monetare (në shumën 408 milionë lekë) u gjykua që të testohen 7 procedura ose 94 % e procedurave.

- Për të ardhurat, janë përdorur teste thelbësore (substanciale), duke u nisur nga vlerësimi paraprak që ka treguar se kontrollat dhe sistemet e kontroleve të brendshme të subjektit janë të dobëta dhe nuk funksionojnë (trajtuar më hollësisht te letrat e punës).

Testet e Kontrollit, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, janë të mbështetura tek niveli i materialitetit dhe vlerësimit të riskut, shkalla e sigurisë që përfitohet nga kryerja e testeve të kontrollit, tek Nt e kampionimit dhe zgjedhjes rastësore.

Testet e detajeve, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, për të marrë evidencë auditimi për pohimet (ekzistenca e një ngjarje ekonomike, ligjshmëria dhe vlerësimi i saj).


II.9. Dokumentimi i auditimit, është mbështetur në kërkesat e manualeve të auditimit, në Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e ezauruara (planifikim dhe auditim në terren). Nga Grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është lënë gjurmë auditimi për të gjitha procedurat e kryera nga Grupi i auditimit.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Bashkia Tepelenë, është Njësi e Vetëqeverisjes Vendore, e cila ka në përbërje të saj 4 Njësi Administrative: Tepelenë, Qendër Tepelenë, Lopes dhe Kurvelesh, ajo shtrihet në një sipërfaqe prej 431 km² dhe ka një popullsi sipas Regjistrit të Gjendjes Civile prej 16,371 banorë dhe sipas Cencus 2011, rreth 8,949 banorë.

Bashkia Tepelenë



Njësitë administrative, qytetet dhe fshatrat

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë Administrative	Qyteti dhe fshatrat nën juridiksionin e Bashkisë Tepelenë
		Tepelenë	Qyteti Tepelenë
		Qendër Tepelenë	Fshatrat: Dukaj, Salari, Turan, Mamaj, Veliqot, Bënçë, Dragot, Beçisht, Mezghoran, Peshan, Hormovë, Lekël, Kodër, Luzat

Gjirokastrë	Tepelenë	Lopes	Fshatrat: Sinanaj, Matohasanaj, Dorëz, Dhëmban, Lab Martalloz
		Kurveleshsh	Fshatrat: Lekdush, Gusmar, Nivicë, Rexhi

Veprimtaria e saj bazohet në Ligjin nr. 139/2015 ÷Për vetëqeverisjen vendore, Ligjin nr. 68/2017 ÷Për financat e vetëqeverisjes vendore; Ligjin nr. 115/2014 ÷Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, etj.

Vendimet merren nga Këshilli Bashkiak i përbërë nga 15 anëtarë;

Drejtimi i Bashkisë kryhet nga Kryetari i Bashkisë;

Njësitë Administrative drejtohen nga Administratorët e Njërive Administrative;

Detyrat dhe kompetencat e Bashkisë Tepelenë fokusohen kryesisht në:

- Shërbimin publik;
- Shërbimin social;
- Shërbimin kulturor dhe sportet;
- Biznesin.

Misioni për njësinë që auditohet është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin*).

Objektivat burojnë nga ligji ÷Për vetëqeverisjen vendore.

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

III.2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

III.2.1 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

II.2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

U auditua funksionimi i pesë elementëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informimi dhe komunikimi, monitorimi. Në përfundim të auditimit arrihet në konkluzionin se edhe pse është hartuar rregullore e brendshme, nuk është hartuar një paketë e plotë rregullash të tjera të shkruara për të siguruar një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit, si elementi bazë dhe kryesor i kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e duhur, punonjësit kanë mangësi në njohjen e kërkesave të ligjit 10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk janë hartuar programe për të

siguruar ruajtjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk janë hartuar dokumente si regjistri i riskut, gjurma e auditimit.

Për të vlerësuar funksionimin e SKB dhe AB, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Rregullore e Brendshme e miratuar me Vendimin nr. 21, datë 04.09.2019 "Për miratim të përditësimit të Rregullores së Brendshme në Bashkinë Tepelenë";
- Rregullore e Brendshme e Funksionimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës dhe Kujdesit Social, miratuar me Vendimin nr. 3, datë 01.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë;
- Rregullore për "Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Bashkinë Tepelenë", miratuar me Urdhëresën nr. 82/1, datë 24.12.2019 të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë;
- Rregullore për "Menaxhimin e aktiveve të Bashkisë Tepelenë dhe institucioneve në varësi të saj, dhe anekset bashkëngjitur", miratuar me Vendimin nr. 25, datë 14.10.2020 të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë;
- Kodi Etik i Bashkisë Tepelenë, miratuar me Vendimin nr. 68, datë 05.05.2017;
- Rregullat dhe kushtet e zënies së hapësirës publike në Bashkinë Tepelenë, miratuar me Urdhëresën nr. 11, datë 10.01.2018;
- Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Tepelenë nr. 5/3, datë 30.03.2020, dhe shkresa e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë mbi konfirmimin e ligjshmërisë nr. 508/1, datë 29.05.2020, mbi strukturën organizative dhe numrin e punonjësve në Bashkinë Tepelenë, për vitin 2020;
- Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Tepelenë nr. 11, datë 31.03.2021, dhe shkresa e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, mbi konfirmimin e ligjshmërisë nr. 593/2, datë 08.04.2021, mbi strukturën organizative dhe numrin e punonjësve në Bashkinë Tepelenë, për vitin 2021, ndryshuar me Vendimin nr. 11/2, datë 07.07.2021;
- Pyetësori i Vetëvlerësimit për vitin 2020, dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 530/1, datë 06.04.2021;
- Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në Njësinë Vendore Bashkia Tepelenë, për vitin 2020;
- Pyetësori i Vetëvlerësimit për vitin 2021, dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 438, datë 25.02.2022;
- Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në Njësinë Vendore Bashkia Tepelenë, për vitin 2021;
- Shkresa për ndryshim dhe miratim të NZ dhe NA, dërguar Ministrisë së Financave;
- Urdhri nr. 14, datë 12.02.2018 mbi ngritjen e GMS, në Bashkinë Tepelenë;
- Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Bashkinë Tepelenë, miratuar me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2018;
- Raport vjetor "Mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkisë Tepelenë për vitin 2020 dhe 2021";
- Plani i Veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Urdhër i Kryetarit të Bashkisë nr. 6, datë 22.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave të organizimit të ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale";
- Urdhër i Kryetarit të Bashkisë nr. 8, datë 22.01.2020 "Për gjurmën e standarde të prokurimit me vlerë të vogël";

- Urdhër i Kryetarit të Bashkisë nr. 10, datë 22.01.2020 "Për menaxhimin e aktiveve".

Nga auditimi ka rezultuar se:

II.2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Tepelenë, janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët, konkretisht:

- Mjedisi i kontrollit;
- Menaxhimi i riskut;
- Aktivitetet e kontrollit;
- Informimi dhe komunikimi;
- Monitorimi, në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò si dhe në mbështetje të Manualit mbi MFK.

Konkluzion: Nga subjekti Bashkia Tepelenë, përgjithësisht ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm, ku ka gjetur zbatim implementimi i 5 komponentëve të tij. Është zbatuar Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, në lidhje me plotësimin e kërkesave mbi përgjegjshmërinë menaxheriale, si dhe përdorimin me efektivitet të fondeve. Në Bashkinë Tepelenë, ka funksionuar sistemi me dy firma, si dhe ka një ndarje të qartë të detyrave dhe funksioneve, në zbatim të nenit 8 òPërgjegjshmëria menaxheriale e titullaritò dhe nenit 9 òPërgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizuesò.

II.2.1.2. Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi/komunikimi, si dhe monitorimi.

Nga auditimi u konstatuan këto mangësi:

- Titulli i Gjetjes 1: Komponenti 1. "Mjedisi i kontrollit",** është vlerësuar bazuar në parimet që duhet të zbatohen, nga Bashkia Tepelenë, për të siguruar një mjedis kontrolli, që ti shërbejë arritjes së objektivave.
- Situata:**
- GMS për vitin 2020 dhe 2021, nuk ka kryer takimet periodike, për rishikim të risqeve, menaxhim të aktiveve, analizë mbi arritjen e objektivave, etj.;
 - Nuk janë miratuar procedura dhe mekanizma të cilat ju dedikohen ankesave për korrupsion, si dhe nuk ka procedura mbi sinjalizuesit dhe mbrojtjen e tyre;
 - Njësia nuk ka nja program trajnimi të dedikuar për integritetin dhe sjelljen etike;
 - Nuk ka plan monitorimi për objektivat strategjike.
- Kriteri:** Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò:
- nenin 27 të ligjit òPër MFKò, si dhe Manualin mbi zbatimin e MFK-

së pika 4.2.9 òGrupi për menaxhimin strategjikò, ku cilësohet: “GMS të kryejë takimet 4 herë në vit si dhe vendimet e grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik”.

- nenin 8, pika 8, germa e, në kundërshtim dhe me Ligjin nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", Kreu III, neni 10 "Sinjalizimi i brendshëm dhe njësitë përgjegjëse" ku cilësohet: "1. Pranë çdo autoriteti publik, i cili ka më shumë se 80 të punësuar, dhe subjekti privat, i cili ka më shumë se 100 të punësuar, caktohet një njësi përgjegjëse, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet, sipas këtij ligji. 2. Njësia përgjegjëse mund të përbëhet nga një ose më shumë persona, sipas përbërjes dhe strukturës së organizatës, të trajnuar posaçërisht në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve dhe me Urdhrin nr. 30, datë 05.03.2015 të Kryeministrit mbi miratimin e rregullores òPër procedurat e regjistrimit, shqyrtimit dhe ruajtjes së praktikave korruptive të denoncuar në faqen unike të denoncimit të korrupsionitò;
- neni 8 pika 8/b “Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit”, neni 20 òMjedisi i kontrollitò, ku cilësohet: 1. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. 2. Mjedisi i kontrollit përmban: a) integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; b) politikat menaxheriale dhe stilin e punës; c) strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; ç) politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore; d) aftësitë profesionale të punonjësve.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e monitorimit të risqeve dhe menaxhimit të tyre, mos plotësimi i strukturës me personelin e duhur, mungesa e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve profesionale, si dhe mungesa e një plan monitorimi mbi objektivat ndikojnë në arritjen e tyre.

Shkaku: Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 08.07.10 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, si dhe mungesë stafi teknik.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Titullari i Bashkisë, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues dhe Kryetarit të GMS, të marrë masa për mbledhjen e GMS, të paktën 4 herë në vit, me qëllim identifikimin, monitorimin, rishikimin e risqeve dhe marrjen e masave për minimizimin e tyre, duke hartuar dhe miratuar aktivitete kontrolli shtesë.

Titulli i Gjetjes 2: Komponenti 2. Menaxhimi i riskut”. Në funksion të këtij komponenti të MFK, Bashkia Tepelenë duhet të:

- Specifikojë objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje më këto objektiva;
- Specifikojë dhe analizojë risqet në lidhje më këto objektiva;
- Vlerësojë mundësinë e riskut për mashtrim;
- Identifikojë dhe analizojë ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se nga Bashkia Tepelenë:

Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Nuk është hartuar Regjistri i riskut në nivel institucional, për vitin 2020 dhe 2021 për pasojë, nuk është kryer asnjë proces tjetër pasues; - Titullari në cilësinë e NA, as nuk e ka kryer funksionin e koordinatorit të riskut, si dhe as nuk e ka deleguar këtë funksion tek një zyrtar i nivelit të lartë drejtues; - Nuk është mbledhur GMS për caktimin e nivelit të lejueshëm të riskut; - Nuk është mbledhur GMS për shqyrtim dhe rishikim të riskut. - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 <i>“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin neni 21 të Menaxhimit të riskut, ku cilësohet: 1. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes. 2. Për t’i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollin që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit. 3. Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsive, nëpunësit autorizues të njësisë publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive.</i> - nenin 10 të Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut, ku cilësohet: <i>“1. Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatori i riskut është nëpunësi autorizues i njësisë publike. 2. Në përmbushje të përgjegjësisë të tij, nëpunësi autorizues mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e koordinimin e riskut punonjësve, pjesë të strukturës së financës. 3. Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut përcaktohen me udhëzim të Ministrisë të Financave”.</i>
Ndikimi/Efekt:	Mos identifikimi i risqeve, monitorimi dhe rishikimi i tyre gjatë vitit, mund të sjellë në mosrealizim të objektivave.
Shkaku:	Mungesë e stafit teknik, profesional në sektorë të ndryshëm të bashkisë, për të identifikuar risqet, sipas strukturave, proceseve, si dhe më pas në hartimin e regjistrimit institucional të risqeve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Titullari i Bashkisë, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues dhe Kryetarit të GMS, të marrë masa për nxjerrjen e një urdhri, i cili duhet të drejtohet të gjithë strukturave të bashkisë, me qëllim identifikimin e risqeve, si dhe ngritjen e grupit të punës, për hartimin e regjistrimit institucional të risqeve, për vitin 2022 e në vazhdimësi.

Titulli i Gjetjes 3: Komponenti 3. Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit, janë politikat dhe procedurat e vendosura për të adresuar risqet dhe për të arritur objektivat e institucionit, të cilat ndahen në 3 kategori: Kontrolli para faktit ose parandalues; Kontrolli pas faktit ose zbulues; Kontrolli drejtues menaxherial.

Në funksion të këtij komponenti të MFK, Bashkia Tepelenë duhet të:

1. Përzgjedh dhe zhvillojë aktivitete kontrolli;
2. Përzgjedh dhe zhvillojë aktivitete kontrolli të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë;
3. Vendos aktivitet kontrolli përmes politikave dhe procedurave;

Situata:

Veprimtaritë e kontrollit, që jepen në nenin 22, pikën 3 dhe 4 të këtij, janë kontrole para faktit dhe pas faktit. Përjashtimisht, kontrollet para faktit, për proceset apo transaksionet e punës, që gjykohen si më të ekspozuara ndaj risqeve të mëdha, mund të ushtrohen nga kontrollorët financiarë apo persona të tjerë, të caktuar nga nëpunësi autorizues.

a. Kontrolli parandalues: evidentojmë se është kryer ndarja e detyrave, në lidhje me kryerjen e transaksioneve financiare, është përdorur sistemi me dy firma, janë përcaktuar rregulla të qarta për ruajtjen e pronës. Janë vendosur kontrole aksesi si dhe janë zbatuar procedura kontabiliteti të plota, të sakta dhe në kohë të cilat pasqyrojnë të gjitha ngjarjet.

Bashkia Tepelenë, ka hartuar dhe miratuar një sërë rregullash për aktivitetet kryesore, si masa parandaluese të një ngjarje dhe minimizuese për risqet, të cilat mund të cenojnë arritjen e objektivave.

b. Kontrolle zbuluese: evidentojmë se janë kryer kontrole pas fakti nga KLSH, si dhe nga Sektori e Auditit të Brendshëm. Gjatë vitit 2021, nga AB është kryer auditim mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, sipas programeve vjetore të vitit 2020 dhe 2021. Titullari i bashkisë, nëpërmjet raporteve dhe informacioneve nga AB, ka marrë siguri të arsyeshme se njësitë publike mban informacione të përshtatshme financiare, në mënyrë që pasqyrat financiare janë plotësuar sipas standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar, etj.

c. Kontrolli drejtues menaxherial: evidentojmë se në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, janë përcaktuar rregulla që lidhen me ndarjen e detyrave të drejtave dhe përgjegjësisë, procedurat për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të trajtuara në Kapitullin V "Funksionimi i administratës së bashkisë", neni 31, 32, 33, 46 dhe 45. Është miratuar Rregullore " Për parandalimin e konfliktit të interesave të funksioneve publike" nr. 82/1, datë 24.12.2019, ku janë trajtuar qartë dhe procedurat që duhet të ndiqen, Kreu II "Procedurat dhe mjetet për identifikimin, regjistrimin dhe trajtimin e konfliktit të interesit".

Nga auditimi u konstatua se:

- Nuk ka rregulla të miratuara për komunikimin elektronik, apo sisteme të ndryshme online edhe për faktin se nuk ka ecuri në lidhje me përdorimin e teknologjisë së informacionit në ushtrimin e veprimtarisë;
- Nuk ka gjurmë auditimi dhe hartë procesesh (Aneksi nr.3 dhe nr.4 i Manualit) për të gjitha aktivitetet kryesore të Bashkisë, si një masë parandaluese dhe minimizuese të risqeve të cilat mund të cenojnë arritjen e objektivave institucionalë. Harta e proceseve të punës është paraqitur vetëm për procedurat e prokurimit në vlerë të vogël, ndërsa nga strukturat e tjera të Bashkisë Tepelenë, nuk është hartuar harta e proceseve të punës, nga ku të përshkruhen dhe dokumentohen me hollësi: -procesi, nën proceset, objektivi i procesit, struktura përgjegjëse, përshkrimi i procesit, njësitë dhe strukturat që përfshihen në proces, kuadri ligjor dhe afati kohor (sipas aneksit 2 Manuali i

proceseve të punës).

- Nuk janë përcaktuar dhe miratuar gjurmët e auditimit për procedurat dhe operacionet e njësisë, sipas përcaktimeve në Manualin e MFK. Mos përcaktimi i hartës së proceseve dhe gjurmës së auditimit është në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK dhe Manualin në zbatim të tij dhe është përgjegjësi e titullarit, pasi është personi përgjegjës që duhet të urdhërojë përgatitjen e gjurmës së auditimit nga strukturat organizative që janë përfshirë në proces.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 *Ë*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

neni 22 *Ë*Veprimtaritë e kontrollit, ku cilësohet: *“1. Titullarët e njësive të sektorit publik miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.*

Ndikimi/Efekti: Mos hartimi i gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve, për aktivitet kryesore të Bashkisë, ndikon negativisht në realizimin e tyre me cilësi dhe në përputhje me rregullat dhe aktet ligjore, si dhe me ndjekjen e hapave të duhur, në afat dhe nga personat përgjegjës, sipas shkallës hierarkike.

Shkaku: Mosnjohje në masën e duhur të ligjit për MFK, mungesë të stafit, si dhe mosveprim nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: Mesme

Rekomandim: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune më qëllim hartimin e gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve, për aktivitetet kryesore të veprimtarisë, ku do të veçonim, identifikimin e subjekteve taksapaguese, përlllogaritjen e detyrimeve, monitorimin dhe vjeljen e tyre.

Titulli i Gjetjes 4: Komponenti 4: Informacioni dhe komunikimi.

Në funksion të këtij komponenti të MFK, Bashkia Tepelenë duhet të:

1. Marrë dhe gjenerojë dhe përdorë informacion cilësor;
2. Përdorë komunikim të brendshëm;
3. Përdorë komunikim të jashtëm;

Në Bashkinë Tepelenë, funksionin shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shpresore dhe elektronike, sipas rregullores së brendshme. Mënyra e shkëmbimit të informacionit dokumentar dhe elektronik është e përcaktuar në pjesë të veçanta të Rregullores së Brendshme të Bashkia Tepelenë, neni 35-45 dhe në Kapitullin V "Funksionimi i administratës së bashkisë". Kanë funksionuar linjat e komunikimit të jashtëm në lidhje me dhënien dhe marrjen e informacionit për njësitë e varësisë jashtë Bashkisë Tepelenë, por edhe të tretë jashtë sistemit. Është funksionale faqe eb Bashkia Tepelenë, në të cilën ka informacion relativisht të mjaftueshëm për aktivitetin, veprimtarinë, raporte monitorimi mbi realizimin e programeve, planeve vjetore, etj., por është evidentuar mangësia si më poshtë:

Situata: Përsa i përket komunikimit të brendshëm, nuk janë identifikuar, hartuar dhe miratuar llojet e raportimit brenda strukturave të bashkisë, në funksion të monitorimit të realizimit të objektivave strategjike dhe

Kriteri:	vjetorë, të përcaktuara në planet përkatëse; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò neni 23 òInformacioni dhe komunikimiò, ku cilësohet: <i>Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi, që sigurojnë: 1. Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.</i> <i>23/1. Nëpunës autorizues i nivelit të dytë dhe/ose i niveleve të tjera janë nëpunës të administratës publike në secilën nga njësitë vartëse, me buxhet më vete të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues”.</i>
Ndikimi/Efekti:	Mos marrja e informacionit të plotë, sjell mos identifikimin në kohë të problematikave, mos identifikim të indikatorëve të pa realizuar dhe për pasojë në mos marrjen e masave korrigjuese me qëllim arritjen e objektivave.
Shkaku:	Mosveprim nga ana e Titullarit të Bashkisë.
Rëndësia:	Mesme
Rekomandim:	Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për miratimin e formateve dhe informacionit që struktura të ndryshme të Bashkisë, duhet të përgatisin dhe raportojnë, në lidhje me përmbushjen e objektivave strategjike dhe vjetorë, ku të jetë përcaktuar: lënda, indikatorë të matshëm, afatet, strukturat përgjegjëse, realizuese dhe monitoruese.

Titulli i Gjetjes 5: Komponenti 5 "Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm"

Monitorimi bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Monitorimi kryhet nëpërmjet një monitorimi në vazhdimësi, nëpërmjet vlerësimeve të shkëputura ose duke i kombinuar të dyja.

- Nga Bashkia, është plotësuar Pyetësori i vetëvlerësimit dhe është dërguar në Ministrinë e Financave për të dy vitet objekt auditimi, brenda afatit të përcaktuar;
- Është hartuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave òRaporti përmbledhës mbi cilësinë dhe gjendjen e kontrollit të brendshëmò, në zbatim të nenit 18.1 të ligjit òPër MFKò;
- Është hartuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financave òDeklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëmò në zbatim të nenit 18.1 të ligjit òPër MFKò dhe Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011 "Për paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike";

Në funksion të këtij komponenti të MFK, Bashkia Tepelenë duhet të:

1. Përzgjedhë, zhvillojë dhe kryejë vlerësime të vazhdueshme, ose të veçanta të SKB;
2. Vlerësojë dhe komunikojë mangësitë.

Situata: Nga auditimi u konstatuan këto mangësi:

- Sistemet e raportimit, nuk janë monitoruar nga grupi për menaxhimin e çështjeve të riskut të brendshëm;
- Gjithashtu, nga Auditimi i Brendshëm, nuk është audituar në drejtim

të monitorimit të riskut si një prej dy metodave kryesore të këtij procesi, si dhe nuk janë vendosur rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku të specifikohet periodiciteti i verifikimit të këtyre sistemeve, si dhe procedurat për marrjen e masave riparuese.

- Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"
- Neni 24 "Monitorimi", ku cilësohet: *"1. Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë kushtet. 2. Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit realizohen, kryesisht, përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm nuk është pjesë e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Funksioni i auditimit të brendshëm rregullohet me ligjin për auditimin e brendshëm në sektorin publik".*
- Ndikimi/Efekti:** Mos marrja e informacionit të plotë, sjell mos identifikimin në kohë të problematikave, mos identifikim të indikatorëve të pa realizuar dhe për pasojë në mos marrjen e masave korrigjuese me qëllim arritjen e objektivave.
- Shkaku:** Mosveprim nga ana e Titullarit të Bashkisë.
- Rëndësia:** Mesme
- Rekomandim:** Titullari i Bashkisë, të marrë masa për vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet kontrollit drejtues dhe menaxherial, si kontroll parandalues, si dhe nëpërmjet strukturës së Auditit të Brendshëm në Bashki, si kontroll pas faktit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Titullari i Institucionit, z. T. P., cili nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet e përcaktuara në ligjin "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

II.2.1.3. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Konkluzion: Bashkia Tepelenë, ka dorëzuar "Deklaratën vjetore për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm", në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila është nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Tepelenë, në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe të Nëpunësit Autorizues, në përputhje me ligjin nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 9. Plotësimi i deklaratës është bërë në mënyrë të saktë dhe sipas formatit të kërkuar.

II.2.1.4. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm;

Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm. Niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe kryerja e trajnimeve të detyrueshme.

Konkluzion: Njësia eAB në Bashkinë Tepelenë, është miratuar sipas Strukturës organizative, më nivel sektori i cili ka në përbërje 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 2

(dy) specialistë, në përputhje me VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditit të brendshëm në sektorin publik", pika 3 dhe Ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore". Kjo drejtori është në varësi të titullarit të Bashkisë. Audituesi i brendshëm, është i certifikuar, sipas Certifikatës me nr. 1543/2013

Bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, niveli i raportimit në këtë drejtori.

Nga Bashkia Tepelenë, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, Kreu V "Të drejtat dhe përgjegjësitë e audituesve të brendshëm" është dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë:

a. *Karta e Auditit të brendshëm për Bashkinë Tepelenë:*

- Urdhri nr. 37, datë 09.03.2020 "Për miratimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm;
- Urdhri nr. 46, datë 25.03.2021 "Për miratimin e Kartës së Auditit të Brendshëm;
- Urdhri nr. 155, datë 09.12.2021 "Për miratimin e Kartës së Auditit të Brendshëm, dërguar në MFE me shkresën nr. 2411, datë 09.12.2021, në zbatim neni 14, germa (b).

Karta e auditit është hartuar në përputhje me formatin, sipas MAB, "Formatet standard për Kapitullin II", Formatin nr. 1.

a. *Planet strategjike të veprimtarisë së njësisë së AB;*

- Plani vjetor strategjik për vitin 2020, dërguar në MFE me shkresën nr. 1548, datë 18.10.2019 dhe Plan veprimi 2020-2022;
- Plani vjetor strategjik për vitin 2021, dërguar në MFE me shkresën nr. 1618, datë 06.10.2020 dhe Plan veprimi 2021-2023;

b. *Raportet vjetore të veprimtarisë së AB;*

- Është hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të AB, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Raporti mbi veprimtarinë e vitit 2020, me shkresën nr. 320, datë 12.02.2021;
- Është hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të AB, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Raporti mbi veprimtarinë e vitit 2021, me shkresën nr. 438, datë 25.02.2022;

Konkluzion: Sa më sipër, Sektori i AB, në Bashkinë Tepelenë, ka bashkëpunuar në vazhdimësi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në MFE, në përputhje me Ligjin 114/215, Kreu V, neni 14.

Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Sektori i Auditit të Brendshëm (SAB) gjatë vitit 2020-2021, në punën e saj audituese është mbështetur në Ligjin nr. 114/2014, 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar; Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, etj.;

Sipas programit vjetor të auditimit nr. 1548, datë 18.10.2019, gjatë vitit 2020 janë planifikuar për t'u kryer 4 auditime, nga të cilët dy auditime përputhshmërie, një auditim performace dhe një auditim financiar. Janë realizuar të 4 auditimet e planifikuara, ku niveli i zbatimit të rekomandimeve është: 90 % e tyre janë pranuar; 50 % e tyre janë realizuar dhe pjesa tjetër është në proces zbatimi.

SAB, gjatë këtij viti ka kryer auditime me fokus funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si në Drejtorinë e Arsimit Kulturës dhe Kujdesit Social, ku janë

evidentuar 5 gjetje dhe rekomandimet përkatëse; Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ku janë evidentuar 6 gjetje dhe rekomandimet përkatëse;

Sipas Programit vjetor të vitit 2021, janë planifikuar për t'u audituar 4 subjekte dhe janë realizuar 4 prej tyre, ose në masën 100 %. Përzgjedhja e tyre është kryer bazuar në risqet e identifikuar sipas subjekteve dhe fushave, si më poshtë:

Përcaktimi i fushave për t'u audituar dhe subjekteve për t'u audituar gjatë vitit 2021, është kryer sipas vlerësimit të riskut, referuar Planit strategjik vjetor për vitin 2021, ku janë përcaktuar si:

fusha me risk të lartë: detyrimet e prapambetura; tatim taksat; kultura dhe trashëgimia historike mbrojtja e territorit ujësjellës kanalizime;

subjekte me risk të lartë: Drejtoria e Zhvillimit ekonomik dhe Menaxhimit Financiar; Ujësjellës Kanalizime; Njësitë Administrative.

Nga Sektori i AB, gjatë këtij viti janë realizuar 3 auditime tematike financiare, në 3 Njësi Administrative, si dhe një auditim tematik, në fushën e tatim taksave.

Gjatë vitit 2021, nga Sektori i AB, nuk janë kryer auditime me fokus sistemet e kontrollit të brendshëm.

Të dhëna mbi realizimin e planit të vitit 2020-2021

Nr.	Periudha	Planifikuar	Realizuar %	Realizimi %
1	Viti 2020	4	4	100
2	Viti 2021	4	4	100

Të dhëna mbi realizimin e rekomandimeve 2020-2021

Nr.	Periudha	Rekomanduar	Pranuar %	Realizuar %	Proces %
1	Viti 2020	4	90	50	50
2	Viti 2021	4	100	0	100

Përsa i përket anës formale të dosjeve të auditimit:

Dosja e auditimit, referuar të dhënave të Tabelës anekse nr. 1.5.1, për auditimet e zhvilluara në vitin 2021, për 4 subjekte, nuk është e plotësuar dhe dokumentuar sipas përcaktimeve të bëra në MAB, Kapitulli VI. Dosja korente dhe dosja përhershme e auditimit të brendshëm, nuk është plotësuar në përputhje me MAB dhe me formatet standard.

Titulli i Gjetjes 6: Mbi dokumentacionin e dosjeve provizore dhe të përhershme të auditimit.

Situata:

Dokumentacioni mbi kryerjen e angazhimit të auditimit

- Nuk ka gjurmë mbi kundërshtitë dhe qasjen e subjektit të audituar kundrejt gjetjeve dhe rekomandimeve të auditit.
- Mungon Procesverbali i takimit përmbyllës
- Mungon Plani i veprimit dhe programi i masave për zbatim të rekomandimeve, sipas modelit të përcaktuar në MAB, Formati nr.10 "Model plan veprimi i plotësuar nga grupi i auditimit dhe subjekti i audituar";
- Janë mbajtur Akt konstatime dhe Proces verbale, dokumente të cilat nuk cilësohen të nevojshme në dokumentacionin e dosjes së auditit të brendshëm.

Kriteri:

Manuali i Auditimit të Brendshëm, me ndryshime.

Ndikimi/Efekti:

Mos dokumentim i duhur i procedurave të auditimit, mungesë e gjurmës së auditimit mbi procedurat e kryera e cila cënon cilësinë e auditimit.

- Shkaku:** Mosveprim nga ana e audituesit të brendshëm.
- Rëndësia:** E mesme
- Rekomandim:** Sektori i Auditit të Brendshëm të marrë masa që në të ardhmen të zbatojë me rigorozitet të gjitha hapat dhe procedurat e auditimit, me qëllim dokumentimin, sigurimin e gjurmës së auditimit, sigurimin e evidencës së auditimit për mbështetjen dhe argumentimin e konkluzioneve të auditimit.

Titulli i Gjetjes 7: Mbi konstatimet e rezultuara nga shqyrtimi i dosjeve, dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe raportimit të SAB në MFE.

Situata: Në vlerësim të raportimit që SAB, bën në MFE dhe konstatimeve të rezultuara nga shqyrtimi i dosjeve dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, duhet të evidentojmë se ka raportime të cilat nuk janë të mbështetura dhe argumentuara, si:

- Nga auditimi ka rezultuar se, fushëveprimi i auditimit, në funksion të qëllimit të tij, përgjithësisht ka qenë në koherencë me kërkesat e ligjit, ndërkohë që është raportuar se në çdo rast ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore. Konkretisht, evidentojmë se SAB për vitin 2021, kryesisht është përqendruar në identifikim të gjetjeve me rezultat financiar, duke devijuar nga qëllimi dhe objekti kryesor i auditimit të brendshëm, përcaktuar në ligjin nr. 114/2014, nenin 6 òRoli i auditimit të brendshëm cilësohet: *“Roli i auditimit të brendshëm është t’i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë:*

duke përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar;

duke vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve;

duke dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

- Nga auditimi ka rezultuar se SAB, përgjithësisht ka mbuluar me auditim të gjitha fushat të cilat i ka identifikuar në planet vjetore strategjike me nivel të lartë risku, ndërkohë që është raportuar se i mbulon të gjitha;
- Nga auditimi ka rezultuar se SAB, nuk ka kryer një përzgjedhje të fushave të auditimit në koherencë me risqet institucionale siç ka raportuar, pasi Bashkia Tepelenë nuk ka një regjistër risku;
- Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Tepelenë nuk ka të miratuar regjistrin e risqeve, ç'ka do të thotë se, nuk ka kontribut të identifikuar të SAB mbi evidentimin e risqeve institucionale, siç është raportuar;
- Nga auditimi ka rezultuar se SAB, përgjithësisht ka zbatuar standardet e AB, të specifikuara në MAB, mbi identifikimin e kontrolleve shtesë që duhet të ndërmerren për minimizimin e tyre, ndërkohë që raporton se identifikohen saktë të gjitha kontrollet për minimizimin e risqeve;
- Nga auditimi ka rezultuar se në vitin 2021, në dosjet e auditimit përgjithësisht administrohet dokumentacioni i kërkuar dhe cilësuar në MAB, ndërkohë është raportuar se administron të gjitha evidencat e nevojshme dhe të përshtatshme për të dokumentuar punën;

- Nga auditimi ka rezultuar se në Raportin final, nuk janë dokumentuar kundërshtitë e subjektit, ndërkohe që raportohet se në të gjitha rastet janë trajtuar kundërshtitë e subjektit.

Kriteri: Ligji për AB dhe Manuali i Auditit të Brendshëm.

Ndikimi/Efekti: Mos identifikimi i mangësive në zbatim të procedurave të auditimit, sjell mos korrigjim të tyre në të ardhmen.

Shkaku: Mos korrektësi nga ana e Audituesit të Brendshëm të Bashkisë Tepelenë, në raportimin e të dhënave.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Sektori i Auditit të Brendshëm duhet të marrë masa që në të ardhmen të korrigojë mangësitë e mësipërme si dhe të raportojë në mënyrë të saktë dhe transparente mbi aktivitetin vjetor, në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Z. K.N., Auditues në Sektorit të Auditimit, për mangësitë në zbatimin e procedurave të auditimit, si dhe për pa saktësi në plotësimin e Pyetësorit të vetëvlerësimit të AB në Bashkinë Tepelenë, drejtuar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Për sa është trajtuar më lart (pika 1 e Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 1 datë 08.04.2022, protokolluar në subjekt me nr. 484/2, datë 08.04.2022. Mbi këtë Akt konstatim, nuk janë paraqitur observacione.

II.2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

II.2.2.1 Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2020 dhe 2021

(në 000/lekë)

Nr.	EMERTIMI	VITI 2020		VITI 2021	
		Të ardhurat	Shpenzimet	Të ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura te trashëguara nga viti paraardhës	896		2,278	
2	Transfertë e pakushtëzuar	157,403		162,273	
3	Transfertë e kushtëzuar	194,473,		326,713	
4	Plani i të ardhurave	42,500		52,500	
5	Trashëguar nga transfertat viti paraardhës	11		76	
6	Shtese ne transfertet e vitit paraardhës	6,000		5,308	
	Transferta nga FZHR viti aktual			0	
7	Trashëguar Transferta nga FZHR viti paraardhës			0	
1	Paga (600)		124,917		121,804
2	Sig.shoqërore (601)		21,416		18,487
3	Shpenzime operative (602)		49,927		67,367
4	Transferta (603+604+605+606+609)		120,438		143,469
5	Investime (230 +231)		84,585		198,021
	Totali i buxhetit	401,283	401,283	549,148	549,148

Programimi i PBA 2019-2020

- Nga ana e Titullarit të Institucionit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS);

- Është miratuar kalendari buxhetor afatmesëm dhe buxheti vjetor brenda muajit Dhjetor 2018 me VKB nr.44, date 21/12/2017 òPër miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetorò, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.2784/1, datë 05/01/2018;
- PBA 2020 është miratuar me VKB nr. 89, datë 20/12/2019 òPër miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2020-2022ò, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.1794/1, datë 06/01/2020;
- PBA 2020 përfundimtare është miratuar me VKB nr.90,datë 20/12/2019 òPër miratimin e buxhetit të vitit 2020ò, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.1794/1, datë 06/01/2020;
- Vendimi KB nr.17, datë 19/03/2020 òPër disa ndryshime ne VKB nr.90, datë 20/12/2019 òPër miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2020ò.
- Është miratuar në afat monitorimi i buxhetit për periudhën 4 M I me VKB nr.30, datë 29/05/2020 òPër miratimin e raportit për monitorimin e buxhetit për periudhën 4-mujori i parë 2020ò, konfirmuar me shkresën 557/1, datë 15/06/2020 nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër;
- Është miratuar monitorimi i buxhetit për periudhën 8 M I VKB nr.58, datë 01/10/2020 òPër miratimin e raportit të monitorimit të buxhetit për periudhën 8-mujore të vitit 2020ò, konfirmuar me shkresën nr.972/1, datë 14/10/2020 nga Prefekti I Qarkut Gjirokastër;
- Vendimi KB nr.59, datë 01/10/2020 òPër disa ndryshime në VKB nr.90, datë 20/12/2019 òPër miratimin e buxhetit të vitit 2020, konfirmuar me shkresën nr.972/1, datë 14/10/2020 nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër;
- Është miratuar raporti vjetor i zbatimit të buxhetit me VKB nr.14, datë 26/02/2021 òPër miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit të vitit 2020ò, konfirmuar më shkresën nr.226/1, datë 10/03/2021 nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër;
- Vendimi KB nr.90, datë 20/12/2019, pika òdò, nga totali i shpenzimeve operative të parashikuara për vitin 2020 do të përdoren me destinacion për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura 10.000 mijë lekë, ku nga këto:
 - ✓ Për Mallra dhe Shërbime 8.500 mijë lekë;
 - ✓ Për Vendime Gjyqësore 1.500 mijë lekë;

Programimi i PBA 2020-2021

- Është miratuar kalendari buxhetor afatmesëm dhe buxheti vjetor brenda muajit Dhjetor 2019 me VKB nr.44, date 21/12/2019 òPër miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetorò, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.2784/1, datë 05/01/2019;
- Është miratuar në Këshillin Bashkiak tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik (të vitit paraardhës); me VKB nr.45, datë 30/07/2020 òPër miratimin e tavanëve përfundimtare të programit buxhetor afat mesëm 2021-2023ò, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr.772/1, datë 11/08/2020;
- Është miratuar PBA afatmesme me VKB nr.79, datë 23/12/2020 òPër miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023ò, konfirmuar me shkresën nr.1283/1, datë 07/01/2021 nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër;
- Është miratuar buxheti me VKB nr. 80, datë 23/12/2020 òPër miratimin e buxhetit të vitit 2021ò, konfirmuar me shkresën nr.1283/1, datë 07/01/2021 nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër;

- Është miratuar në afat monitorimi i buxhetit për periudhën 4 M I Vendimi KB nr.33, datë 31/05/2021 òPër miratimin e raportit të monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e parë të vitit 2021ò, konfirmuar me shkresën 509/1, datë 14/06/2021;
- Vendimi KB nr.34, datë 31/05/2021 òPër disa ndryshime në VKB nr.80, datë 23/12/2020òPër miratimin e buxhetit të vitit 2021ò, konfirmuar me shkresën 509/1, datë 14/06/2021;
- Vendimi KB nr.56, datë 30/09/2021 òPër disa ndryshime në VKB nr.80, datë 23/12/2020 òPër miratimin e buxhetit të vitit 2021ò, konfirmuar me shkresën nr.874/1, datë 05/10/2021 të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë;
- Vendimi KB nr.55, datë 30/09/2021 òPër miratimin e raportit për monitorimin e buxhetit për periudhën 8-mujore të vitit 2021ò, konfirmuar me shkresën nr.873/1, datë 11/10/2021 nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë;
- Është miratuar monitorimi i buxhetit për periudhën 8 M I Vendim KB nr.77, datë 17/12/2021 òPër disa ndryshime në VKB nr.80, datë 23/12/2021 òPër miratimin e buxhetit të vitit 2021ò, konfirmuar me shkresën nr.1174/1, datë 30/12/2021 nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë;
- Është miratuar në afat raporti vjetor i zbatimit të buxhetit me Vendimi nr.19, datë 31/03/2022 òPër miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit të vitit 2021ò, konfirmuar me shkresën 355/1, datë 14/04/2022 nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë;
- Vendimi KB nr.80, datë 23/12/2020, pika òcò, nga totali i shpenzimeve operative të parashikuara për vitin 2021 do të përdoren me destinacion për shlyerje të detyrimeve të prapambetura shuma 16.500 mijë lekë, ku nga këto:
 - ✓ Për Mallra dhe Shërbime 8.500 mijë lekë;
 - ✓ Për Vendime Gjyqësore 4.500 mijë lekë;
 - ✓ Për Investime 3.500 mijë lekë.

Referuar dokumentacionit të mësipërm arrijmë në përfundimin se Bashkia Tepelenë është duke vepruar në zbatim të plotë të Ligji nr.68/2017 òPër financat e qeverisjes vendoreò, konkretisht:

Neni 33 ku cilësohet:

òKryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.

Neni 34 ku cilësohet: Pika 1. Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore..ò.

Neni 35 ku cilësohet: Pika 1. Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek të gjitha njësitë shpenzuese.

Neni 36 ku cilësohet: Pika 4. Programi buxhetor afatmesëm vendor përfshin informacionin për dy vitet e fundit, vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese për çdo program të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore për: a) secilën kategori të të ardhurave të njësisë së vetëqeverisjes vendore ;b) shpenzimet sipas klasifikimit administrativ, funksional dhe ekonomik për çdo program buxhetor; c) qëllimet e politikave të programeve, objektivat e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve dhe kostot e tyre përkatëse. Të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe

treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore; ç) vlerësimin e kostove të politikave aktuale dhe atyre të reja, të planifikuara për financim nëpërmjet shpenzimeve buxhetore vendore vjetore dhe afatmesme; d) informacionin për standardet e shërbimeve të ofruara nga çdo program buxhetor dhe niveli i përmbushjes së tyre.

Pika 5. Brenda datës 1 qershor, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore i dërgon Ministrisë së Financave projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm.

Neni 37 ku cilësohet: Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik.ö

-Udhëzimi nr.23, datë 22.11.2016 öPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, shtojca 5 e udhëzimit ku cilësohet: Gjurma e Auditit për procedurat e përgatitjes së PBA (njësitë e qeverisjes së përgjithshme).

-Udhëzimi nr.22, datë 30.07.2017 öPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore, shtojca 1 e udhëzimit ku cilësohen: öAfatet kohore për monitorimin e buxhetitö.

-Udhëzimi nr.6/3, datë 10.07.2018 öPër përgatitjen e buxhetit vendorö

-Udhëzimi nr.7, datë 27.02.2019 öPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022ö, kapitulli 1 ku cilësohet: Afatet e përgatitjes të kërkesave të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022ö, shtojca 4 öGrupi për menaxhimin strategjik, ekipi i menaxhimit të programeve, shtojca 5 öPema e programit dhe roli i saj në mbështetje të rishikimit të politikave të programit dhe planifikimin e shpenzimeve të programitö.

II.2.2.2 Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative.

Nga auditimi u konstatua se, buxheti viteve 2020-2021 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesat të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 öPër menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, öPër menaxhimin Financiar dhe Kontrollinö, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 öPër sistemin e taksave vendoreö të ndryshuar.

- Buxheti vjetor 2020, është miratuar me VKB nr.90, datë 20/12/2019 öPër miratimin e buxhetit të vitit 2020ö, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr.1794/1, datë 06/01/2020;

- Buxheti vjetor 2021, është miratuar me VKB nr.80, datë 23/12/2020 öPër miratimin e buxhetit të vitit 2021ö, konfirmuar me shkresën nr.1283/1, datë 07/01/2021 nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë;

Mbi kontrollin e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Tabela nr. II.2.2.2.1 "Realizimi i buxhetit 2020"

(në 000/lekë)

Nr	Emërtimi i artikullit të shpenzimeve	Viti 2020		
		Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat	124,917	123,417	98,8
2	601 Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	21,416	20,841	97,3
3	602 Shpenzime operative	49,927	47,979	96
4	603 Subvencion Ujësjetësi	0	0	0
5	604 Këshilli Qarkut + emergjenca civile + transfertat	5,650	4,546	80,4
6	606 Ndihma ekonomike + shpërbllim lindje	114,788	114,031	99,3
7	609 Fondi rezervë dhe kontigjenca, emergjence civile	0	0	0
8	231 Investime objekte	84,585	15,421	18,2
9	230 Studime projektive	0	0	
	TOTALI	401,283	326,235	81,3

Tabela nr. II.2.2.2.2 "Realizimi i buxhetit 2021"

(në 000/lekë)

Nr	Emërtimi i artikullit të shpenzimeve	viti 2021		
		Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat	121,804	121,796	99,9
2	601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	18,487	18,483	99,9
3	602 Shpenzime operative	67,367	67,315	99,9
4	603 Subvencion Ujësullësi	0	0	0
5	604 Këshilli Qarkut + emergjenca civile + transferta	5,850	5,585	95,5
6	606 Ndihma ekonomike + shpërblim lindje	137,619	136,168	98,9
7	609 Fondi rezervë dhe kontigjenca, emergjence civile	0	0	0
8	231 Investime objekte	198,021	191,655	96,8
9	230 Studime projektive	0	0	0
	TOTALI	549,148	541,002	98,5

Burimi: Bashkia Tepelenë

Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se nuk ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, për sa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre, gjë e cila ka ndikuar në realizim të shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë Tepelenë. Si e tillë sektori i buxhetit ka zbatuar Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe ndryshuar, ligji nr.10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, ligji nr.9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore dhe ndryshuar, ligji nr. 68/2017 për Financat e Vetëqeverisjes Vendore, ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 për vetëqeverisjen vendore, UMF nr.10, datë 28.02.2017, për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020, si dhe UMF nr.10/1, datë 28 02 2017 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016 për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

Mbi shlyerjen e detyrimeve të prapambetura

Sektori i buxhetit ka programuar pagesat për detyrimet e prapambetura sipas shpërndarjes më poshtë :

Tabela nr. II.2.2.2.3 "Plani i shlyerjes së stokut të detyrimeve"

Nr	Bashkia	Detyrimi i mbetur deri në Dhjetor 2021	Shuma e parashikuar për shlyerjen përgjatë tre viteve			Diferenca Fakt Plan
			Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	
1	Bashkia Tepelenë	39,180,517	18,500,000	14,500,000	6,180,517	0

Burimi: Bashkia Tepelenë

Konkluzion:

1. Nga auditimi i hartimit të programimit, aprovimit, realizimit dhe monitorimit të buxhetit për vitet 2020-2021, arrijmë në konkluzionin se:
2. Nga auditimi i programimit të buxheteve afatmesëm dhe i procedurave për përgatitjen PBA 2019-2021 dhe 2020-2022 rezultoi se, janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik mbi organizimin dhe mbledhjen e këtij grupi për përcaktimin e tavaneve të shpenzimeve sipas programeve.

3. Janë përcaktuar qartë tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve si dhe janë përcaktuar fushat prioritet në shpenzimet për investime. Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse për investimet janë paraqitur në mënyrë të detajuar, referuar burimeve të financimit, pra cilat janë nga të ardhurat e veta dhe nga transfertat e pakushtëzuar.
4. Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet buxhetimit në pjesëmarrje. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, ujësjellësi etj., situatë e cila vërteton se nuk janë marrë në konsideratë nevojat reale dhe ato më prioritare.
5. Në planifikimin e buxheteve janë përcaktuar vlera e detyrimeve të prapambetura për mallra dhe shërbime sipas programeve që do të përballohen me fondet e vitit buxhetor.
6. Detyrimet e papaguara të paraqitura të grupuara sipas raporteve vjetore dërguar MFE paraqiten në fund vitin 2020 në shumën 58,056,725 lekë për fund vitin 2021 në shumën 39,180,517 lekë, të cilat përkojnë me vlerat e paraqitura në bilanc.

Për sa është trajtuar më lart (pika 2 e Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 12 datë 13.05.2022, protokolluar në subjekt me nr. 484/13, datë 13.05.2022. Nga subjekti janë paraqitur observacione për sa është trajtuar në këtë pjesë të PRA.

Pretendimi i subjektit të audituar.

- Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2020 janë në shumën 58,056,725 lekë dhe jo 135,712,539 lekë;
- Detyrimet e papaguara në fund të vitit 2021 janë në shumën 39,180,517 lekë dhe jo 144,770,921 lekë.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit

Grupi i auditimit shqyrtoj observacionin dhe vuri re gabimin njerëzor mbi shifrën e paraqitur në raportet vjetore të dërguara në MFE mbi detyrimet e prapambetura për vitet 2020 dhe 2021 dhe atë të mbajtur në akt konstatim. Si e tillë pretendimi i subjektit merret në konsideratë dhe u reflektua në materialin e PRA.

II.2.2.3 Burimi krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Për auditimin e burimit të krijimit të ardhurave dhe përdorimit të tyre u auditua dokumentacioni i paraqitur nga sektori i taksave dhe tarifave vendore si:

- evidencat analitike të llogarive debitorë për taksat dhe tarifatat vendore;
- akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga tatim taksat vendore;
- evidencat mbi gjendjen e debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare, regjistrat e bizneseve;
- administrimi i aseteve;
- procedura e lëshimit të licencave dhe autorizimeve;
- dokumente mbi procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore.

Nga auditimi u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

Në lidhje me auditimin e kryer në Bashkinë Tepelenë, për vitin 2020, numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me Vendimin nr. 5/3, datë 03.03.2020 të Kryetarit të Bashkisë dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 5081, datë 29.05.2020, ku përfshihet edhe struktura e Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore.

Për vitin 2021 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me vendimin 11/2, datë 07.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 593/2 të datës 8.04.2021.2021, ku përfshihet edhe struktura e Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore. Kjo drejtori ka në përbërje 2 punonjës, konkretisht pa Përgjegjës së Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore.

Në tabelat e mëposhtme paraqitet e detajuar situata e pagesave të kryera si më sipër, duke përfshirë edhe diferencat sipas viteve. Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke u përgatitur nga punonjësit e Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të Financës.

Në vijim paraqesim evidencën e gjendjes së bizneseve dhe ndryshimet e ndodhura si regjistrimet e reja, bizneset që kanë mbyllur aktivitetin dhe gjendja në fund të periudhës sipas tabelës 2.2.3.1.

Tabela: II.2.2.3.1 Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për 2020 -2021.

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja
1	Biznesi Vogël	2020	329	11	8	332
		2021	332	34	33	333
2	Biznesi Madh	2020	99	3	0	102
		2021	102	5	0	107
	Gjithsej	2020	428	14	8	434
		2021	434	39	33	440

Sa më sipër konstatohet se numri i bizneseve në total për vitin 2020 dhe 2021 është zvogëluar me 41 mbyllje aktiviteti dhe është zgjeruar me 53 çelje të reja për regjistrimin e bizneseve, për të cilat janë mbajtur regjistra manual për bizneset që ushtrojnë aktivitet tregtar etj., për të rritur sigurinë e informacionit që disponon zyra e tatim taksave vendore.

Në vijim po paraqesim në formë table planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për periudhën 01.01.2020-31.12.2021, sipas aneksit 2.2.3.2.

Titulli i gjetjes nr. 1: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitet 2020 dhe 2021

Tabela nr. II.2.2.3.1 “Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitet 2020 dhe 2021” (në mijë lekë)

Nr.	Lloji i taksës	Viti 2020			Viti 2021		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	TE ARDHURA NGA TAKSAT(1-9)	22,295	18,055	80	30,363	31,792	104
2	a)Taksa mbi ndërtesat	5,689	1,896	33	5,689	2,471	
3	b)Taksa mbi tokën bujqësore	711	707	99	721	485	
4	Taksa Trualli	498	554	111	498	574	
5	Taksa e kullotës	595	328	55	595	592	
6	Tatimi I thjeshtuar mbi fitimin	495	1,398	282	1995	1,493	
7	Taksa kalimit të drejt të pronësisë PP	0	99		290	85	
8	Taksa ndik.infras.nga ndërt.reja	8,331	6,629	79	14,781	18,359	
9	Taksa e zënies hapësirave publike	429	562	130	429	799	
10	Taksa parkimi dhe tregu	250	493	197	250	595	
11	Taksa e tabelës	228	495	217	228	507	
12	Taksa e regjistrimit për vi.mjeteve	3,663	4,456	121	3,703	5,568	

13	Taks reklame	234	243	103	0	0	
14	Taks e lendes drusore	1,172	195	16	1,184	264	
15	TE ARDHURA JOTATIMORE	20,205	19,536	96.6	22,137	23,488	106
16	Pastrim dhe gjelbërim	4,779	3,700	77.5	4,779	5,724	
17	Ndriçim	2,092	746	35	2,092	1,425	
18	Leje transporti	90	154	170	90	213	
19	Qira mbi token bujqësore	1,075	886	82	1,075	812	
20	Qira nga ndërtesat	0	0	0	40	201	
21	Qira kullote	5,630	3,966	70	5,630	2,271	
22	MNZ	0	5		12	11	
23	Gjoha + Kamatëvonesa	0	51		2278	4,150	
24	Pagesat për çerdhe	260	322		260	480	
25	Pagesa e kopshtit	260	323		260	481	
26	Te ardhura nga ambulantet	108	68	62	0	0	
27	Te ardhura shërbim varrimi	647	1312	202	647	627	
28	Te ardhura te tjera (antena celulare)	1,016	2,224	218	381	,3180	
29	Te tjera te ardhura sekondare	4,248	5,779	136	4,593	3,913	
	GJITHSEJ	42,500	37,591	88	52,500	55,280	105

Situata: **a. Për vitin 2020**, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga **42,500,000** lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën **37,591,000** lekë ose **88 %** me një diferencë në vlerën **4,909,000** lekë. Nga të cilat të ardhurat nga taksat nuk janë realizuar në vlerën 4,240,000 lekë, ose 20% të planifikimit, të ardhurat nga tarifave nuk janë realizuar në vlerën 669,000 lekë, ose 3.4% të planifikimit.

b. Për vitin 2021 të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga **52,500,000** lekë të parashikuara, janë realizuar, në vlerën **55,280,000** lekë, ose **105%**. Nga të cilat të ardhurat nga taksat mbi ndërtesën nuk janë realizuar në vlerën **3,218,000 lekë**, ose **57%** të planifikimit, të ardhurat nga tarifave për ndriçimin nuk janë realizuar në vlerën **667,000 lekë**, ose **32%**, të ardhurat nga qira kullote nuk janë realizuar në vlerën **3,359,000 lekë** ose **60%**.

Situatë e cila tregon një nivel të kënaqshëm në vlerë absolute të treguesve të buxhetit, por pamjaftueshmëri të angazhimit të strukturës së tatim taksave në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre

Niveli i arkëtimeve për taksat vendore nga njëra periudhë në tjetër vjen në rritje, ku për vitin 2020 paraqitet në shumën 37,591,000 lekë, ndërsa në vitin 2021 paraqitet në shumën prej 55,280,000 lekë.

-Mungesa e kadastrës fiskale për taksën e pronës (ndërtesë) për shkak të mungesës së burimeve njerëzore apo agjentëve tatimorë pengon vjeljen e taksës familjare.

-Vështirësi haset në vjeljen e taksës së tokës bujqësore ndaj fermerëve për shkak të mos organizimit të duhur të punës për vjeljen e taksës. Kjo sjell të ardhura të munguara nga viti në vit në buxhetin e Bashkisë.

Kriteri: - Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 ÷Për sistemin e taksave vendore;
- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar ÷Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Impakti: Mos realizimi i të ardhurave, mos vjelja e detyrimeve etj., ka impakt negativ në burimet e financimit dhe për rrjedhojë në realizimin e shpenzimeve, për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Shkaku: Punë e pamjaftueshme e administratës së tatim taksave të Bashkisë Tepelenë, si dhe mos rakordim për evidentimin e subjekteve të paregjistruara, zbatimin e masave shtrënguese për vjeljen e detyrimeve etj.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, duhet të marrë masa të menjëhershme, për koordinimin e punës midis sektorëve, bashkëpunimin me struktura të tjera si QKB, Drejtoria e Tatimeve Gjirokastrë, Zyrat e Gjendjes Civile, DRSHTRR, etj. me qëllim:

1. Kryerjen e rakordimeve me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, (në cilësinë e agjentit tatimor) për numrin e subjekteve që duhet të paguajnë, si dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimor, si dhe kryerjen e rakordimeve 6-mujore mbi realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;

2. Marrjen e të dhënave mbi bizneset në QKB, që në fazën e planifikimit, mbi numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllën ose regjistruan, dhe bazën e të dhënave për subjektet, të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore, do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;

3. Marrjen e masave për evidentimin e resurseve, analizimin dhe planifikimin e të ardhurave nga taksat kombëtare;

4. Marrjen e masave për kryerjen e rakordimeve me Zyrën e Gjendjes Civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Tepelenë, si dhe marrjen e masave për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të ÕNjoftim Vlerësimit, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi, nëpunësit civilë:

1. Z.R. H., me detyrë specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik Tatim Taksat

2. Z.G. G., me detyrë specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik Tatim Taksat

Titulli i gjetjes 2: Mbi mos vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat nga Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore.

Situata: Bazuar në të dhënat e marra nga evidencat e zyrës së Planifikimit të të Ardhurave, në vijim paraqitet debitorët progresiv deri më 31.12.2021 si në aneksin 2.2.3

Vlera e borxhit në 31.12.2020 në mënyrë progresive është në vlerën 21.455.168 nga të cilat:

- 13.364.487 lekë nga bizneset private;

- 1.688.171 lekë nga taksa e tokës;

- 6.402.510 lekë nga taksa familjare.

Vlera e borxhit në 31.12.2021 në mënyrë progresive është në vlerën 31.886.454 lekë nga të cilat:

-17.938.719 lekë nga bizneset private , 15.309.164 principal dhe 2.629556 leke kamat vonesa;

- 3.478.382 lekë nga taksa e tokës;

-10.469.353 lekë nga taksa familjare;

Vlera e borxhit të vitit 2021 deri në 31.12.2021 është në vlerën 10.431.286 lekë nga të cilat;

-4.574.232 lekë nga bizneset private;

-1.790.211 lekë nga taksa e tokës bujqësore;

-4.066.843 lekë nga taksa dhe tarifa familjare.

Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, nga bizneset, nga ana

e zyrës së planifikimit të të ardhurave, Bashkia Tepelene me shkresën nr. 2416 date 08.11.2020 ka njoftuar te gjitha bankat e nivelit të dytë (për bllokim llogarish bankare) dhe Zyrën e Regjistrimit të pasurive për subjektet debitorë sipas listës së mësipërme. Nuk kanë vazhduar më tej procedurat për të dërguar shkresa për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Për më tej nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

Kriteri: -Ligji nr. 95/2018 ò për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, òPër sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c;
-VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 ò Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim, pika 5;
-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, kreu XI, Neni 89, 90, 91.

Impakti: Mos realizimi i të ardhurave, mos vjelja e detyrimeve etj., ka impakt negativ në mungesën e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve..

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në arkëtimin e detyrimeve nga debitorët.

Rëndësia: **E lartë**

Rekomandimi: Për taksat dhe tarifatat e tjera vendore: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Tepelenë të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **31.886.454 lekë**, dhe të ndjek veprimet e mëposhtme:

-Të vazhdoj më tej procedurat për të dërguar shkresa për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

-Gjithashtu për të vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve dhe në kallëzim penal sipas kërkesave të nenit 89,90,91 dhe 93, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ò Për Procedurat tatimore në R.SHö ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

1. Z.R. H., me detyrë specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik Tatim Taksat
2. Z.G.G., me detyrë specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik Tatim Taksat

Mbi taksën e ndikimit në infrastrukturë

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, òPër sistemin e taksave vendore, i ndryshuar , neni 9, pika 3/c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 ò Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim, pika 5 .

Në Bashkinë Tepelenë struktura që administron dokumentacionin dhe përllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipër cituara për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është i Drejtorisë së Kontrollit Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Aneksi 2.2.3. bashkëlidhur specifikon familjarët që kanë përfituar certifikatën e pronësisë nga legalizimi si dhe përllogaritja e detyrimit përkatës.

Titulli i gjetjes 3: Mbi mos vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.

Situata: Referuar shkresave që ASHK ka dërguar në Bashkinë Tepelenë, për vitin 2020 dhe 2021 janë legalizuar gjithsej 102 objekte për të cilat DKPZHT ka llogaritur detyrimin për taksën e ndikimit në infrastrukturë në shumën **2,163,842 lekë**. Për vitin 2020, janë legalizuar 24 objekte me vlerë totale detyrimi ndaj bashkisë 371,747 lekë, nga të cilët kanë paguar detyrimin ndaj bashkisë 21 subjekte dhe janë debitor 3 subjekte për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet e bëra në vlerën totale prej **70,394 lekë**. Për vitin 2021, janë legalizuar 78 objekte me vlerë totale detyrimi ndaj bashkisë është 1,792,095 lekë, nga të cilët kanë paguar detyrimin ndaj bashkisë 60 subjekte dhe janë debitor 18 subjekte për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet e bëra në vlerën totale prej **516,676 lekë**. Vlera e debitorëve nga mos pagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë llogaritur në vlerën **587,070 lekë, përbën të ardhura të munguara** në buxhetin e Bashkisë Tepelenë.

Kriteri: -Ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, òPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeò i ndryshuar, neni 23.
-VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 ò Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizimò, pika 5;
-Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, kreu XI, Neni 89, 90, 91.

Impakti: Mos realizimi i të ardhurave, mos vjelja e detyrimeve etj., ka impakt negativ në mungesën e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve..

Shkaku: Mos respektimi e kuadrit ligjorë nga peronat përgjegjës.

Rëndësia: **E lartë**

Rekomandimi: Drejtorja e Kontrollit Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Policinë Bashkiake të marrë plotësisht masa me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtoria Rajonale Gjirokastër për vlerën debitore **587,070 lekë** në mbështetje të Ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, òPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeò i ndryshuar, neni 23, dhe Vendimin e Këshillit të VKB nr.26, datë 30.04.2020, me vendim nr.88 datë 28.12.2019, për disa ndryshime në VKB nr.74, datë 28.12.2018 òPër miratimin e taksave dhe tarifave vendoreò.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Z. L.B., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.

Për sa është trajtuar më lart (pika 2 e Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 11 datë 13.05.2022, protokolluar në subjekt me nr. 484/12, datë 13.05.2022. Nga subjekti nuk janë paraqitur observacione për sa është trajtuar në këtë pjesë të PRA.

Titulli i gjetjes 4: Mbi aplikimin e tarifës për lejet dhe autorizimet për subjektet që tregtojnë hidrokarbure.

Situata: Sipas evidencës së paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Tepelenë dhe Njësive Administrative, u audituan evidencat mbi pagesat për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, për periudhën objekt auditimi, mbështetur në legjislacionin e taksave dhe tarifave vendore, vendimeve të Këshillit Bashkiak, si dhe procedurave ligjore për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për Licencë karburanti, (Autorizim), sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave Vendoreò, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò, kapitulli II, pika 1; germa òbò, dhe pika 10, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017.

Në Bashkinë Tepelenë gjatë periudhës objekt auditimi 2020-2021 kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 7 subjekte nga të cilat për vitin 2020 janë pajisur me Autorizim/Licencë nga Bashkia Tepelenë të 7 subjektet dhe për vitin 2021 vetëm 6 subjekte, të cilët nuk kanë likuiduar detyrimin e plotë sipas përcaktimeve të VKM nr.344, datë 19.04.2017 pasqyruar si në tabelën në aneks 2.2.3.3.

- Nga të dhënat e pasqyrës si më sipër konstatohet se edhe pas angazhimit të Bashkisë Tepelenë me akt marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve nga posedimi i licencën për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, 6 subjekte nuk kanë likuiduar detyrimin e plotë sipas tarifave në vlerën **3,930,000 lekë** të cilat janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave Vendoreò, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa òbò, dhe pika 10, i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa òbò dhe pika 9, si dhe pika 15.2, të këtij akti normativ.

Kriteri: - ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave Vendoreò, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò, kapitulli II, pika 1; germa òbò, dhe pika 10, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017, ku citohet se:

II. Proceduara për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të

karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjete, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundor
1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjete, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundor, bëhet nga:

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundor, do të ndërtohen në territoret e tjerë.

9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjete, dhe vajrave lubrifikante është 5,000,000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjerë.

- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.

"9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjete dhe vajra lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjerë."

10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundor, është 1,000,000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 200,000 (dyqind mijë) lekë, për bashkitë e tjerë.

- Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: me vkm nr.344, dt. 19.4.2017.

"10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundor, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjerë."

"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjete, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundor.

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

Impakti:

Mos realizimi i të ardhurave, mos vjelja e detyrimeve etj., ka impakt negativ në mungesën e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve..

Shkaku:

Mos zbatimi i kuadrit ligjor.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi:

Bashkia Tepelenë të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej

3,930,000 lekë, për 6 subjektet që tregtojnë karburant me pakicë dhe që janë të pa pajisur me autorizim/licencë, për tregtimin e karburanteve kundrejt tarifës së përcaktuar në VKM nr.970, datë 02.12.2015 ndryshuar me VKM nr.344 datë 19.04.2017.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

1. Z.R. H., me detyrë specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik Tatim Taksat
2. Z.G. G., me detyrë specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik Tatim Taksat

Për sa është trajtuar më lart (pika 2 e Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 8 datë 13.05.2022, protokolluar në subjekt me nr. 484/9, datë 13.05.2022. Nga subjekti nuk janë paraqitur observacione për sa është trajtuar në këtë pjesë të PRA.

Titulli i gjetjes 5: Mos aplikimi i saktë i tarifave vendore mbi subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në prokurimet e fondeve publike.

Situata: Nga Drejtoria e Taksave të të Ardhurave Vendore Bashkia Tepelenë, nuk është vepruar, për të arkëtuar tarifën e pastrimit, të ndriçimit dhe tarifën e gjelbërimit për 9 nga 11 subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike, për periudhën e auditimit 2020-2021 sipas paketës fiskale Vendimit të Këshillit të Bashkisë Tepelenë me vendim nr.88 datë 28.12.2019, vendimi nr.74 datë 28.12.2018 *oPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendore*, dhe Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 *oPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe udhëzimit përkatës nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar 43.1. Këto 9 subjekte si në aneksin 2.2.3.4 bashkëlidhur këtij projekt raporti, janë debitorë në vlerën **984,000 lekë**, gjë që ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Tepelenë.

Kriteri:

- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *oPër sistemin e taksave vendore* i ndryshuar, Kreut VII, neni 35.
- Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 *oPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe udhëzimit përkatës nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar 43.1
- Vendimit të Këshillit të Bashkisë Tepelenë nr.88 datë 28.12.2019, vendimi nr.74 datë 28.12.2018 *oPër Miratimin e taksave dhe Tarifave Vendore*.

Për vitin 2020.

Pika II Tarifa e pastrimit për subjektet e ndërtimit sipas investimit dhe i kantierit të ndërtimit

- për vlera investimi deri 5,000,000 lekë = 20,000 lekë/kantier/vit
- për vlera investimi 5,000,001-15,000,000 lekë = 30,000 lekë/kantier/vit
- për vlera investimi 15,000,001-25,000,000 lekë = 50,000 lekë/kantier/vit
- për vlera investimi 25,000,001-50,000,000 lekë = 70,000 lekë/kantier/vit
- për vlera investimi 50,000,001-100,000,000 lekë = 90,000 lekë/kantier/vit
- për vlera investimi 100,000,001-200,000,000 lekë = 100,000 lekë/kantier/vit
- për vlera investimi mbi 200,000,000 = 150,000 lekë/kantier/vit

Pika II.2 Tarifa e ndriçimit

- për subjekte ndërtuese = 8,000 lekë/vit/njësi

Pika II.3 Tarifa e gjelbërimit

- për subjekte ndërtuese = 8,000 lekë/vit/njësi

Në zbatim të nenit 43 pika 1/1 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, kontraktori përpara fillimit të punimeve duhet të aplikojë në QKB për hapjen e vendit të ushtrimit të veprimtarisë të ndryshëm nga selia (sipas vendndodhjes të objektit të kontratës). Këto subjekte janë në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1 *“Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia”*.

Impakti:	Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tepelenë, nga mos aplikimi i tarifave vendore për kantier ndërtimi dhe tarifave të pastrimit mbi subjektet që kanë kryer punime publike dhe që janë të identifikuar.
Shkaku:	Mos zbatimi i paketave fiskale dhe kuadrit ligjor.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Bashkia Tepelenë të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej 984,000 lekë , referuar kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike për periudhën 2020-2021 dhe nuk janë ngarkuar me detyrimet për tarifave të pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë Tepelenë nr.88 datë 28.12.2019, vendimi nr.74 datë 28.12.2018 <i>“Për Miratimin e taksave dhe Tarifave Vendore”</i> .

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

1. Z.R. H., me detyrë specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik Tatim Taksat
2. Z.G. G., me detyrë specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik Tatim Taksat

Mbi administrimin e aseteve dhe lidhjen e kontratave për dhënien më qira të tyre me subjektet fizik dhe juridik

Bashkia Tepelenë në procesin e ligjshëm të administrimit të aseteve në pronësi apo në përdorim dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre, prej vitit 2011 e në vazhdim ka lidhur 31 kontrata për dhënien me qira të këtyre aseteve, subjekteve të ndryshëm fizik dhe juridik që kanë shprehur interes, për një afat kohor që shkon nga 1 vit deri në 99 vjet, nga të cilat 3 kontrata lidhur me operatorët e telefonive celulare, 3 kontrata janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore për ndërtimin e HEC-ve, 1 kontratë është lidhur për dhënien me qira të një godine për bar-kafe, 1 kontratë për dhënien me qira të fondit kullimore për ngritje thertore, 11 kontrata janë

lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqes për kultivimin e bimëve medicinale dhe pemëve frutore si dhe 10 kontratat për zhvillimin e aktiviteteve turistike.

Grupi i auditimit i ka vlerësuar për ti audituar të gjitha dosjet e kontratave të qerasë, kjo duke vlerësuar popullatën e vogël të shqyrtimit. Si e tillë më poshtë po renditim të detajuara të gjithë kontratat në të cilat, si dhe mangësitë që janë konstatuar në lidhje me formën dhe përmbajtjen e tyre, si dhe respektimin e kushteve të kontratës në lidhje me arkëtimin e vlerës së qerasë në dobi të bashkisë në cilësinë e qiradhënesit:

Titulli i gjetjes 6: Mos arkëtim i detyrimeve kontraktore për dhënien me qira të aseteve të Bashkisë Tepelenë.

Situata: -Në disa kontrata nuk janë zbatuar kushtet e kontratës që përcakton mënyrën, kohën e pagesës së qerasë, si dhe pasojat kur shkelin detyrimet e përcaktuar në kontratë për mos shlyerjen në kohë të qeras, si dhe nuk është aplikuar sanksion për ndërprerjen e njëanshme të saj në rastet e parashikuar nga kontrata konkrete, veprime të cilat kanë sjell të ardhura të munguara të pamatshme në buxhetin e bashkisë.

-Në disa kontrata nuk është zbatuar penalteti i parashikuar në kontratë për kamatë vonesën në rastet kur qiramarrësi nuk likuidon në kohë detyrimin, nga 0.01% në ditë, por jo më shumë se 10% e vlerës së detyrimit përkatës.

-Kontratat e lidhura midis Bashkisë Tepelenë me subjektin I. SHPK, janë në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 *ōPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveō*, Lidhja nr. 2, Pika nr. 11. Kontrata e qerasë është lidhur midis palëve duke llogaritur çmimin prej 145,000 lek/km/vit, ndërkohë që çmimi sipas legjislacionit është 175,000 lek/km/vit. Diferenca e vlerës që duhet të kishte kontrata prej 394,588.2 lek/vit me vlerën e nënshkruar prej 327,105 lek/vit përbën **dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit në masën **151, 542 lekë**.

-Nga Bashkia Tepelenë nuk është zbatuar neni 13.2, për zgjidhjen e njëanshme të kontratës, pasi rezulton se 8 subjekte si aneksi 2.2.3.5 bashkëlidhur këtij projekt raporti, nuk kanë derdhur në arkën e bashkisë detyrimin e qerasë vjetore siç është parashikuar në nenin 5, pika 5.1 të kontratës së lidhur me Bashkinë Tepelenë nga momenti i lindjes së detyrimit dhe deri në 31.12.2021 vlerën prej **394,372 lekë**, e cila përbën **të ardhura të munguara** në buxhetin e Bashkisë, (prej të cilave 358,520 lekë detyrim qira, dhe 35,852 lekë kamatë vonesë).

-Formulimi i kontratave të qerasë me këto subjekte, në disa raste, vendos në kushte të pafavorshme qiradhënesin në raport me qiramarrësin, duke mos përcaktuar qartë kushtet kontraktuale, dhe penaltetet në rastet kur shkelet ajo nga qiramarrësi.

-Kontratat e qerasë të lidhura me subjektet qiramarrëse të aseteve pronë e bashkisë në 7 raste nuk kanë parashikuar si klauzolë aplikimin e kamatë vonesës apo penaltetet, në rastet e mos pagimit në afat të qerasë, si dhe në 4 raste nuk kanë parashikuar zgjidhjen e njëanshme të kontratës në rastin e shkeljes së afatit të shlyerjes së qerasë.

Kriteri: - Ligjin nr. 139/2015, *ōPër Vetëqeverisjen Vendoreō*, neni 9, pika 1.2, shkronja *ōaō*, dhe pika 1.6, shkronja *ōaō*.

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, *ōPër menaxhimin financiar dhe kontrollinō*

- Kodi Civil i RSH, neni 83, paragrafi i parë.
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 òPër përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, i ndryshuar, kap VI, pikat 1,2,9,10
- VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, Lidhja nr. 2, Pika nr. 8

Impakti: Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tepelenë, nga mos arkëtimi i detyrimeve kontraktore të kontratave të dhëna me qira

Shkaku: Mos zbatimi i detyrimeve kontraktore.

Rëndësia: **E lartë**

Rekomandimi: Bashkia Tepelenë të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej **394,372 lekë**, për subjektet debitore ndaj detyrimeve kontraktore të shfrytëzimit me qira të aseteve të bashkisë.

Bashkia Tepelenë të marrë masa për arkëtimin e diferencës së vlerës që duhet të kishte kontrata me qiramarrësin I. SHPK në shumën **151, 542 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

1. Znj. J.K., me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative
2. Z.G. Sh., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Rural
3. Z.M. Sh., me detyrë Përgjegjës në sektorin e administrimit të pyje, kullota, mbrojtjes së tokës dhe ujërave

Për sa është trajtuar më lart (pika 2 e Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 10 datë 13.05.2022, protokolluar në subjekt me nr. 484/11 datë 13.05.2022. Mbi PRA, nuk janë paraqitur observacione nga subjekti.

1.5. Të Tjera

Trajtimi i ankesës

Dokumentacioni i shfrytëzuar nga grupi i auditimit mbi trajtimin e ankesës së Z.T. drejtuar KLSH në rrugë elektronikë të Drejtorit të DNJQV, konsistojnë në;

- Kontrata noteriale e dhënies me qira për subjektin fizik K. K. me Bashkinë Tepelenë me nr. 1045 rep., datë 08.08.2018, për dhënien me qira të tokës bujqësore të pandarë për kultivim bimë etero vajore dhe vreshta në pronësi të Bashkisë Tepelenë;
- Kontrata noteriale e dhënies me qira për subjektin Z.T. SHPK me nr. 935 rep., datë 24.07.2019 për ngritjen e fermës bujqësore për kultivim pemëtarie;
- Kontrata noteriale e dhënies me qira për subjektin Z.T. SHPK me nr. 1318 rep., datë 19.11.2020 për ngritjen e fermës bujqësore për kultivim pemëtarie, në nr e pasurisë 28/1
- Kontrata jo noteriale e dhënies me qira për subjektin Z.T. SHPK me nr.1914, datë 12.10.2021 për kultivim pemëtarie, në nr. e pasurisë 28/1
- Kontrata jo noteriale e dhënies me qira për subjektin Z. SHPK me nr.503/3, datë 19.03.2021 për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike kampingje.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin nr.1, datë 26.07.2018 òPër shpalljen e 17 zonave me përparësi zhvillimin e turizmit ne territorin e Shqipërisë në të cilën përfshihet edhe zona Vjosë ó Zagori. Në këtë kuadër dhe në zbatim të Kodi Civil i

RSH, VKM nr. 373, datë 20.6.2018 òPër përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit; VKM nr. 54, datë 5.2.2014 òPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, i ndryshuar dhe VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, Bashkia Tepelenë si burim për krijimin e të ardhurave të veta, ka zhvilluar procedurat për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, pyjeve dhe kullotave në pronësi të saj. Mbi këtë objekt, gjatë periudhës së zhvillimit të auditimit në terren, në KLSH është drejtuar një ankesë nga subjekti Z.T., të cilën grupi e ka marrë në shqyrtim.

Me qëllim ndërtimin e një resorti agroturizmi në fshatin Peshtan në zonën kadastrale nr. 2936, me propozim të MTM është miratuar VKM nr. 262, datë 11.05.2021 òPër heqjen nga fondi kullor dhe ndryshimin e statusit nga kategoria e resursit òkullotë në òtokë urbane trull të pasurisë 28/3 dhe miratimin e ndryshimit nga kategoria e resursit òtokë bujqësore në tokë urbane të pasurisë 26 në zonën kadastrale nr. 2936. Për përdorimin e sipërfaqes së sipërcituar, me qëllim zhvillimin e turizmit Bashkia Tepelenë ka nënshkruar kontratë për dhënie me qera të tokës me subjektin Z.T., konkretisht me të dhënat si më poshtë:

- Kontrata nr. Rep 935, Kol 480/4 dt 24.07.2019, ndryshuar me kontratën nr.791, datë 07.05.2021 dhe kontratën nr. Rep 420 Kol 212, datë 05.04.2022;
- Kontratën nr. Prot 1122, datë 27.07.2020, nr. Rep 1318 Kol 603, datë 19.11.2020, ndryshuar me kontratën nr. Prot 503/3, datë 19.03.2021 dhe kontratën nr. Rep 421 Kol. 213, datë 05.04.2022, me qëllim marrjen me qira të pasurisë objekt i kontratës me qëllim ndërtimin e një resorti agroturizmi.

Për shfrytëzimin e objektit të kontratës dhe vënien në përdorim të planit të biznesit, Bashkia Tepelenë ka dhënë lejen e ndërtimit nr. Z-LNM010421, datë 10.06.2021 òPër ndërtimin e resortit agroturistik në fshatin Peshtan për pasurinë nr. 26/2, 28/6, 28/7, 28/8 në zonën kadastrale nr.2936. Pretendimi i subjektit Z.T. është së realizimi i kësaj leje kufizohet nga takimi pjesërisht i hyrjes në zonën e propozuar të projektit nga qiramarrësi i pasurisë nr.50 në zonën kadastrale nr.2936, konkretisht subjekti Klajdi Kruja. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit u vu re se subjekti fizik Klajdi Kruja ka lidhur kontratë noteriale me Bashkinë Tepelenë me nr. 1045 rep., datë 08.08.2018, për dhënien me qera të tokës bujqësore të pandarë për kultivim bimë etero vajore dhe vreshta në pronësi të Bashkisë Tepelenë, me të dhënat e mëposhtme:

- Sipërfaqja 1.25 ha nga të cilat (0.37 ha Majkosh, 0.64 ha Peshtan, 0.24 ha Peshtan)
- Vendi Majkosh dhe Peshtan nr.pasurisë respektivisht 19/7, nr.50 dhe nr.78
- Afat 10 vjet/ 35 vjet/ 10 vjet
- Vlera e këstit kontraktor 12.500 lekë/vit,
- Mënyra e pagesës me nënshkrimin e kontratës dhe për periudhën vijuese pas çdo 12 muaj.
- Penalitete kamat vonesë; saka.
- Subjekt jo debitor

Njëkohësisht ankesa e subjektit Z.T. citon mos respektimin e termave kontraktor të subjektit K. K., lidhur me realizimin e mbjelljeve të kulturave bujqësore brenda afatit të përcaktuar në plan biznes.

Gjatë shqyrtimit të evidencave të subjektit lidhur me planet e monitorimit si dhe gjatë intervistës me punonjësit përgjegjës, u vu re se Bashkia Tepelenë nuk ka miratuar programe pune për monitorimin e respektimit të termave kontraktor për të 31 kontratat efektive.

Titulli i gjetjes 7: Mos respektim i termave kontraktor të shfrytëzimit me qera të aseteve të Bashkisë.

Situata: -Bashkia Tepelenë në cilësinë e palës qiradhënëse të aseteve në pronësi të saj, nuk ka miratuar programe pune për monitorim nga njësia e inspektimit në terren lidhur me zbatimin e termave kontraktor si: mbjelljet e kulturave sipas llojit të përcaktuar në planet e biznesit dhe respektimit të afatit kohorë të mbjelljeve shoqëruar me kontrollin e shlyerjes së detyrimeve financiare për secilën kontratë.

-Bashkia Tepelenë nuk ka aplikuar në asnjë nga rastet e 31 kontratave efektive penalitetet e mos respektimit të termave kontraktor;
Në rastet e mos respektimit të termave kontraktual, Bashkia Tepelenë nuk ka dërguar asnjë njoftim të zgjidhjes së njëanshme të kontratës së qiradhënies së aseteve në pronësi të saj.

Kriteri: -Ligjin nr. 139/2015, ÷Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 9, pika 1.2, shkronja ÷a, dhe pika 1.6, shkronja ÷a.

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin

-Kodi Civil i RSH, neni 83, paragrafi i parë.

-VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ÷Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, i ndryshuar, kap VI, pikat 1,2,9,10

Impakti: Të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tepelenë, nga mos arkëtimi i detyrimeve kontraktore të kontratave të dhëna me qira

Shkaku: Mos zbatimi i detyrimeve kontraktore.

Rëndësia: **E lartë**

Rekomandimi: -Kryetari i Bashkisë Tepelenë të marrë masa për të miratuar programe pune për njësinë e inspektimit në terren lidhur me zbatimin e termave kontraktor si: mbjelljet e kulturave sipas llojit të përcaktuar në planet e biznesit dhe respektimit të afatit kohorë të mbjelljeve shoqëruar me kontrollin e shlyerjes së detyrimeve financiare për secilën kontratë.

-Bashkia Tepelenë në rastet e dhënies me qira të aseteve të aplikoj në kontratë në mënyrë eksplicite penalitetet e mos respektimit të termave kontraktor nga palët.

-Në rastet e mos respektimit të termave kontraktual, Bashkia Tepelenë të dërgojë njoftim të zgjidhjes së njëanshme të kontratës së qiradhënies së aseteve në pronësi të saj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

1. Z.G. Sh., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Rural
2. Z.M. Sh., me detyrë Përgjegjës në sektorin e administrimit të pyje, kullota, mbrojtjes së tokës dhe ujërave
3. Z.R. H., me detyrë specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik Tatim Taksat
4. Z.G. G., me detyrë specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik Tatim Taksat

Për sa është trajtuar më lart (pika 2 e Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 13 datë 13.05.2022, protokolluar në subjekt me nr. 484/14, datë 13.05.2022. Nga subjekti nuk janë paraqitur observacione.

II.2.3. Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare të vitit 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit

financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022

II.2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

Konkluzion: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bankës (për periudhat nëntor dhe dhjetor, për vitet 2020 dhe 2021), të pasqyruara në aneksin nr. 3.1.1 dhe 3.1.2, ka rezultuar se nga Bashkia Tepelenë, kryerja e shpenzimeve është kryer në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296/2010, neni 4, pika 26 "Dokument financiar", ku cilësohet: *“Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna. Dokumenti elektronik rregullohet me ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010 "Për dokumentin elektronik", si dhe për aktivet, sipas kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, Kapitulli III, ku cilësohet:*

“Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim dhe grupohen në:

a. Dokumente autorizues - janë ato dokumente që autorizojnë kryerjen e një veprimi të caktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Te tilla janë urdhrat e blerjeve, kontratat, urdhri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj.

b. Dokumente vërtetues - vërtetojnë kryerjen në fakt, dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet, mandat arkëtimet, mandat pagesat, procesverbalet, dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.

c. Dokumente të kontabilitetit - janë dokumentet përmbledhës ose regjistrat kontabël (libri i madh, librat analitike, kartelat e aktiveve, etj.) të çdo lloj forme 11, bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

Bashkëngjitur urdhër shpenzimeve ishte dokumentacioni si: (kontrata, fatura, situacione, fletë hyrje, fletë dalje, akt marrje në dorëzim, akt kolaudimi, etj.).

II.2.3.2 Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

Bashkia Tepelenë me shkresën nr. 424 prot., datë 24.02.2021 i ka dërguar Degës së Thesarit Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2021, brenda afatit të Udhëzimit të MFE nr. 5, datë 21.02.2022, ÷Disa ndryshime në Udhëzimin e MFE-s për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshmeö pika 25.

Plotësimi dhe hartimi i pasqyrave fiannciare të Bashkisë Tepelenë, paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin e saj financiar më datë 31.12.2021. Nga grupi i auditimit

u shqyrtuan të gjitha pasqyrat financiare, nga ku ka rezultuar se janë pasqyruar të gjitha transaksionet financiare (sipas Aneksit nr. II.2.3.2 ëPasqyrat financiare të Bashkisë Tepelenë, 31.12.2021), ku:

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 2,312,234,350 lekë.

- Aktivet 2,312,234,350 lekë
- Pasivet 178,708,797 lekë
- Aktivet neto 2,133,525,553 lekë

Nga auditimi u evidentuan mangësitë e mëposhtme:

Mbi Aktivet afatgjata financiare

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të viti 2020 me vlerën 0 lekë dhe në fund të vitit 2021 në vlerën 0 lekë. Ky seksion i bilancit kontabël për vitet 2020 dhe 2021 është paraqitur në vlerën 0 lekë siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të paraqitur më poshtë:

Nr. Reshti	Referenca E Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhënie e Nën huadhënie	0	0
61	26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet	0	0

Burimi: Bashkia Tepelenë

Titulli i Gjetjes 1: Mbi kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2021.

Situata:

Bashkia Tepelenë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 05/01/2021 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Tepelenë SHA me NUIS ëK29009502Gë e cila është shoqëri aksionere me objekt aktiviteti ëShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyreë. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqië. Numri i aksioneve është 1,00 me vlerë nominale 510,086,359 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 510,086,359 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Tepelenë në ëUjësjetllës Kanalizime Tepelenë SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2021, më konkretisht në llogarinë 26 ëPjesëmarrje në kapitalet e vetaë që përfaqëson aksionet me vlerë kontabël (kosto) 510,086,359 lekë dhe investitori është Bashkia Tepelenë.

Kriteri:

Udhëzimi nr. 8/2018, i ndryshuar, Kapitulli III, pika 31, ku cilësohet se:

“Aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre. Lidhur me këto aktive, njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të analizojnë e të rakordojnë investimet e tyre eventuale që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e ndërmarrjeve të

tjera (publike ose jopublike). Për këtë qëllim, çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme duhet të saktësojë regjistrimet kontabël në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar”.

Impakti: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 26 ÷ Pjesëmarrje në kapitalin e vetë, gjendje kjo e nën vlerësuar me 510,086,359 lekë.

Shkaku: Mosveprim nga ana e Drejtorisë së Financës.

Rëndësia: I mesme

Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues, në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, të përfshihet sistemimi në kontabilitet, mbi regjistrimin e pjesëmarrjes, sipas përqindjes së përcaktuar në aktet ligjore, në kapitalin aksionar të ÷ Ujësjetës Kanalizime Tepelenë SHA, me vlerë kontabël 510,086,359 lekë.

Mbi Aktivet e Afatgjata Materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 ÷ Aktivet Afatgjata Materiale", AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, paraqiten në shumën 1,932,586,987 lekë (me vlerë neto). Në vitin paraardhës 2020, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,473,396,444 lekë (me vlerë neto), me një shtesë të AAM-ve në shumën 486,241,714 lekë, si dhe të pakësimeve të AAM-ve për 27,111,171 lekë që kanë ardhur kryesisht si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimit të AQT dhe llogaritja e amortizimit për AQT në Bashki.

Duke analizuar veprimet e shtesave dhe pakësimeve të AAM-ve sipas të dhënave të siguruar nga zyra e financës si në tabelën më poshtë:

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2020	SHTESA	PAKSIME	Gjendja me 31.12.2021
1	210	Toka, troje, Terene	145,030,295	49,524,229	0	194,554,524
2	211	Pyje, Kullota Plantacione	237,999,902	422,589,396	0	660,589,298
3	212	Ndertime e Konstruksione	315,436,472	7,097,250	0	322,533,722
4	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	754,247,116	0	26,764,645	727,482,471
5	214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	6,930,526	0	346,526	6,584,000
6	215	Mjete transporti	2,920,256	910,948		3,831,206
7	218	Inventar ekonomik	10,831,675	6,119,891		16,951,766
		TOTALI	1,473,396,444	486,241,714	27,111,171	1,932,586,987

Burimi: Bashkia Tepelenë

- Llogaria. 210 ÷ Toka, Troje, Terene është në vlerën 194,554,524 me 31.12.2021, me një ndryshim në shtesë për 49,524,229 si rrjedhojë e regjistrimit të pasurive në ASHK.
- Llogaria 211 ÷ Pyje, Plantacione paraqitet më 31.12.2021 (me vlerë neto) 660,589,298 lekë me një shtesë prej 422,589,396 lekë, ardhur nga regjistrimi i pasurive në ASHK.
- Llogaria e aktivitetit 212 ÷ Ndërtesa dhe konstruksione e cila pasqyron gjendjen e aseteve për llogari të Bashkisë, në fund të vitit 2020 rezulton me një kosto historike 406,093,379 lekë dhe në fund të vitit 2021 rezulton me një kosto historike 430,166,088 lekë, me një shtesë prej 24,072,709 lekë nga investimet e kryera dhe të përfunduara gjatë vitit 2021.

Pasqyra e aseteve të regjistruara dhe të paregjistruara

Nr	Llog	Asete gjithsej në kontabilitet	Te regjistruara në ASHK	Te pa regjistruara
----	------	--------------------------------	-------------------------	--------------------

1	210 òToka,troje,terreneö	117	108	9
2	211 òPyje,kullota,plantacioneö	25	23	2
3	212 òNdërtesa,konstruksioneö	79	2	77
4	213 òRruge,rrjete,vepra ujoreö	85	0	85

Regjistrimet sipas viteve:

Vitet	2019	2020	2021
Toka,troje,terrene	58	26	24
Pyje,kullota,plantacione	5	7	11

Titulli i Gjetjes 2: Aktivët Afatgjata Materiale mbi saktësinë, plotësinë dhe përkatësinë e vlerave të tyre në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2021.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, nga objektet inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 391,047,353 lekë, objektet nuk janë pajisur me titull pronësie, nuk janë regjistruar në hipotekë, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë:

- llog 210 òToka troje terreneö, 9 elementë në vlerën neto 74,573,778 lekë
- llog. 211 òPyje plantacioneö, 2 elementë në vlerën neto 196,200 lekë,
- llog. 212 òNdërtesa e konstruksioneö, 77 objekte me vlerën neto 316,277,375 lekë
- llog. 213 òRrugë, rrjete, vepra ujoreö, 85 objekte me vlerë neto 727,482,471 lekë

Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

VKM nr. 510, datë 10.06.2015 òPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorialö, Kreu VI òTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshmeö, VKM nr.433, datë 8.6.2016 òPër transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkiveö.

Impakti: Paraqitja në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse inventariale, pa kryer më parë njohjen e pronës dhe statusin juridik të saj, lë hapësirë për interpretim jo të saktë të vlerës së pasqyruar në bilanc.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

Rëndësia: E mesme

Titullari i Bashkisë Tepelenë të marrë masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së Aktiveve Afatgjata Materiale për llogari të Bashkisë Tepelenë.

Rekomandimi:

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë më 31.12.2021, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2021, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2021, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj.,

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2021 është në vlerën 25,457,997 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia më 31.12.2021.

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë, paraqitet në vlerën 7,990,014 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit Dhjetor për t'u paguar në muajin Janar të vitit pasardhës.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 390,522 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për detyrimet e muajit Dhjetor 2021 të cilat do të paguhen në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për muajin Dhjetor 2021 2,362,566 lekë.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 7,600,823 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 7,600,823 lekë.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime gjyqësore, investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2021 paraqiten në shumën 13,722,520 lekë.

Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”, paraqitet me tepricë kreditorë në vlerën 6,001,282 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia trashëgon për t'u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen.

Pasqyra e Performancës financiare (F2)

-Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë më datë 31.12.2021 janë të kuadruara me Degën e Thesarit, konkretisht:

Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Dif
Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	55,280,393	Akt rakordimi me Degën e Thesarit	55,280,394	0
Granti nga buxheti	270,666,480	Sipas çeljes së buxhetit nga MFE	270,666,480	0
Financim i pritshëm nga buxheti	29,637,033	Sipas llogarisë 7206	29,637,033	0
Totali të ardhurave	355,583,906	Totali të ardhura	355,583,906	0

Burimi: Bashkia Tepelenë

Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2020	Detyrime të vitit 2021	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	121,795,763	7,895,699	7,990,014	121,890,078
601	18,483,285	4,518,790	3,076,625	17,041,120
602	67,315,201	16,097,756	18,008,000	69,225,445

604	5,584,229	0	0	5,584,929
606	136,167,557	0	0	136,167,557
63	0	0	0	-326,505
Totali	349,346,735	28,512,245	29,074,639	349,582,624

Burimi: Bashkia Tepelenë

-Diferenca në shumën 326,505 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe sipas Situacionit përbëhet nga diferenca e vlerës prej 326,505 lekë "Ndryshimi i gjendjes së inventarit".

-Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 ÷shpenzimetö dhe klasës 7 ÷të ardhuratö, janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 ÷Rezultati i veprimtarisë ushtrimoreö, konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	355,583,906	355,583,906	0
II	Shpenzime	349,582,624	349,582,624	0
III	Rezultati i vitit ushtrimor	6,001,282	6,001,282	0
IV	Rezultati i vitit ushtrimor	6,001,282	6,001,282	0

Burimi: Bashkia Tepelenë

-Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën **6,001,282 lekë**, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare.

Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Nr. Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	13,602,105	5,647,524
II	Veprimtaritë e investimeve	0	0
III	Transferata e të tjera	-3,793,110	-67,136,270
IV	Teperica në fillim të vitit ushtrimor	5,647,524	906,755
V	Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	13,602,105	5,647,524

Burimi: Bashkia Tepelenë

-Nga kontrollet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2021, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën **13,602,105 lekë** dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Disponibilitet në Thesarö Llog 520" e cila paraqitet në shumën **13,602,105 lekë**.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.6 ÷Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetareö.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)

Referenca	EMËRTIMI	Fonde bazë dhe Grante	Fonde të tjera të veta	Rezultatet e Mbartura Tepricë/Deficit	Rezultatet e Ushtrimit Tepricë/Deficit	GJITHËSEJ Aktive/neto
		Kapitale				Fonde/ Neto
101	I.AKTIVET NETO/FONDET NETO	1,494,534,976				1,494,534,976
	II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)	X	X	0	638,990,577	638,990,577
	I.LNGA BURIME TE BRENDSHME	X	X	0	611,139,018	611,139,018
105	Nga grantet e brendshme kapitale (+)	X	0	X	191,981,961	191,981,961
1016;1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)				27,851,559	27,851,559
12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)					
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)	X	X		6,001,282	6,001,282

1013	Nga konsumi i AAGJ(-)				-51,564,130	-51,564,130
1015	Nga nxjerrjet jashtë përdorimit dhe dëmtimet (-)				-7,393,720	-7,393,720
109	Nga rivlerësimi AAGJ (+,-)				472,113,625	472,115,625
	TOTALI	1,494,534,976	X	0	638,990,577	2,133,525,553

Burimi: Bashkia Tepelenë

-Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën **2,133,525,553 lekë**. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

-Vlera prej 697,948,427 lekë, përfaqëson gjithë shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101 "Fonde bazë".

-Vlera prej 58,957,850 lekë, përfaqëson amortizimin vjetor dhe nxjerrjet jashtë përdorimit.

-Vlera prej 6,001,282 lekë, përfaqëson rezultatin financiar të vitit ushtrimor pasqyruar në llog.85 dhe llog. 12 paraqitet në shumën 2,353,360 lekë.

-Nga auditimi rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën "Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto" në shumën **2,133,525,553 lekë** kuadron me pasqyrimin e tyre në pasqyrën e "Pozicionit financiar".

Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.5 të Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto.

Konkluzion: Nga ana e Zyrës së Financës së Bashkisë Tepelenë, janë zbatuar në mënyrë të drejtë kërkesat e Udhëzimit nr. 8/2018 me ndryshime, për mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021, me përjashtim të mos pasqyrimin të pjesëmarrjes së kapitalit të vet, si rezultat i pjesëmarrjes 100% të saj në aksionet e UK Tepelenë SHA, për vlerën e aksioneve në shumën 510,086,359 lekë.

Për sa është trajtuar më lart (pika 3 e Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 4 datë 06.05.2022, protokolluar në subjekt me nr. 484/5, datë 06.05.2022. Mbi këtë Akt konstatimin dhe PRA, nuk janë paraqitur observacione.

II.2.4. Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017, Udhëzimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr.2, datë 24.04.2017 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël".

Nga Grupi i auditimit në zbatim të këtij drejtimi të Programit të Auditimit u audituan:

II.2.4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrin të prokurimeve.

II.2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

II.2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).

II.2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kushteve në kontratave të lidhura me operatorë ekonomik të shpallur fitues për mallra dhe shërbime, si dhe marrja në dorëzim e tyre sipas specifikimeve teknike.

Dokumentacioni i shqyrtuar:

- Shkresat mbi alokimin e fondeve;
- Urdhrat e Titullarit të AK;
- Procesverbalet e mbajtura nga NJP dhe KVO, etj.;
- Raporti përfundimtar;
- Korrespondenca me OE;
- Dokumentacioni i hedhur në SPE nga OE;
- Dokumentacioni bankar mbi likuidimin e situacioneve;

II.2.4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Programimi i nevojave për investime është kryer që në fazën e hartimit të projektbuxheteve vjetore për vitet 2020 dhe 2021, konkretisht:

Tabela 4.1.1 "Investimet e planifikuara në nivel objekti për vitin 2020"

Nr.	Emërtimi i programit/ objektit	Fondi limit	Financimi në vite		
			2020	2021	2022
I	Nga buxheti i shtetit				
1	Rikonstruksion sheshi Sinanaj	1,720,000	1,000,000	720,000	0
2	Blerje makineri e pajisje Sektori Gjellbërimit	1,000,000	600,000	0	400,000
3	Rikonstruksion fasada, unaza veriore dhe Llagja "Demokracia"	12,000,000	2,000,000	5000000	5,000,000
4	Rikonstruksion rruge qytet dhe blloqe banimi	8,500,000	1,500,000	3000000	4,000,000
5	Rikonstruksion fasada Rruga "Elmaz Teme"	3,700,000	1,500,000	2200000	0
6	Rruga e "Birbilenjve"	5,500,000	1,500,000	1500000	2,500,000
7	Blerje pajisje kompjuterike	500,000	500	0	0
8	Rikonstruksion godine Njësia Administrative Qendër	9,200,000	2,000,000	3500000	3,700,000
	Totali	42,120,000	10,600,000	15,920,000	15,600,000
II	Nga të ardhurat e veta				
1	Rikonstruksion fasada, unaza veriore dhe Llagja "Demokracia"	3,500,000	3,500,000	0	0
2	Blerje makine teknologjike pastrimi	4,000,000	1,000,000	1,000,000	2,000,000
3	Blerje kamionçinë për Drejtorinë e shërbimeve	960,000	960,000	0	0
4	Rikonstruksion rruge qytet dhe blloqe banimi	4,000,000	0	2,500,000	1,500,000
5	Rikonstruksion lera e përmirësim kullote	6,500,000	1,000,000	2,500,000	3,000,000
	Totali	18,960,000	6,460,000	6,000,000	6,500,000
I+II			17,060,000		

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë
Punoi: KLSH

Tabela 4.1.2 "Investimet e planifikuara në nivel objekti për vitin 2021"

Nr.	Emërtimi i programit/ objektit	Fondi limit	Financimi në vite		
			2021	2022	2023
I	Nga buxheti i shtetit				
1	Blerje kontenierë	600,000	600,000	0	0
2	Blerje makineri e pajisje Sektori Gjellbërimit	400,000	400,000	0	0
3	Blerje orendi për konviktin e nxënësve	500,000	500,000	0	0
4	Blerje kamionçinë për MZSH	960,000	960,000	0	0
	Totali	2,460,000	2,460,000	0	0
II	Nga të ardhurat e veta				
1	Rikonstruksion godine Njësia Administrative Qendër	4,000,000	4,000,000	0	0
2	Blerje pajisje kompjuterike	500,000	500,000	0	0
3	Blerje orendi për çerdhen e fëmijëve	500,000	500,000	0	0
	Totali	5,000,000	5,000,000	0	0
I+II		7,260,000	7,260,000		

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë
Punoi: KLSH

Konkluzion II.2.4.1: Në bazë të nevojave të identifikuara dhe programimit të tyre, është hartuar Regjistri i parashikimit të prokurimeve, që do të zhvillohen në dy vitet,

objekt auditimi. Regjistri i parashikimeve për prokurimet publike të vitit 2020 dhe 2021, është hedhur në sistemin SPE, Hartimi i tyre është bërë në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, neni 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik", pika 2, ku cilësohet: "Organet e pushtetit vendor, ndërmarrjet shtetërore apo çdo autoritet kontraktor tjetër, përveç atyre të parashikuara më lart, përgatitin dhe dërgojnë një përmbledhje të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike në APP, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit apo planit të blerjeve nga këshillat vendore ose nga organet drejtuese përkatëse".

Referuar regjistrin të realizimit të prokurimeve publike nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Tepelenë, ka realizuar procedurat si me poshtë:

Nr.	Lloji i procedurës	Viti 2020		Viti 2021	
		Parashikuar	Realizuar	Parashikuar	Realizuar
1	Të hapura		2		2
2	Te hapura të thjeshtuara		0		4
3	Kërkesë për propozim		2		1
4	Blerje të vogla		61		83
5	Pa procedura Ö100 mijë lekë		18		15
	Totali	94	83	127	105

Burimi i të dhënave: SPE
Punoi: KLSH

II.2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Nga Grupi i auditimit, u verifikua për të gjitha procedurat e zhvilluara dhe kontratat e lidhura, gjatë periudhës objekt auditimi, angazhimi i fondeve (llogaria 230 & 231) dhe burimi i financimit të tyre.

Bashkia Tepelenë me VKB nr. 72, datë 20.12.2019 dhe VKB nr. 80, datë 23.12.2020, ka miratuar planin e buxhetit për vitet respektive 2020 dhe 2021, si dhe ka miratuar planin e investimeve në nivel objekti dhe sipas burimit të financimit, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Viti buxhetor 2020		Viti buxhetor 2021	
	Burimi i financimit	Vlera	Burimi i financimit	Vlera
I	Transferta e pakushtëzuar	10,000,000	Transferta e pakushtëzuar	1,000,000
II	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	500,000	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	1,460,000
III	Të ardhurat e veta	6,460,000	Të ardhurat e veta	5,000,000
	Totali	16,960,000		7,460,000

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë
Punoi: KLSH

Financime gjatë vitit buxheti shtetit, viti 2020

Nr.	Procedurat realizuara (Emërtimi)	Fondi limit	Burimi i financimit
1	öRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonatödhe öRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë	111,118,889	Buxheti i Shtetit MIE, shkresa nr.1872, date 230.07.2020 dhe shkresa nr.232,date 28.01.2021
2	öRehabilitimi Kanalit Ujitës Dukaj (Pastrimi i Rezervuarit), Bashkia Tepelenë.	17,435,664	Buxheti i Shtetit MBZHR, shkresa nr. 5865, datë 22.07.2020 dhe VKM nr. 488, datë 17.06.2020
3	Mbikëqyrje Punimesh Objekti Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonatödhe öRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë	2,023,303	Buxheti i Shtetit MIE, shkresa Nr.1872,date 230.7.2020 dhe shkresa nr.232,date 28.01.2021

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë
Punoi: KLSH

Financime gjatë vitit buxheti shtetit, viti 2021

Nr.	Procedura te realizuara (Emertimi)	Fondi limit pa TVSH	Burimi i financimit
1	Drejtimi i punimeve oNdërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Ndëtimi I fshatit Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë	2,893,111	Buxheti shtetit, MIE me shkresën nr.232, date 28.01.2021
2	oNdërtim i rrjetit të jashtëm për shtimin e sasisë së ujit të pijshëm të fshatit Salari, Bashkia Tepelenë	29,082,067	Buxheti i Shtetit, MIE me shkresën nr.376,date12.02.2021
3	Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Ndëtimi I fshatit Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë	195,833,333	Buxheti Shtetit, MIE me shkresën nr.376, date 12.02.2021

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë
Punoi: KLSH

Konkluzion II.2.4.2: Referuar të dhënave të Tabelave 4.2.1 dhe 4.2.2, sa më sipër dhe tabelave anekse nr. 4.2.1 dhe 4.2.2 (pjesë e këtij akt konstatimi), në të cilat janë evidentuar të gjitha të dhënat mbi burimet e financimit për procedurat e prokurimit të zhvilluara nga AK, u konstatua se është vepruar në përputhje me LPP, me ligjin oPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHö dhe UMF nr. 9, datë 20.07.2018 oPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, me ndryshime Kapitulli III oProcedurat për kryerjen e shpenzimeve publike, me ndryshime, Kapitulli oMarrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, pika 154 ku cilësohet:

"Kërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijeni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollet e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhrin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Kërkesa për shpenzim i drejtohet nëpunësit autorizues dhe për dijeni nëpunësit zbatues".

II.2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).

Strukturat përgjegjëse për prokurimet: Titullari i Autoritetit Kontraktor "Bashkia Tepelenë", në zbatim të nenit 56 "Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar" të VKM nr. 914/2014 dhe nenit 73 "Titullari i autoritetit/entit kontraktor" të VKM nr. 285/2021, me Urdhrin nr. 13, datë 29.01.2020 dhe Urdhrin nr. 14/1, datë 19.01.2021 dhe Urdhri nr. 14, datë 19.01.2021 "Për caktimin e personave përgjegjës për prokurimin dhe administratorin e llogarisë së AK Bashkia Tepelenë", ka përcaktuar Personin përgjegjës për prokurimet, dhe anëtarët e NJP si më poshtë:

- J.K., anëtare e NJP dhe Personi përgjegjës për prokurimet në vlera të larta;
- M. Sh., anëtar i NJP
- P. L., anëtare e NJP

Autoriteti kontraktor Bashkia Tepelenë për vitin 2020 dhe 2021, ka zhvilluar procedurat e prokurimit me vlerë mbi 800,000 dhe 1,000,000 lekë, sipas llojit të procedurës si më poshtë:

Viti 2020

Lloji procedurës	Parashikuar Nr. Procedura	Realizuar Nr. procedura	Parashikuar Vlerë	Realizuar Vlerë
I hapur	2	2	128,554,553	122,791,750
Kërkesë për propozim	2	2	7,856,636	7,588,377
Total	4	4	136,411,489	130,380,127

Viti 2021

Lloji procedurës	Parashikuar Nr. Procedura	Realizuar Nr. procedura	Parashikuar Vlerë	Realizuar Vlerë
I hapur	2	2	224,915,401	222,803,548
Kërkesë për propozim	1	1	7,645,833	7,645,833
I hapur i thjeshtuar	4	4	36,211,938	21,391,855
Shërbim konsulence	1	1	2,893,111	2,833,333
Total	8	8	271,666,283	254,674,569

Autoriteti kontraktor Bashkia Tepelene për vitin 2020 dhe 2021 ka zhvilluar procedurat e prokurimit me vlerë mbi 800,000 dhe 1,000,000 lekë, sipas objektivit të kontratës si më poshtë:

Procedura të realizuara gjatë vitit 2020

Nr.	Procedurat e realizuara	Lloji Procedurës	Fondi limit	Vlera e kontratës pa TVSH
1	ōRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonatōdhe ōRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban , Bashkia Tepelenë	E hapur	111,118,889	105,375,894
2	ōRehabilitimi Kanalit Ujitës Dukaj (Pastrimi i Rezervuarit), Bashkia Tepelenë.	E hapur	17,435,664	17,415,856
3	Mbikëqyrje Punimesh Objekti Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonatōdhe ōRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë	Kërkesë për propozim	2,023,303	1,755,044
4	Blerje nafte për nevojat e Bashkisë	Kërkesë për propozim	5,833,333	5,833,333 Marzhi fitimit 5,4 %

Procedura të realizuara gjatë vitit 2021

Nr.	Procedura të realizuara	Lloji Procedurës	Fondi limit pa TVSH	Vlera e kontratës pa TVSH
1	ōBlerje Karburanti për nevoja të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe sektorit të emergjencës civileō	E hapur e thjeshtuar	2,250,000	2,242,187
2	ōRikonstruksion i rrugëve e blloqe banimi në qytetin Tepelenë ō	E hapur e thjeshtuar	10,104,067	6,546,998
3	ōRikonstruksion i fasadave në lagjen ōDemokraciaō dhe në perimetër të rrugës , dhe ndriçimi i rrugës ōE.Bilbiliō unaza veriore e qytetit Tepelenë ō	E hapur e thjeshtuar	11,916,667	6,884,300
4	ō Blerje Karburant(nafte) per vitin 2021 per nevoja te Bashkise Tepeleneō	Kërkesë për propozim	7.645.833	7.645.833 Marzhi fitimit 7,8%
5	Drejtimi i punimeve ōNdërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Ndërtimi i fshatit Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë	Shërbim konsulence	2,893,111	2,833,333
6	ōNdërtim i rrjetit të jashtëm për shtimin e sasisë së ujit të pijshëm të fshatit Salari, Bashkia Tepelenë	E hapur	29,082,067	28,914,365.
7	Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Ndërtimi I fshatit Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë	E hapur	195,833,333	193,889,182.68
8	ōRikonstruksion i rrugëve dytësore fshati Mamaj Njësia Administrative Qendërō	E hapur e thjeshtuar	11,941.564	7,718,370

Procedurat e audituara

Nr.	Procedurat e audituara (Sipas analizës risikut)	Fondi i audituar	Fondi i prokuruar
1	ōRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonatōdhe ōRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë	111,118,889	
2	ōRehabilitimi Kanalit Ujitës Dukaj (Pastrimi i Rezervuarit), Bashkia Tepelenë.	17,435,664	
3	ōRikonstruksion i rrugëve e blloqe banimi në qytetin Tepelenë	10,104,067	
4	ōRikonstruksion i fasadave në lagjen ōDemokraciaō dhe në perimetër të rrugës dhe ndriçimi i rrugës ōE.Bilbiliō unaza veriore e qytetit Tepelenë	11,916,667	
5	ōNdërtim i rrjetit të jashtëm për shtimin e sasisë së ujit të pijshëm të fshatit Salari, Bashkia Tepelenë	29,082,067	
6	"Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Ndërtimi i fshatit Peshtan-	195,833,333	

	Mezhgoran Bashkia Tepelenë		
7	oRikonstruksion i rrugëve dytësore fshati Mamaj, Njësia Administrative Qendër	11,941.564	
8	Fonde total	365,398,562	408,077,772
9	Mbulimi me auditim në %		89 %

Procedurat e mësipërme janë vlerësuar referuar VKM 914/2014 dhe VKM nr. 285/2021, neni 15, pika 3, në lidhje me paraqitjen e informacionit specifik për kontratat e punëve, pjesë e dosjes së tenderit si:

- Detyrën e projektimit;
- Leje ndërtimi;
- **Projektin Teknik;**
- **Specifikimet teknike;**
- **Relacionin teknik;**
- **Grafiku i zbatimit;**
- Oponencën teknike;
- **Përlllogaritja e fondit limit, preventiv me analizë.**

Nga auditimi ka rezultuar:

Titulli i Gjetjes 1: Mbi dokumentacionin specifik, të kontratave të punëve publike, pjesë e dosjes së tenderit.

Situata: Referuar të dhënave analitike në **Tabelën anekse nr. 4.3.1** ka rezultuar se, nga Bashkia Tepelenë, janë hartuar Detyrat e Projektimit për 6 nga 7 objektet e audituara. Nga Bashkia Tepelenë nuk është hartuar Detyra e projektimit për objektin "Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonat dhe Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë". Ky fakt është konsideruar mangësi, pasi hartimi i detyrës së projektimit është hapi i parë dhe dokumentacioni që tregon parametrat fillestar dhe termat e referencës për të zbatuar projektin. Kjo mangësi është cilësuar edhe në raportin mbi oponencën teknike të paraqitur nga Instituti i Ndërtimit, mbi këtë objekt. Realizimi i projektit është kryer nga studio projektimi, e cila duhet të bazohet dhe zbatohet detyrën e projektimit të dhënë paraprakisht. Këto verime janë në kundërshti me kriteret e mëposhtme:

Kriteri: - VKM nr. 914/2014, neni 38 "Konkursi i projektimit", ku cilësohet: *2/a. "Në rastin kur autoriteti kontraktor organizon një konkurs projektimi, ku objekti është një projektide, në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohen qartë kriteret e vlerësimit teknik, çmimi dhe/ose rimbursimet që jepen për kandidatin fitues dhe për kandidatët e tjerë të pranuar"*.

- Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", neni 23 "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike", pika 14, ku cilësohet: *"Njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë përgjegjëse për planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj"*.

Ndikimi/Efekti: Mospasja e një detyre projektimi, mund të sjellë një projekt i cili nuk plotëson kushtet, parametrat, kondicionet reale, mbi të cilat duhet të projektohet dhe zbatohet një vepër.

Shkaku: Mos veprim nga ana e Bashkisë Tepelenë.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Titullari i AK, duhet të marrë masa që në të ardhmen, të nxjerrë urdhra të specifikuar për Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, me qëllim hartimin e detyrave të projektimit dhe vënien e tyre në dispozicion të projektuesve, si dhe në rast të mungesave të burimeve njerëzore, duhet të marrë masa për kryerjen e këtij shërbimi nga të tretë.

Titulli i Gjetjes 2: Nga verifikimi mbi kërkesat, kryerjen dhe Raportin mbi oponencën teknike, për objektet e audituara.

Situata 1: Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonatò dhe òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë, me vlerë kontrate 105,375,894 lekë pa TVSH, ka rezultuar se:

- Bashkia Tepelenë me shkresën nr. 2979, datë 29.12.2020 "Kërkesë për kryerjen e oponencës teknike", i është drejtuar Institutit të Ndërtimit, për kryerjen e oponencës për objektin e mësipërm.
- Në përgjigje të kësaj kërkesë është lidhur Marrëveshje nr. 2033/1, datë 23.12.2020 midis Institutit të Ndërtimit dhe Bashkisë Tepelenë, për kryerjen e këtij shërbimi, për vlerën 275,588 lekë, mbështetur në VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit", pika 4 ku cilësohet: *"Kërkesa për oponencë teknike bëhet nga investitori. Me miratimin e kërkesës, palët lidhin një aktmarrëveshje ndërmjet tyre, kushtet e së cilës miratohen nga ministri i Punëve Publike dhe Transportit"* dhe VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave të shërbimeve në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".
- Kërkesa e Bashkisë është bërë referuar Ligjit nr.8402, date 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 6, dhe VKM nr.1055, datë 22.12.2010 "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit", pika 3, **por nuk është kryer në kohën e duhur dhe në funksion të asaj ç'ka kërkon ligji dhe VKM.** Për rrjedhojë rekomandimet e dhëna në këtë oponencë, nuk janë bërë pjesë e projektit teknik, përlllogaritjeve; shprehjes së tyre në fondin limit të përlllogaritur; specifikime teknike apo kërkesa kualifikimi, pasi procedura e prokurimit është hapur sipas formularit të njoftimit të kontratës më datë 09.10.2020, si dhe shpalljen e fituesit me datë 11.12.2020.

Situata nr. 2 Për shërbimin òKryerje e oponencës teknikeò e cila është jashtë kontekstit kohor, pra pas përfundimit të gjithë procedurës, është kryer pagesa në vlerën prej 275,588 lekë, e cila do konsiderohet shpenzim i panevojshëm, me efekt negativ financiar në të ardhurat e bashkisë.

Kriteri: Ligjit nr.8402, date 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 6, ku cilësohet: *"Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve"* dhe VKM nr.1055, datë 22.12.2010 "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit", pika 3 ku cilësohet: *"Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet*

kompetente pa kryerjen e opionencës teknike. Oponenca teknike është pjesë e dokumentacionit teknik të projektit".

- Ndikimi/Efekti:** Kërkesa për opionencë dhe kryerja e opionencës teknike, nuk i kanë shërbyer qëllimit për çfarë kërkohet dhe është e dobishme një opionencë teknike, përmirësim projekti e më tej.
- Shkaku:** Mosveprim në kohën e duhur nga ana e Bashkisë Tepelenë dhe strukturave përgjegjëse.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandim:** -

Titulli i Gjetjes 3: Mungesë e opionencave teknike.

Situata 1: Nga auditimi ka rezultuar se nga Bashkia Tepelenë, nuk është kërkuar opionencë teknike për 1 subjekt gjatë vitit 2021, duke vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore, si dhe për të cilat sipas ligjit 120/2020 aplikohet penalitet, në shuëm 1,000,000-3,000,000 lekë.

Kriteri: Ligjit nr.120/2020, "Për disa ndryshime në ligjin nr.8402/1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 6, ku cilësohet:
1. Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:

a) ndërtimet publike;

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;

c) objektet me akses publik.

2. Për çdo rast, institutet shtetërore ose entet e tjera, që kryejnë opionencën teknike, janë solidarisht përgjegjëse me projektuesin për çdo dëm që rrjedh si pasojë e gabimeve ose të metave të opionencës teknike, si dhe mbajnë përgjegjësi administrative ose penale, sipas rastit, për shkeljen e legjislacionit në fuqi. Rregullat për projektet, që duhet t'i nënshtrohen opionencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Ndikimi/Efekti: Kërkesa për opionencë dhe kryerja e opionencës teknike, mund të sjellë në zbatimin të projektit, cilësinë e objektit dhe punimeve në tërësi.

Shkaku: Mosveprim nga ana e Bashkisë Tepelenë, e cila ka paraqitur si shkak pa mjaftueshmërinë e fondeve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1: Titullari i Bashkisë, të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive, si dhe me qëllim shmangien e rasteve të tilla, të marrë masa për hartimin e gjurmës së auditimit/hartës së proceseve, për opionencën dhe miratimin e procedurave mbi marrjen e opionencave teknike për objektet që do të ndërtohen në vazhdimësi, ku të përcaktohen qartë, strukturat përgjegjëse, grupet apo specialistët përkatës që do të kryejnë këtë proces, si dhe të përcaktohen qartë periodat kohore mbi kërkesën dhe marrjen e këtij shërbimi, nga të tretët.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë z. T.P., në cilësinë e investitorit.

Nga verifikimi mbi "Përlllogaritjen e fondit limit", u konstatua:

Konkluzion:

1. Nga NJP, për të gjitha procedurat e audituara janë mbajtur procesverbalet përkatëse për verifikimin e fondit limit dhe vendosjen e kushteve të specifikimeve teknike të tenderit (pjesë e dosjes së tenderit), ku janë shprehur se: *“Nga analiza zë për zë e zërave të punimeve të parashikuara në preventivin e administruar rezulton se është sipas manualit në fuqi. Preventivi është shoqëruar me analizat e çmimeve për çdo zë të preventivit që nuk është në manual. Gjithashtu dhe specifikimet teknike janë korrekte dhe ju përgjigjen kërkesave të projektit dhe bazës ligjore në fuqi për prokurimet”*.

2. Nga auditimi me zgjedhje i disa zërave të punimeve, me peshën specifike më të lartë kundrejt vlerës totale të kontratave sipas **tabelave anekse nr. II.2.4.3.2**, ka rezultuar se për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është vepruar në përputhje me manualin e miratuara me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, sipas përcaktimit të bërë në LPP neni 28 dhe Metodën e përlllogaritjes së vlerës në kontratat publike dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publiko i ndryshuar, neni 9 dhe neni 59, pika 2.

Nga verifikimi "Mbi vlerësimi i ofertave dhe kriterëve të kualifikimit, ka rezultuar:

Nga NJP, ishin mbajtur procesverbalet përkatëse për hartimin e kriterëve kualifikuesë, (kriteret e përgjithshme/ligjore; kapaciteti ekonomik dhe kapaciteti teknik). Procesverbalet janë firmosur në çdo faqe dhe në fund nga 3 anëtarët e NJP, në përputhje me përcaktimet në VKM nr. 914/2014, neni 61, pika 2 dhe 285/2021, neni 2 dhe Dokumentimi i procesit, pika 1, ku cilësohet: *Autoriteti/enti kontraktor duhet të administrojë të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi i saj deri te zbatimi i kontratës. Për këtë qëllim, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera”* dhe neni 78 dhe Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika 2.

Titulli i Gjetjes 4: Mbi mangësi të evidentuara në përcaktimin e kriterëve kualifikuesë dhe miratimin e DT nga NJP.

Situata 1: 1. Nga shqyrtimi i Procesverbaleve, në të gjitha procedurat e audituara, është evidentuar se nga NJP, nuk janë dhënë argumente të mjaftueshme, mbi përcaktimin e kërkesave që duhet të plotësojnë OE, në përmbushje të kriterëve, veçanërisht atyre teknike.

Kjo mangësi është më e evidente në procedurat e vitit 2020, pasi në vitin 2021 me ndryshimet ligjore NJP, përveç se është e detyruar të japë argumente, duhet dhe të paraqesë në SPE, procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim. *(Trajtuar hollësisht në aneksin II.2.4.3.3 "Mbi vlerësimin e ofertave dhe kriterëve të kualifikimit")*.

2. Nga shqyrtimi i dokumenteve të dosjes së prokurimit është evidentuar se në të gjitha rastet, ka patur ndërhyrje nga procesi i monitorimit të APP, ku tërhiqet vëmendje dhe rekomandohet që AK, Bashkia Tepelenë, duhet të argumentojë kërkesat e vendosura, si dhe duhet ti përcaktojë ato në raport me objektin dhe madhësinë e kontratës, pasi vendosja e kriterëve jo të përshtatshme, sjell kufizim të OE në garë.

Në lidhje me raportet e monitorimit të APP-së duhet të evidentojmë faktin se për shqyrtimin e tyre, AK ka zbatuar rregullat, ka pezulluar procedurën, ka shqyrtuar rekomandimet e APP-së, ka mbajtur procesverbalin përkatës (shtoja e DT), ka shtyrë afatin e hapjes së tenderit, si dhe ka hapur procedurën e prokurimit.

Në lidhje me pranimin e vërejtjeve dhe propozimeve të APP-së, cilësojmë se jo në të gjitha rastet janë pranuar rekomandimet e APP-së, si dhe jo në të gjitha rastet janë dhënë argumentet e duhura nga NJP, për moszbatim të tyre. *(Trajtuar rast pas rasti në aneksin II.2.4.3.3 "Mbi vlerësimin e ofertave dhe kritereve të kualifikimit").*

Rasti më evident është në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonatë dhe Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë, ku APP ka bërë një sërë vërejtjesh dhe midis tyre ka atakuar si të pa argumentuar kërkesën e NJP, për paraqitjen nga ana e OE, të 200 punonjësve me kohë të plotë, si dhe faktin që figurojnë në listë pagesa nga Prill 2020-Qershor 2020.

APP, ka kërkuar rishikim të kësaj kërkesë, për të ulur numrin e punonjësve në 120. Nga shqyrtimi i dokumentacionit për përlllogaritjen e kësaj kërkesë është konstatuar se numri i punonjësve të përlllogaritur, për 150 ditë punime, nga projektuesi është 91 punonjës.

Sa më sipër, në këtë rast NJP, jo vetëm që nuk ka reflektuar kërkesën e APP-së, por nuk ka vendosur këtë kërkesë, sipas përlllogaritjeve të bëra nga projektuesi.

Në lidhje më këtë shtojmë dhe faktin se, në procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë, nga NJP është përcaktuar në DT e njëjta kërkesë për numrin e punonjësve (200 punonjës). Edhe në këtë rast APP, ka kërkuar që të rishikohet kjo kërkesë dhe NJP, ka pranuar vërejtjen e APP-së duke ndryshuar numrin e punonjësve nga 200 në 120, edhe pse kjo kontratë është në vlerën 195,833,333 lekë, pra më e lartë se kontrata në fjalë me fond limit 111,118,889 lekë, ku NJP nuk ka pranuar këtë rekomandim.

Kriteri 1 dhe 2: NJP, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, me ndryshime (aktualisht i shfuqizuar),

- Nenin 20 ò Mos diskriminimi, ku cilësohet: *"Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre";*

- Nenin 46 ò Kualifikimi i ofertuesve, pika 1, ku cilësohet: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese"* dhe pika 3, ku cilësohet: *"Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik"*.

- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 neni 26 "Kontratat për punë publike",

pika 5, ku cilësohet: *"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve".*

- LPP 162/2020, neni 77, pika 1;

- VKM nr. 285/2021, neni 78 ÷ Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, pika 2, ku cilësohet: *"Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësi e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".*

Ndikimi/Efekti: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ndikojnë në pjesëmarrjen e OE në garë, dhe konkretisht në dy procedurat me objekt ndërtimin e ujësjellësve, ka marrë pjesë vetëm 1 OE, i paraqitur si BOE.

Shkaku: Përcaktimi i disa kërkesave për përmbushjen e kriterëve kualifikuese, në nivele të larta dhe jo në përputhje të plotë me madhësinë, objektin dhe afatet e realizimit të kontratave, vjen si rezultat i mosveprimit dhe analizimit të këtyre kriterëve në mënyrën e duhur nga ana e personave përgjegjës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, Njësia e Prokurimit dhe Grupet e Punës të ngritura për përcaktimin e specifikimeve teknike, apo kriterëve të veçanta për kualifikim, të marrin masa, që të sigurojë përcaktim të kriterëve kualifikuese, në përputhje me objektin dhe madhësinë e kontratës, me qëllim mos diskriminimin e operatorëve ekonomikë potencialë në garë dhe rritje të pjesëmarrësve në garë.

Titulli i Gjetjes 5: Mbi hedhjen në SPE të DT, dhe ndryshimeve të tyre.

Situata 1: a- Personi përgjegjës për prokurimin, ka hedhur në SPE, dokumentet e tenderit, të miratuara me procesverbal nga NJP, në seksionin "Dokumentet e tenderit". Gjithashtu kriteret e përcaktuara në DT janë hedhur në seksionin "Kriteret e pjesëmarrjes" dhe seksionin "Vlerësimi i ofertave", ku janë reflektuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në DT, në përmbushje të kriterëve kualifikuese, në përputhje me VKM nr. 285/2021, neni 7, ku cilësohet: *"Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor publikon, në faqen e tij zyrtare të internetit, dokumentet e tenderit dhe procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit. Autoriteti/enti kontraktor është përgjegjës për barazvlefshmërinë e kopjes së sipërpërmendur, së bashku me dokumentet e tenderit të hartuara nga njësi e prokurimit dhe që administrohen prej tij".*

b- Në të gjitha procedurat e audituara ka patur modifikim të DT, për

kryerjen e të cilave nga AK, janë zbatuar të gjitha procedurat e përcaktuara në lidhje me shqyrtimin e tyre, pasi nga Titullari i AK, është kryer pezullimi i procedurës, është ngritur grupi i punës, është rihapur procedura, janë përcaktuar afatet e hapjes së tenderit, është mbajtur procesverbali për shqyrtimin dhe miratimin e modifikimeve, **si dhe është bërë hedhja në SPE, në formën e shtojcës së DT**, në seksionin Dokumentet e tenderit, në zbatim të nenit 14 "Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët", pika 4, ku cilësohet: *"Çdo ndryshim në dokumentet e tenderit duhet t'i bëhet i njohur çdo operatori ekonomik të interesuar, në përputhje me nenin 42 të LPP dhe me këto rregulla"* dhe LPP 162/2020, neni 75, ku cilësohet: *"Çdo ndryshim në dokumentet e tenderit duhet t'i bëhet i njohur çdo operatori ekonomik të interesuar, në përputhje me nenin 75, të LPP-së, dhe me këto rregulla"*. Gjithashtu në seksionin administrimi i tenderit janë bërë ndryshimet përkatëse.

c- Në lidhje me publikimin e ndryshimeve të DT, sipas procesverbalit përkatës Shtojca e DT, **duhet të theksojmë se këto ndryshime nuk janë pasqyruar në seksionin "Kriteret e pjesëmarrjes" dhe në seksionin "Vlerësimi i ofertave"**, seksion i cili aksesohet nga KVO për të vlerësuar ofertat në raport me kriteret dhe kërkesat e pasqyruara në këtë seksion të DT, varianti final.

NJP, në kushtet e procedurës elektronike, duhet të pasqyrohet në SPE, në seksionin e KVO-së ÷Vlerësimi i ofertave, si vlerësues i ofertave të paraqitura në procedurë, ku çdo dokumentacion i paraqitur nga ofertuesit të verifikohet nga KVO në raport me kriteret përfundimtare, duke përfshirë edhe ato të ndryshuara sipas shtojcës së DT.

Gjithashtu kemi konstatuar se edhe nga ana e OE, nuk ka patur asnjë reflektim kundrejt ndryshimeve në DT, pasi dokumentacioni i hedhur në sistem nga OE ofertues, është i bazuar në kriteret e përcaktuara në DT fillestare.

Vlerësimi është bërë pa përfshirë rekomandimet e APP-së për ndryshim të kriterëve kualifikuese të pranuar sipas Procesverbaleve (Shtojca e DT).

Kriteri 1 dhe 2:

Manuali nr. 2, datë 06.02.2018 ÷Për rolin e Administratorit të Sistemit të Autoritetit Kontrator, për rolin e Nëpunësit të autorizuar të Njesisë së Prokurimit dhe për rolin e Anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të ofertave, në Sistemin e Prokurimit Elektronik, 3.1. ÷Krijimi i dosjes së tenderit, ku është cilësuar:

"Nëpunësi i autorizuar hedh në sistemin e prokurimit elektronik dhe bën përcaktimin e kriterëve të pjesëmarrjes dhe kriterëve të vlerësimit në përputhje me kriteret e përcaktuara nga njësia e prokurimit në Dokumentet e Tenderit të miratuara nga vetë njësia e prokurimit. Çdo devijim nga kërkesat e njesisë së prokurimit ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin e autorizuar dhe përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit".

LPP nr. 162/2020, neni 75 ÷Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit, pika 3 ku cilësohet: *"Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit komunikohet në të njëjtën mënyrë që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës"*.

Ndikimi/Efekti:

Nga AK (shtojca e DT) është hedhur në SPE në seksionin "Dokumente të tenderit", por ka rezultuar se KVO në vlerësimin që ju ka bërë ofertuesve ka marrë për krahasim kërkesat e ligjore, financiare dhe teknike të pa

ndryshuara, në seksionin "Vlerësimi i ofertave".

Shkaku: Mos pasqyrim i ndryshimeve të DT, në seksionin "Vlerësimi i ofertave".
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: -

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Znj. J.K., Personi Përgjegjës për Prokurimet.

Nga verifikimi i kryer "Mbi vlerësimin e ofertave" ka rezultuar se:

Nga grupi i auditimit, janë audituar 7 procedura prokurimi, 2 procedura të zhvilluara në vitin 2020 dhe 5 procedura të zhvilluara në vitin 2021 (paraqitur në mënyrë të detajuar në tabelat e mësipërme). Nga auditimi i tyre në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO, kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

Titulli i Gjetjes 6: Mbi vlerësimin e ofertave, nga ana e KVO-së.

Situata 1: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt:

1."Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonatë dhe òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë, me fond limit në shumën 111,118,889 lekë;

2."Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë me fond limit në shumën 195,833,333 lekë **ka rezultuar se**, në të dy procedurat ka marrë pjesë në garë një ofertues, i cili është paraqitur si BOE.

Nga këqyrja e dokumentacionit të hedhur në sistem, por dhe atij të dorëzuar pranë AK nga OE të shpallur fitues, janë plotësuar të gjitha kriteret kualifikuese si ato ligjore, kapaciteti financiar dhe teknik, por nga një analizë e gjithë dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesit, kemi konstatuar sa më poshtë vijon:

BOE-të kanë paraqitur, sipas kërkesës së DT, në shtojcën 11 òKontrata të lidhura dhe në procesë si më poshtë:

- Në procedurën "Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonatë" dhe "Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë", me fond limit në shumën 111,118,889 lekë.

Shtojca 11 "B.-S." SHPK

Nr.	Vlera e kontratave te fituara ose ne proces	Përqindja e pjesëmarrjes	Pjesëmarrja në vlerë
1	142,601,830	30.7	43,778,762
2	284,308,036	53	150,683,259
3	389,270,085	70	272,489,060
4	328,139,297	70.5	231,338,204
5	18,527,669	15.5	2,871,789
6	79,129,675	50	39,564,838
7	130,146,289	60	78,087,773
8	115,134,594	100	115,134,594
9	466,395,123	100	466,395,123
10	362,713,599	30	108,814,080
11	305,615,961	12	36,673,915

12	416,094,615	20	83,218,923
	3,038,076,773		1,629,050,319

Shtojca 11 "E." SHPK

Nr.	Vlera e kontratave te fituara ose ne proces	Përqindja e pjesëmarrjes	Pjesëmarrja në vlerë
1	25,405,720		25,405,720
2	15,699,520		15,699,520
3	70,000,630		70,000,630
4	7,158,000		7,158,000
	118,263,870		118,263,870

Shtojca 11 "ST." SHPK

Nr.	Vlera e kontratave te fituara ose ne proces	Përqindja e pjesëmarrjes	Pjesëmarrja në vlerë
1	127,727,766		127,727,766
2	381,811,507		381,811,507
3	70,000,630		70,000,630
4	364,221,316		364,221,316
	943,761,219		943,761,219

Siç shihet nga të dhënat e tabelave të mësipërme OE, pjesëmarrës në garë janë të angazhuar në një numër të konsiderueshëm kontratash.

OE "B.S." SHPK, ka në total 114 punonjës, sipas listë pagesave, ku sipas kërkesave të kësaj procedure dhe sipas përqindjes së pjesëmarrjes, 112 punonjës duhet ti angazhojë në ndërtimin e këtij objekti, kur ndërkohë ka kontrata të lidhura dhe në proces të deklaruara Shtojca 11, të cilat po ashtu kërkojnë punonjës për t'u realizuar.

Gjithashtu, OE "E.C." SHPK, nuk e përmbush këtë kriter sipas pjesëmarrjes në procedurë, me 30 %, ose 60 punonjës, pasi sipas listë pagesave ka 53 punonjës, si dhe duke marrë në konsideratë kontratat e lidhura dhe në proces, ky kriter nuk mund të plotësohet.

- Në procedurën "Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivicë dhe Rexhin, Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë" me fond limit në shumën 195,833,333 lekë.

Ka marrë pjesë vetëm një operator i paraqitur si BOE, sipas kontratës së bashkëpunimit, midis OE "2." SHPK dhe OE "G. Company" SHPK.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, por dhe atij shkresor pranë AK, ka rezultuar se BOE, ka plotësuar kërkesat sipas DT në përmbushje të kriterëve kualifikuese.

Nga vlerësimi i procedurave në tërësi, në lidhje me OE "2." SHPK, duhet të theksojmë se është pjesëmarrës në procedurën "Ndërtim rrjeti ujësjellësi Nivicë, Rexhin..." të zhvilluar nga Bashkia Tepelenë me fond limit 195 milion lekë dhe Ujësjetës Salari më fond limit 29 milionë lekë.

Në këtë procedurë, sipas DT, pika 2.3.3 i është kërkuar që të disponojë 120 punonjës me kohë të plotë, referuar listë pagesave, ku sipas pjesëmarrjes si BOE, me 67 %, duhet të këtë të angazhuar me kohë të plotë 80 punonjës, për periudhën Gusht 2020-Janar 2021.

Në procedurën "Ujësjetës Salari", sipas DT, pika 2.3.3 është kërkuar që: OE duhet të dëshmojë se ka të punësuar mesatarisht të paktën 70 punonjës me kohë të plotë, për periudhën Prill 2020-Dhjetor 2020.

Në një vlerësim të dokumentacionit mbi deklaratën për kontrata të ngjashme dhe në proces, rezulton se ky operator ekonomik është i angazhuar në 13 kontrata të tjera (të lidhura ose në proces/Shtojca 11), për

vlerën totale 3,125,341,139 lekë.

Nr.	Vlera e kontratës	Pjesëmarrja në %	Pjesëmarrja në vlerë
1	421,287,293	35.5	149,556,989
2	444,056,344		444,056,344
3	416,094,749	35	145,633,162
4	218,123,134		218,123,134
5	113,595,678		113,595,678
6	305,615,961	50	152,807,981
7	46,786,558		46,786,558
8	442,292,336		442,292,336
9	380,568,371		380,568,371
10	167,624,376		167,624,376
11	157,377,451		157,377,451
12	149,312,121		149,312,121
13	557,606,638		557,606,638
	3,820,341,010		3,125,341,139

OE "2T" SHPK, e cili në këtë procedurë paraqitet si BOE, me 67 % të pjesëmarrjes, për plotësimin e kriterit mbi numrin e punonjësve, OE të ketë 120 punonjës me kohë të plotë të angazhuar në këtë objekt, me vlerë limit të kontratës 195,833,333 lekë (ku 2T SHPK, duhet të ketë 80 punonjës). Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme, si dhe kërkesave të procedurës përkatëse, vlerësojmë se është e pamundur të vlerësohet plotësimi i këtij kriteri, ndërkohë që kontrata të lidhura ose në proces (*pa afate kohore të përcaktuara*), janë në shumën 3,125,341,139 lekë, ose 16 herë më shumë se fondi limit i prokuruar. Numri i punonjësve sipas listë pagesës është 257 punonjës, nga të cilët sipas kërkesave të DT, 80 prej tyre, duhet të jenë të angazhuar në këtë objekt me kohë të plotë.

E njëjta situatë paraqitet edhe për kapacitetin teknik "makineri dhe pajisje", pavarësisht se BOE, plotëson këtë kriter referuar makinerive dhe pajisjeve të deklaruara në Shtojcën 10, si dhe të paraqitura me dokumentacion në ofertën e tyre, angazhimi i tyre në disa kontrata njëkohësisht, cenon plotësimin e këtij kriteri.

Sa më sipër, pavarësisht se BOE, kanë plotësuar kriteret kualifikuese referuar DT dhe ofertave të paraqitura, këto fakte nuk janë analizuar nga KVO, si fakte të cilat ndikojnë në mos përmbushjen e kriterit për kapacitetin teknik 2.2.3 "numri i punonjësve", apo dhe ato të shtojcës 10 ÷ Makineri e pajisjeë edhe **a)** për arsyen se të dhënat e deklaruara në këto shtojca, nuk janë të mjaftueshme, për të bërë një analizë të saktë të situatës, si dhe **b)** për arsye se nga KVO, nuk janë kërkuar sqarime nga OE.

Kriteri: LPP 9643/2006, neni 53 ipika 1 dhe LPP 162/2020, neni 92 ÷ Shqyrtimi i ofertave, pika 1, ku cilësohet: "*Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme*".

DT, Shtojca 10 dhe Shtojca 11.

Ndikimi/Efekti: Angazhimi i kapaciteteve teknike (punonjës/staf teknik dhe makineri e pajisje), në një nivel të konsiderueshëm kontratash të lidhura dhe në proces sipas vetë deklarimeve të OE, referuar shtojcave të DT nr. 10 dhe

11, riskon realizimin e kontratave.

- Shkaku:** KVO, nuk ka të dhëna të detajuara, për një vlerësim më të saktë të këtij kriteri, pasi të dhënat e paraqitura nga OE, sipas shtojcave përkatëse, nuk e japin këtë mundësi.
- Rëndësia:** E ulët, pasi me ndryshimet sipas LPP nr. 162/2020 dhe VKM nr. 285/2021, në këto situata OE, mund të mbështeten në kapacitete të subjekteve të tjera.
- Rekomandimi:** -

Titulli i Gjetjes 7: Mbi vlerësimin e ofertave, nga ana e KVO-së, për procedurën me objekt “Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj (Pastrimi i rezervuarit)”

Situata 1: Nga verifikimi i kryer "Mbi vlerësimin e ofertave" ka rezultuar nga 6 OE pjesëmarrës, janë skualifikuar 5 prej tyre dhe është kualifikuar 1 (një) OE "Sh" SHPK.

Nr.	Operatoret ekonomikë	NIPT	Oferta e paraqitur	Statusi
1	OE-M.SHPK	L2.....1C	11,661,883	Skualifikuar
2	BOE-A.&B. SHPK	J6.....6O	12,317,584	Skualifikuar
3	OE-Sh.SHPK	K0.....3N	17,415,856	Kualifikuar
4	OE-N.Structures SHPK	L7.....2O	17,433,163	Skualifikuar
5	OE-Fl. SHPK	K1.....4C	14,839,009	Skualifikuar
6	OE-K. K. SHPK	K7.....4	-	Skualifikuar

Nga këqyrja e ofertave në SPE, të OE të cilët janë skualifikuar nga KVO, ka rezultuar se OE-M. SHPK dhe BOE-A. & B. SHPK, nuk kanë plotësuar një sërë kriteresh. (Trajtuar hollësisht në aneksin II.2.4.3.3 "Mbi vlerësimin e ofertave dhe kriterëve të kualifikimit"). KVO, ka skualifikuar OE dhe BOE të cilësuar më lart, në përputhje me LPP nenin 46 dhe 53.

OE-Sh SHPK, i kualifikuar ka këto mangësi:

1. OE Sh. SHPK, ka deklaruar pagesat e taksave vendore në bashkitë ku ka zhvilluar aktivitetet për vitet 2018-2020, si më poshtë:

Për vitin 2018, ka paraqitur vërtetime nga bashkitë (Pukë dhe Roskovec).

Për vitin 2019, ka paraqitur vërtetime nga bashkitë (Patos, Konispol, Selenicë, Finiq, Gjirokastër, Berat, Tepelenë, Skrapar, Tepelenë, Mallakastër, Tropojë, Dropull, Kavajë, Pukë, Tepelenë dhe Roskovec);

Për vitin 2020, ka paraqitur vërtetime nga bashkitë (Tiranë, Poliçan, Kamëz dhe Fier);

OE Sh. SHPK, ka paraqitur në Shtojcën 11 se ka kontrata të lidhura dhe në proces me NJVV (Roskovec, Lezhë, Poliçan, Tiranë), si dhe vërtetim të pagesave të taksave vendore për vitin 2020, (Tiranë, Poliçan, Kamëz dhe Fier). OE Sh. SHPK, **nuk ka paraqitur vërtetime dhe dokumentacion mbi pagesat e detyrimeve nga bashkitë Lezhë dhe Roskovec**, të deklaruar prej tij, duke mos përmbushur kështu kërkesën e pikës 2.1.c të DT.

Nga këqyrja e dokumentacionit për verifikim të plotësimin të kërkesave të DT, në përmbushje të kriterëve kualifikuese, siç është pagesa e taksave vendore, në të gjitha njësitë ku OE ka zhvilluar apo zhvillon veprimtari, në raport këto me deklarimin adresave të ushtrimit të aktivitetit të tij në Ekstraktin historik të regjistrimit QKB, ka rezultuar se OE Sh. SHPK, ka deklaruar vetëm dy adresa për periudhën 2018-2020 (Fier dhe Tiranë), gjë

që cenon krahasueshmërinë e të dhënave dhe nxjerrjen e një konkluzioni të saktë. OE Sh. SHPK, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" me ndryshime, neni 43 "Përditësimi i të dhënave të regjistrimit" pika 1.

2. KVO, nuk ka vlerësuar në mënyrën e duhur OE Sh. SHPK, në lidhje me pagesat e taksave vendore, pasi pavarësisht mungesës së informacionit krahasues (mungesa e adresave në Ekstraktin e QKB). KVO duhet të skualifikonte këtë OE, për mos përmbushje të kërkesës së pikës 2.1.c të DT, **nuk ka paraqitur vërtetime dhe dokumentacion mbi pagesat e detyrimeve nga bashkitë Lezhë dhe Roskovec**. KVO ka vepruar në kundërshtim me LPP neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1. Në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve kualifikuese nga të dy OE, diferenca midis ofertës ekonomike të OE Sh. SHPK dhe OE Av. SHPK **në shumën 5,098,272 lekë** (17,415,856-12,317,584) do të konsiderohet përdorim i fondeve pa 3E, për shkak të moszbatimit të nenit 46, pika 1 të ligjit, nga KVO.

Kriteri 1: Ligji 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" me ndryshime, neni 43 "Përditësimi i të dhënave të regjistrimit" pika 1 cilësohet: *"Tatimpaguesi, person fizik dhe juridik, regjistron çdo ndryshim të të dhënave në Qendrën Kombëtare të Biznesit, siç përcaktohet në ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" i ndryshuar. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia".*

Kriteri 2: LPP nenin 46 dhe 53 ku cilësohet: *Neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1 "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese..."; Nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji".*

Ndikimi/Efekti: OE Sh. SHPK, për shkelje të Ligjit 9723/2007, neni 43 "Regjistrimet e tjera të detyrueshme", pika 3, germa (d), ku cilësohet se janë detyrim për regjistrim, vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia", subjekti penalizohet sipas nenit 74 "Kundërvajtjet administrative" të Ligjit 9723/2007 në masën 15,000 lekë dhe sipas nenit 112 "Mungesa e ekzekutimit të detyrimit për regjistrim", të ligjit 9920/2008, gjithashtu është parashikur gjobë në masën 15000 lekë, ku parashikohet se: *"Përveç sanksioneve administrative, të parashikuara në ligje të tjera, mosrespektimi i detyrimit për regjistrim apo detyrimit për përditësimin e të dhënave, dënohet për çdo shkelje me gjobë prej 10 000 lekësh për*

organizatat jofitimprurëse dhe për tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe 15 000 lekësh për tatimpaguesit e tatimit mbi fitimin".

Nga ana e subjektit "Sh." SHPK, nuk janë regjistruar për periudhën 2018-2020, referuar Ekstraktit historik të QKB, te depozituar nga vetë subjekti në DT, 19 adresa ku sipas pagesave të taksave vendore ka ushtruar veprimtari. **Detyrimi i subjektit (gjoba) është në shumën 285,000 lekë (19 adresa*15,000 lekë).**

Mos vlerësimi i duhur i OE, òSh. SHPKò, ka sjellë përdorim pa efektivitet e fondeve në shumën **në shumën 5,098,272 lekë.**

Shkaku:

Mos vlerësim i duhur i dokumentacionit nga ana e KVO-se.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandimi:

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tepelenë, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë nga ana e KVO-së, të operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në DT, për përmbushjen e òKritereve të veçanta për kualifikimò, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të cilat janë në kundërshtim me aktet rregullative të fushës, si dhe me pasojë në përmbushjen me cilësi të kontratës në këto investime, për shkak të mos përmbushjes së kritereve të vendosura në DT.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Komisioni i vlerësimit të Ofertave.

Titulli i Gjetjes 8: Mbi vlerësimin e ofertave anomalisht të ulëta, nga ana e KVO-së, për tre procedurat e mëposhtme.

Situata:

1. Nga verifikimi i kryer "Mbi vlerësimin e ofertave" për procedurën me objekt òRikonstruksion i rrugëve e blloqe banimi në qytetin Tepelenëò ka rezultuar:

Nr.	Operatorët pjesëmarrës	NIPT	Oferta ekonomike
6	N.	J7.....7U	6,546,998
9	Sh.	K0.....3N	8,991,193
12	Fondi limit		10,104,067
13	Vlera 25 % e fondit limit		2,526,017
14	Vlera e ulur e ofertës fituese		3,557,069

- Nga këqyrja e dokumentacionit të OE "N" SHPK, ka rezultuar se ka paraqitur shtojcat, si dhe dokumentacion në përmbushje të kritereve, ligjore, kapacitetit ekonomik dhe kapacitetit teknik, sipas kërkesave të DT. KVO ka vepruar në përputhje me LPP 162/2020, neni 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3.

- Përsa i përket vlerës së ofertës ekonomike, së paraqitur nga OE "N" SHPK, rezulton të jetë anomalisht e ulët, sipas përlllogaritjeve të bëra në tabelën e mësipërme, bazuar në VKM nr. 285/2021, neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 4. Vlerësimi i ofertës anomalisht të ulët është kryer në tabelën e mësipërme bazuar në VKM nr. 285/2021, neni 82 òShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveò, pika 4.

Sa më sipër, në Procesverbalin e KVO-së, mbi vlerësimin e ofertave nuk është bërë përlllogaritja e mësipërme, për rrjedhojë nuk është cilësuar se OE "N" SHPK, është paraqitur me ofertë anomalisht të ulët.

2. òRikonstruksion i fasadave në lagjen òDemokraciaò në perimetër të rrugës dhe ndriçimi i rrugës òE.Bilbiliò unaza veriore e qytetit Tepelenëò.

Sipas Urdhrit të prokurimit, kjo është procedurë e hapur e thjeshtuar e llojit "punë", me vlerë limit të kontratës prej 11,916,667 lekë, në të cilën kanë marrë pjesë 10 OE, si më poshtë:

Nr.	Operatorët pjesëmarrës	NIPT	Oferta ekonomike
1	BOE-V	L9.....8E	6,844,300
2	K.	L7.....1E	8,167,200
3	T.	K3.....9L	8,313,200
4	BOE-S & J	J6.....5F	9,543,700
6	N.	J7.....7U	8,563,500
7	A.	K5.....2C	9,650,000
8	NG.	L7.....2O	9,999,999
9	Sh.	K0.....3N	10,599,100
10	E.	L8.....1M	10,713,150
11	LK	K7.....9I	11,081,094
12	Shuma totale e ofertave		93,475,243
13	Mesatare e vlerave te ofertave		9,347,524
14	Vlera prej 85 % e mesatares		7,945,395

- Nga këqyrja e dokumentacionit të OE "BOE-V.& I.", ka rezultuar se ka paraqitur shtojcat, si dhe dokumentacion në përmbushje të kriterëve, ligjore, kapacitetit ekonomik dhe kapacitetit teknik, sipas kërkesave të DT.KVO ka vepruar në përputhje me LPP 162/2020, neni 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3.

- Përsa i përket vlerës së ofertës ekonomike, së paraqitur nga OE "BOE-V", rezulton të jetë anomalisht e ulët, sipas përlllogaritjeve të bëra në tabelën e mësipërme, bazuar në VKM nr. 285/2021, nenin 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 4.

Sa më sipër, në Procesverbalin e KVO-së, mbi vlerësimin e ofertave nuk është bërë përlllogaritja e mësipërme, për rrjedhojë nuk është cilësuar se BOE ÷V.& I." është paraqitur me ofertë anomalisht të ulët.

3. ÷Rikonstruksion i rrugëve dytësore fshati Mamaj, Njësia Administrative Qendërë.

- Nga KVO sipas Procesverbalit datë 07.12.2021, është bërë vlerësimi i ofertave dhe sipas klasifikimit përfundimtar, ka rezultuar se kanë plotësuar kriteret e kualifikimit 7 OE dhe si ofertë fituese është klasifikuar, oferta e paraqitur nga OE "T." SHPK, i cili ka paraqitur dhe ofertën ekonomike në vlerë më të vogël.

Nr.	Operatori ekonomik	NIPT	Vlera ofertës ekonomike
1	T.	K3.....9L	7,718,370
2	A. & A.	K5.....2C	8091249
3	N	J7.....7U	8597919
4	Av.	J6.....6O	9247622
5	K.	L7.....1E	9797059
6	Sp.	J6.....5F	9818364
7	E.C.	K8.....2K	11703438
	Vlerësim mbi ofertën anomalisht të ulët		
1	Shuma e ofertave		64,974,021
2	Mesatarja e ofertave		9,282,003
3	Vlera 85 % e mesatares		7,889,703

- Nga këqyrja e dokumentacionit të OE "T.", ka rezultuar se ka paraqitur shtojcat, si dhe dokumentacion në përmbushje të kriterëve, ligjore, kapacitetit ekonomik dhe kapacitetit teknik, sipas kërkesave të DT.

KVO ka vepruar në përputhje me LPP 162/2020, neni 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3.

- Përsa i përket vlerës së ofertës ekonomike, së paraqitur nga OE "T.", rezulton të jetë anomalisht e ulët, sipas përlllogaritjeve të bëra në tabelën e mësipërme, bazuar në VKM nr. 285/2021, nenin 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 4.

Sa më sipër, në Procesverbalin e KVO-së, mbi vlerësimin e ofertave nuk është bërë përlllogaritja e mësipërme, për rrjedhojë nuk është cilësuar se OE "T.", është paraqitur me ofertë anomlisht të ulët.

Kriteri 1:

LPP 162/2020, neni 92 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3, ku cilësohet: *"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit".*

Kriteri 2:

LPP 162/2020, neni 93 *Oferta anomalisht e ulët;*

VKM nr. 285, neni 82 *Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*, pika 4 ku cilësohet: *"Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:*

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së".

Ndikimi/Efekti:

Mund të ndikojë në mosrealizimin në kohë apo cilësi të kontratës.

Shkaku:

Mosveprim nga ana e KVO, për përlllogaritjen e vlerës anomalisht të ulët dhe kërkesën për argumentim nga ana e OE.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandimi:

Titullari i Autoriteti Kontraktor, të marrë masa që gjatë zbatimit të këtyre kontratave, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, të ndjekë me rigorozitet zbatimin e tyre, me qëllim shmangien e problematikave eventuale si në zbatimin e afateve, po ashtu dhe të cilësisë së punimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: KVO, referuar VKM nr. 285/2021, neni 75 "Komisioni i vlerësimit të ofertave".

Për sa është trajtuar më lart (pika II.2.4, të Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 3 datë 13.05.2022, protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr. 484/15, datë 13.05.2022. Mbi këtë Akt konstatimi është paraqitur observacioni me shkresën nr. 484/16, datë 20.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 261/3, datë 23.05.2022 dhe observacioni mbi PRA me shkresën nr. 484/19, datë 13.07.2022, protokolluar në KLSH me nr. 261/8, datë 18.07.2022 dhe observacioni me shkresës nr. 484/17, datë 10.06.2022, protokolluar në KLSH me nr. 261/5, datë 16.06.2022. (Paraqitur me vonesë në fazën e hartimit të PRA).

Sqarim mbi observacionin nr. 484/19, datë 13.07.2022, protokolluar në KLSH me nr. 261/8, datë 18.07.2022.

Për sa është observuar nga znj. J.K., në cilësinë e Personit përgjegjës për prokurimet, në lidhje me hedhjen në të gjitha seksionet e SPE, të ndryshimeve në DT, sqarojmë se: nga ana e Personit përgjegjës për prokurimet, janë paraqitur të njëjtat argumente si në fazën e PRA, për të cilat nga ana e grupit të auditimit janë dhënë shpjegimet përkatëse. Nga observuesi nuk janë paraqitur argumente të reja dhe ligjore dhe për këtë arsye i qëndrojmë konstatimit të trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit.

Sqarim mbi observacionin nr. 484/17, datë 10.06.2022, protokolluar në KLSH me nr. 261/5, datë 16.06.2022, paraqitur nga z. L.B..

Pretendimi i subjektit:Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të territorit, nuk ka patuar dijeni mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit, si dhe nuk i është kërkuar që të hartojë ato.

Nuk ka patur dijeni projektet teknike dhe për objektet e prokuruar, për rrjedhojë as për nevojën e kërkesës për oponencë teknike.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Përsa është observuar nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të territorit, konfirmojmë se pas shqyrtimit të argumenteve të sjella, u rivlerësua konstatimi i grupit të auditimit, i cili për nga përmbajtja nuk do të ketë ndryshim, por përsa i përket përgjegjësisë, observacioni i paraqitur merret në konsideratë dhe është reflektuar në pjesën takuese PRA.

Mbi zbatimin e kontratave dhe likuidimin e situacioneve.

Zbatimi i kontratave është trajtuar në akt konstatimin e mbajtur për këtë qëllim, ndërsa likuidimi i tyre paraqitet si më poshtë:

Objekti	Situacioni		Urdhër shpenzimi		Faturë TVSH & fiskalizuar		Shuma	Garancia
	Nr.	Datë	Nr.	Datë	Nr.	Datë		
Ujësjiellësi Progonat	1	S'ka	296	04.06.2021	5	03.06.2021	9421,188	495,852
Ujësjiellësi Progonat	4	24.09.2021	670	28.12.2021	96	27.12.2021	47,500,000	2,500,000
Kanali vaditës Dukaj	1	S'ka	577	24.11.2020	4	24.11.2020	9,500,000	500,000
Kanali vaditës Dukaj	Përfundimtar	S'ka	194	22.04.2021	15	24.12.2020	9,404,075	494,951
Ujësjiellës Nivicë	1	20.12.2021	635	23.12.2021	115	22.12.2021	44,650,000	2,350,000
Ujësjiellës Salari	1	20.12.2021	663	24.12.2021	117	23.12.2021	6,650,000	350,000

Konkluzion: Nga këqyrja e dokumentacionit të bankës ka rezultuar se, kryerja e shpenzimeve për zërin investime, për procedurat objekt auditimi, është kryer sipas situacioneve të mësipërme është bërë në përputhje Ligjin për Kontabilitetin nr. 25/2018, si dhe Udhëzimi i MFE nr. 30, datë 27.12.2011 ne ndryshime, Kapitulli III. "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes se tyre", pika 3, germa (a) "Dokumente autorizues"; (b) Dokumente vërtetues dhe (c) Dokumente të kontabilitetit", për paraqitjen e dokumentacionit autorizues dhe justifikues të shpenzimeve. Bazuar në Kontratën e lidhur mes palëve, si dokument autorizues të shpenzimit; Situacionet e paraqitura (pjesorë dhe përfundimtarë) të nënshkruar nga Mbikëqyrësi i punimeve, Sipërmarrësi dhe Investitori, Kryetari i Bashkisë Tepelenë; Faturën me TVSH, si dhe në vitin 2021, Faturë elektronike.

Mbi procedurat e ndjekura nga NJP dhe KVO për blerjet në vlerë të vogël.

Nga auditimi ka rezultuar:

1. Strukturat përgjegjëse për prokurimet:

Nga ana e titullarit të Bashkisë Tepelenë në zbatim të akteve ligjore, Z. T.P., Titullar i Autoritetit Kontraktor "Bashkia Tepelenë", ka nxjerrë urdhrat për ngritjen e komisioneve, në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 56 "Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar", ku cilësohet: *"Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendës titullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit", si dhe Udhëzimin nr. 3/2018 dhe Udhëzimi nr. 5/2021.*

2. Autoriteti kontraktor Bashkia Tepelenë për vitin 2020 dhe 2021, ka zhvilluar procedurat e prokurimit me vlerë mbi 800,000 dhe 1,000,000 lekë si më poshtë:

Tabela nr. 1

Viti	Parashikuar Nr. procedura	Realizuar Nr. procedura	Parashikuar Vlerë	Realizuar Vlerë	Përqindja e realizimit
2020	83	59	32,108,995	25,542,857	80 %
2021	107	79	43,195,523	32,103,798	74 %

3. Prokurimet në vlerë të vogël, janë paraqitur në Regjistrin e Parashikimeve dhe të Realizimit të prokurimeve publike, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 4 "Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik".

4. Mbi vlerësimin e operatorëve ekonomikë dhe shpalljen e fituesit:

Për të vlerësuar zbatimin e rregullave të prokurimit ne vlerë të vogël, u audituan me zgjedhje 20 procedura, sipas aneksit bashkëngjitur, ku ka rezultuar së nga ana e KVO-së, për blerjet e vogla, në vitin 2020 dhe 2021, janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit nr. 3, datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike dhe Udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 "Mbi

përdorimin e procedurës në vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", konkretisht:

- Në SPE, është hedhur i gjithë dokumentacioni i kërkuar sipas përcaktimit të bërë në udhëzimin përkatës;
- Janë respektuar afatet e përcaktuara për vlerësimin e OE;
- Klasifikimi përfundimtar i OE, është bërë sipas Udhëzimit nr. 3/2018, pika 13 dhe Udhëzimi nr. 5/2021, pika 14, ku cilësohet: "*Bazuar në kriterin e çmimit më të ulët do të përcaktohet edhe klasifikimi përfundimtar. Klasifikimi përfundimtar nga autoriteti kontraktor nuk duhet të bëhet në ditë pushimi (e shtunë, e dielë, festa zyrtare)*".
- Skualifikimi i OE, kryesisht është bërë për dy arsye: a) Paraqitje e ofertës përtej fondit limit dhe b) krijimi i vonesave, problematikave nga ana e OE, në procedurat e mëparshme, bazuar në Udhëzimin nr. 3/2018, pika 14 "Refuzimi i ofertave" dhe Udhëzimin nr. 5/2021, pika 15.
- Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të prokurimit në vlerë të vogël, është konstatuar se, ndodhet i gjithë dokumentacioni i përcaktuar në udhëzimet përkatëse.

Konkluzion: KVO, në lidhje me vlerësimin, klasifikimin dhe shpalljen e fituesit, si dhe NJP më lidhje me administrimin e dosjes dhe zbatimin e procedurave në SPE, kanë vepruar në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021.

Titulli i Gjetjes 8: Mbi blerjet në vlerë të vogël, përlogaritja e fondit dhe përcaktimi i llojit të procedurës në mënyrë të paargumentuar.

Situata: Nga auditimi mbi respektimin e kufijve monetarë, janë evidentuar 3 (tre) raste në vitin 2020 dhe 2 (dy) raste në vitin 2021 (tabela nr.2), ku AK ka copëzuar fondet, në kundërshtim me përcaktimet e bëra më poshtë ÷Kriteretö.

Tabela nr. 2

2020			
Dru zjarri për ngrohje			Diferenca
	800,000	718,300	
	490,000	439,550	
	1,290,000	1,157,850	490,000
Pako ushqimore			Diferenca
	350,000	329,800	
	300,000	277,800	
	800,000	745,000	
	1,450,000	1,352,600	650,000
Naftë për ngrohje			Diferenca
	420,000	420,000	
	481,250	387,916	
	1,701,250	1,605,916	901,250
2021			
Dru zjarri për ngrohje			Diferenca
	800,000	755,000	
	450,000	339,990	
	1,250,000	1,094,990	450,000
Naftë për ngrohje			Diferenca
	1,000,000	950,000	
	800,000	772,800	
	300,000	298,000	
	800,000	793,333	
	1,900,000	1,864,133	900,000

Theksojmë se, për procedurat e ndjekura gjatë vitit 2021, nuk jemi në kushtet e parashikuara më pikën 6, Udhëzimit nr. 5/2021, ku cilësohet: *"Në çdo rast nëse autoriteti kontraktor ka realizuar gjithë vlerën e parashikuar prej 1,000,000 lekë, por gjatë vitit kalendarik i linden nevojat shtesë që janë në kufirin e prokurimit të vogël dhe nuk ka qenë e mundur të parashikoheshin në fillim të vitit, mund të përdorë përsëri këtë lloj procedure"*.

Kriteret:

- VKM nr. 914/2014, neni 8 "Kufijtë monetarë", ku cilësohet:
 - *"Për prokurimet, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, është nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 800 000 (tetëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlerë të vogël, siç përshkruhet në nenin 40 të këtyre rregullave.*
 - *Asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP"*.
- Udhëzim nr. 3 , datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", ku cilësohet:
 - Pika 3, *"Kjo lloj procedure do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash, kryerjen e shërbimeve apo punëve të ngjashme, që kanë të njëjtin funksion kryesor apo që kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Përdorimi i kësaj procedure nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast, autoritetet kontraktore nuk duhet të prokurojnë veçmas mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor"*.
 - Pika 4, *"Autoriteti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë dhe i përfshin ato në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik. Autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të prokurojë njëherësh të gjithë sasinë e mallrave, shërbimeve apo të punëve për plotësimin e nevojave të veta. Autoriteti kontraktor mund të realizojë disa procedura prokurimi me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik, në varësi të nevojave dhe mundësive të tij, por vlera e përllogaritur në total e këtyre procedurave për të njëjtin mall/shërbim/punë ose grup mallrash/shërbimesh/punësh, nuk duhet të jetë më e madhe se 800.000 (tetëqind mijë) lekë në vit."*
- Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, për periudhën korrik-dhjetor, 2021, ku cilësohet:
 - *"AK, përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për mallra, shërbime dhe punë, vlera e përllogaritur e të cilave gjatë vitit kalendarik është nga 100,000 lekë deri në 1,000,000 lekë, pa TVSH.*
 - *Kjo procedurë do të përdoret për blerjen e një grupi mallrash, kryerje shërbimesh apo punë të ngjashme që kanë të njëjtin funksion kryesor apo kanë të njëjtin emërtim në planin e shpenzimeve. Përdorimi i kësaj procedure, nuk duhet parë si mundësi për shmangien e procedurave konkurruese të prokurimit. Në asnjë rast AK nuk duhet të prokurojnë veçmas shërbime, mallra apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre apo për shkak të funksionit kryesor"*.

Ndikimi/Efekti: Copëzimi i fondeve ka sjellë shmangie të llojit të procedurës së prokurimit.

Shkaku: Mosveprim nga ana e NJP.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: -

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit, sipas përcaktimeve në VKM nr. 914/2014 nenin 57, ku cilësohet: *"Pika 3. Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme: - Përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti) kur kjo nuk bëhet nga struktura të tjera të posaçme"*.

4.4. Auditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimeve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomike fitues.

Për periudhën 2020-2021, është realizuar zbatimi i kontratave për 5 objekte sipas tabelës mëposhtme. Nga këto 5 kontrata, 2 janë audituar nga auditimi i mëparshëm. Në bazë të analizës së rriskut u përzgjedh për t'u audituar objekti òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonat òdhe òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë, duke u bazuar mbi vlerën e investimit.

Nr.	Objekti i kontratës	Viti	Vlera e kontratës
1	òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonat òdhe òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë	Viti 2020	105,375,894
2	òRehabilitimi Kanalit Ujitës Dukaj (Pastrimi i Rezervuarit), Bashkia Tepelenë.	Viti 2020	17,435,664
3	òRikonstruksion i fasadave në lagjen òDemokracia ò dhe në perimetër të rrugës, dhe ndriçimi i rrugës òE. Bilbili ò unaza veriore e qytetit Tepelenë ò	Viti 2021	6,884,300
4	Ndërtim i rrjetit të furnizimit me ujë të fshatit Nivice dhe Rexhin, Ndërtimi i fshatit Peshtan-Mezhgoran Bashkia Tepelenë	Viti 2021	193,889,182.68
5	òNdërtim i rrjetit të jashtëm për shtimin e sasisë së ujit të pijshëm të fshatit Salari, Bashkia Tepelenë	Viti 2021	28,914,365

Në zbatim të pikës 4, të programit të auditimit nr. 261/2, datë 04.05.2022, òMbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 òPër Prokurimin Publik, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, pika 4.5, òAuditim mbi zbatimin e kushteve në realizimin e punimeve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim të punimeve të kryera në kontratat e lidhura me operatorët ekonomikë fitues, u shqyrtua dokumentacioni i dosjes për zbatimin e kontratës për punë civile si dhe auditimi i objektit në terren, për 1 (një) kontratë e lidhur sa më poshtë vijon:

Auditimi i zbatimit të punëve civile të kontratës së lidhur midis AK Bashkia Tepelenë dhe sipërmarrësit E.C. COMPANY SHPK dhe ST. SHPK, me kontratë nr.1958/1 Prot, datë 18.12.2020 me objekt òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonat dhe òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë.

Të dhëna për:			
Kontratën e zbatimit		Mbikëqyrjen	Kolaudimin
Nr.1958/1	Prot, datë	Afati zbatimit të	kontrata nr.prot.44datë -

18.12.2020	kontratës 180 ditë	11.01.2021	
Vlera e kontratës 125,770,073 lekë me TVSH	Periodha e garancisë së defekteve ó 2 vjet	õIKNõ sh.p.k me nr. licence MK.1019/19 Administrator I. M.	-
Kontraktori E.C. COMPANY SHPK dhe ST.SHPK	Punimet kanë filluar me datë 16.04.2021 Punimet kanë përfunduar 07.12.2021	Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 2,106,052.8 lekë me TVSH.	-

Titulli i Gjetjes 1:	Nuk është realizuar kolaudimi i objektit
Situata:	Nga auditimi i objektit õRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellsit në fshatin Progonatõ dhe õRikonstruksioni i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellsit në fshatin Sinanaj,Dhëmblan,Bashkia Tepelenë nuk është realizuar kolaudimi i objektit.
Kriteri:	Në kundërshtim me ligjin 8402 datë 10.09.1998 neni 12 ku citohet: õTë gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuar janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve. Kolaudimi i objektit kryhet nga kolaudatori që është person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i pajisur me licencë përkatëse për kolaudim punimesh dhe që nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit të objektit që do të kolaudojë. Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t'ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rrethëve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit. Investitori do të përcaktojë afatet e zgjatjes së procesit të kolaudimit. Kur nuk ka investitor, dhe ndërtuesi ndërton për llogari të tij, ai është i detyruar të kërkojë brenda 30 ditëve nga autoriteti perkates i planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit një listë me disa emra kolaudatorësh të licencuar sipas paragrafit 2 të këtij neni dhe të zgjedhë njërin prej tyreõ.
Ndikimi/Efekti:	Moskryerja e kolaudimit të objektit nga persona fizik apo juridik të pajisur me licencë përkatëse vë në diskutim saktësinë dhe korrektësinë e zbatimit të projektit dhe zbatueshmërinë e kontratës mes dy palëve,investitorit dhe sipërmarrësit.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e investitorit,Bashkia Tepelenë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga ana e Bashkisë Tepelenë të merren masa menjëherë për fillimin dhe vazhdimësinë e procedurës së kolaudimit të investimit me objekt õRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellsit në fshatin Progonatõ dhe õRikonstruksioni i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellsit në fshatin

	Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë, me qëllimin final marrjen në dorëzim dhe shfrytëzimin e këtij objekti jetik për komunitetin, me cilësi dhe në afatin e përcaktuar.
--	--

Titulli i Gjetjes 2:	“Rrethim i përhershëm me kollona beton-arme me rrjeta teli” dhe “F.V dyer metalike me llamarinë të zezë” nuk është realizuar si punim i situacionuar.
Situata:	Zëri Analizë, Ndërtim kaptazhi në burimin nr.1 me nr.3837 òRrethim i përhershëm me kollona beton-arme me rrjeta teli në sasinë 176 m2 dhe vlerën 277,100 lekë si dhe zëri 2.390/1 F.V dyer metalike me llamarinë të zezë 27.75 kg/m2 me vlerë 9720 lekë nuk është realizuar si punim i situacionuar. Kjo në vlerë është në shumën 286,820 lekë.
Kriteri:	Ligji nr.8402 datë 10.09.1988 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12 Udhëzimi nr.3 datë 15.02.2001 òPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim, Kreu 2 pika 3. Kontratën e sipërmarrjes së punimeve më nr.1958/1 datë 18.12.2020 Kontratën me mbikëqyrjen me nr.44 datë 11.01.2021
Ndikimi/Efekti:	Vlera prej 286,820 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Tepelenë.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit të punimeve.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 286,820 lekë pa TVSH nga BOE òB.-I.ò SHPK, òE.C. COMPANYò SHPK dhe òST.ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit sipas kontratës nr.1958/1, datë 18.12.2020, me objekt òRikonstrksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellsit në fshatin Progonat dhe òRikonstruksioni i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellsit në fshatin Sinanaj, Dhëmban, Bashkia Tepelenë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Titulli i Gjetjes 3:	Depo e re me V=100m3 me nr.An 2.133/1 “Mur b/a M 250”
Situata:	Për zërin Depo e re me V=100m3 me nr.An 2.133/1 òMur b/a M 250ò nga studimi i projektit dhe librezës së masave si dhe gjëndjes faktike në terren konstatohet se: Muret e depos kanë përmasa 9.5m*5.2m dhe lartësi 3.3m. Si dhe ambjenti ndihmës 2.8m*3.2m dhe lartësi 2.4m që është ngjitur me depon. Nga llogaritjet e vëllimit të betonit rezulton se 23.24m3 beton për ndërtimi e depos. Është situacionuar 28.5 m3 beton. Diferenca 28.5m3-23.24m3=5.26m3*15,000lekë/m=78,900 lekë
Kriteri:	Ligji nr.8402 datë 10.09.1988 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, i ndryshuar, Kreu 3, neni 7 dhe neni 12 Udhëzimi nr.3 datë 15.02.2001 òPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim, Kreu 2 pika 3.

	Kontratën e sipërmarrjes së punimeve më nr.1958/1 datë 18.12.2020 Kontratën me mbikëqyrjen me nr.44 datë 11.01.2021
Ndikimi/Efekti:	Vlera prej 78,900 lekë përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Tepelenë.
Shkaku:	Llogaritje e gabuar e volumeve të cilat janë situacionuar.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Nga ana e mbikëqyrësit të merren masa për të tu kontrolluar cdo zë pune i situacionuar duke e ballafaquar atë me gjendjen faktike në terren.

Për sa është trajtuar më lart (pika II.2.5, të Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 6 datë 13.05.2022, protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr. 484/7, datë 13.05.2022. Mbi këtë Akt konstatimi është paraqitur observacioni me shkresën nr. 484/16, datë 27.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 261/4, datë 30.05.2022, të cilat janë trajtuar në PRA. Mbi PRA, nuk janë paraqitur observacione.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Mbikëqyrësi i punimeve, I.K.N. SH.P.K me nr. licence MK.1019/19 Administrator I. M.

II.2.5. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Për auditimin e kësaj pike të Programit të Auditimit, Grupi i auditimit është bazuar në ligjin 154/2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Manualin e Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve, si dhe Regjistrin Institucional të Zbatimit të rekomandimeve, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 67, datë 23.06.2020.

Dokumentacioni i kërkuar dhe vënë në dispozicion nga subjekti:

- Shkresa përcjellëse e KLSH-së nr. 363/8, datë 14.10.2021 òDërgim Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet, për auditimin e ushtruar në Bashkinë Tepelenë;
- Raporti Përfundimtar i Auditimit të mëparshëm të KLSH-së;
- Urdhri i Kryetarit të Bashkisë Tepelenë nr. 135, datë 29.10.2021 òPër zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së;
- Plan veprimi nr. 2178, datë 11.11.2021

II.2.5.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, germa j òhartimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit, bashkia Tepelenë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 363/8 datë 14.10.2021 ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 517/22 prot, datë 01.11.2021, brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes brenda 20 ditësh. Bashkia Tepelenë ka hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit dhe kryetari, me përgjegjësinë dhe cilësinë e titullarit të Njësisë Vendore, Bashkia Tepelenë nëpërmjet deklaratës ka konfirmuar njohjen me Raportin e auditimit.

II.2.5.2. Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

Titulli i gjetjes:	Mbi zbatimin e plan-veprimit dhe raportimin në KLSH (6- Muaj)
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 363/8, datë 14.10.2021, i ka dërguar Bashkisë Tepelenë, Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Shkresën përcjellëse me rekomandimet e lëna. Sipas ligjit nr. 154/2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Bashkia Tepelenë duhet të raportojë me shkrim mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve brenda 6-muajsh nga marrja e Raportit të Auditimit dhe Shkresës përcjellëse mbi rekomandimet e lëna. Nga auditimi ka rezultuar se nga ana e Bashkisë Tepelenë nuk është zbatuar ky detyrim ligjor, pasi nuk ka raportuar me shkrim në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.
Kriteri:	Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 30 òRekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimitò, ku cilësohet: 1. Në raportet e tij, Kontrolli i Lartë i Shtetit jep rekomandime në përputhje me nenin 15 të këtij ligji. 2. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.
Impakti:	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve.
Shkaku:	Mosveprim nga ana e Titullarit të Bashkisë Tepelenë.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Do të ri kërkohet zbatimi i rekomandimeve, si dhe dërgimi i informacionit në KLSH brenda afateve ligjore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Titullari i Bashkisë Tepelenë z. T.P., i cili nuk ka realizuar detyrimin ligjor në lidhje me raportimin mbi zbatimin e rekomandimeve në Këshillin Bashkiak.

II.2.5.3. Mbi raportimin periodik në Këshillin Bashkiak mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

Titulli i gjetjes:	Mbi raportimet e subjektit Bashkia Tepelenë në KB
Situata:	Nga auditimi rezultoi se nga Bashkia Tepelenë, nuk ka raportime në Këshillin Bashkiak mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i jashtëm (KLSH), referuar ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò.
Kriteri:	Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 50, pika 5, ku cilësohet: òPër të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tijò.
Impakti:	Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve.
Shkaku:	Mosveprim nga ana e Titullarit të Bashkisë Tepelenë.

Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe rekomandimeve të lëna nga KLSH,.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Titullari i Bashkisë Tepelenë z. T.P., i cili nuk ka realizuar detyrimin ligjor në lidhje me raportimin mbi zbatimin e rekomandimeve në Këshillin Bashkiak.

Për sa është trajtuar më lart (pika 4.1; 4.2; 4.3, të Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 4 datë 06.05.2022, protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr. 484/5, datë 06.05.2022. Mbi këtë Aktkonstatimi nuk është paraqitur observacion.

II.2.5.4. Mbi statusin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Tabela nr. 1 “Përmbledhëse e zbatimit të rekomandimeve”

Lloji i rekomandimeve	Rekomandime të dhëna	Pranuar				Pa pranuar
		Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar	
Masa organizative	13	6	1	6	0	0
Masa shpërblim dëmi	3	2		1	0	0
Masa për eliminimin e efekteve negative	7	2		5	0	0
Masa disiplinore	9			9	0	0
	32	10	1	21	0	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë

Punoi: KLSH

Nga auditimi i statusit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm, duke marrë në konsideratë dhe rezultatet e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve nga KLSH sipas Programit të Auditimit të mëparshëm, niveli i zbatimit të tyre paraqitet:

Titulli i gjetjes: Mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve

Situata 1: “Masa organizative”:

Nga auditimi i mëparshëm janë rekomanduar 13 masa organizative, si rezultat i auditimit të kryer më parë.

Nga auditimi mbi realizimin e tyre ka rezultuar se, Bashkia Tepelenë, nga 13 masa organizative ka pranuar plotësisht masat e rekomanduara, pasi nuk është dërguar në KLSH, asnjë informacion për kundërshtim të tyre, si dhe nuk është paraqitur asnjë argument ligjor, shkresor apo verbal për mospranim të tyre edhe gjatë procesit auditues në terren.

Nga auditimi ka rezultuar se janë zbatuar plotësisht 6 masa; është zbatuar pjesërisht 1 masë; janë në proces zbatimi 6 masa.

Situata 2: “Masa për shpërblim dëmi”:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit nëneni 15 germa (b) dhe (c) të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për vetëqeverisjen vendore dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat

e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **4,934,957 lekë**. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 4,934,957 lekë, si më poshtë:

Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Tepelenë, nga 3 masa shpërblim të dëmit ekonomik në vlerën 4,934,957 lekë, të pranuar dhe për të cilat kanë dalë njoftimet nga Titullari, janë kontabilizuar, është arkëtuar vlera 534,957 lekë dhe nuk është arkëtuar vlera 4,400,000 lekë. Nga auditimi ka rezultuar se për vlerën e mos arkëtuar i janë nisur njoftimet subjekteve në lidhje me detyrimet e tyre.

Tabela nr. “Përmbledhëse mbi zbatimin e masës shpërblim dëmi ekonomik”

Nr.	Emërtimi	Dëmi në vlerë/lekë
1	Rekomanduar për shpërblim dëmi ekonomik	4,934,957
2	Pranuar për shpërblim vlera	4,934,957
3	Nxjerrë njoftimet nga titullari për vlerën	4,934,957
4	Kontabilizuar vlera	4,934,957
5	Arkëtuar vlera	534,957

Burimi i të dhënave: Bashkia Tepelenë/KLSH

Punoi: KLSH

Situata 3:

“Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficensë dhe efektivitet të fondeve publike”:

Nga auditimi i mëparshëm janë rekomanduar 7 ÷Masa 3Eö, si rezultat i auditimit të kryer.

Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Tepelenë, nga 7 masa për eliminimin e efekteve negative ka pranuar plotësisht masat e rekomanduara, pasi nuk është dërguar në KLSH, asnjë informacion për kundërshtim të tyre, si dhe nuk është paraqitur asnjë argument ligjor, shkresor apo verbal për mospranim të tyre edhe gjatë procesit auditues në terren.

Nga auditimi ka rezultuar se janë zbatuar plotësisht 2 masa dhe janë në proces zbatimi 5 masa.

Situata 4:

“Masa disiplinore”:

Për shkeljet e konstatuara në auditimin e mëparshëm, janë dhënë masa disiplinore dhe administrative për t’u zbatuar nga strukturat përkatëse të ngarkuara me ligj.

Nga auditimi ka rezultuar se nga 9 masa disiplinore të rekomanduara nga KLSH, janë pranuar 9 masa dhe janë në proces zbatimi 9 masa disiplinore.

Kriteri:

Ligji nr. 154/2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e KLSHö neni 30 ÷Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimitö, ku cilësohet:

1. Në raportet e tij, Kontrolli i Lartë i Shtetit jep rekomandime në përputhje me nenin 15 të këtij ligji.

2. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ÷Për financat e vetëqeverisjes vendoreö, neni 50, pika 5, ku cilësohet: ÷Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tijö.

- Impakti:** Mos shqyrtimi dhe moszbatimi i masave të rekomanduara në KLSH, sjell pasoja për subjektet. Moszbatimi i tyre çon në përsëritjen e të njëjtave shkelje dhe mos përmirësim të situatës.
- Shkaku:** Neglizhencë e subjekteve të cilët edhe pas njoftimeve nga Titullari në lidhje me detyrimet e tyre nuk kanë paguar detyrimet e tyre.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandimi:** Do të ri kërkohet zbatimi i të gjitha rekomandime të cilat nuk janë zbatuar.

Konkluzion mbi pikën II.2.5.4. Bashkia Tepelenë, përsa i përket zbatimit të rekomandimeve në përgjithësi paraqitet në nivele të kënaqshme, pasi janë pranuar të gjitha rekomandimet, si dhe nuk ka asnjë masë për të cilën nuk ka filluar zbatimi i saj, por duhet të ndiqet më tej ecuria, sidomos për masat me efekte financiare. Masa shpërbllim dëmi, ku kanë dalë njoftimet nga Titullari i Institucionit, por nga e gjithë shumica e rekomanduar për shpërbllim rezultoi se, është kontabilizuar dhe është arkëtuar vlera 534,957 lekë, duke përjashtuar këtu vetëm vlerën e detyrimeve të subjekteve që tregojnë karburant.

Për sa është trajtuar më lart (pika 4.4 e Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 5 datë 06.05.2022, protokolluar në Bashkinë Tepelenë me protokoll nr. 484/6, datë 06.05.2022. Mbi këtë Aktkonstatimi dhe pjesën takuese në PRA, nuk janë paraqitur observacione.

II.2.6 (Mbi auditimin e zbatimit e kërkesave të ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” Bashkia Tepelenë.)

Në zbatim të pikës 6, të programit të auditimit nr. 261/1 datë 13.05.2022, Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit, Lista e lejeve me sipërfaqe mbi 250 m² është sipas tabelës mëposhtë, ku u shqyrtua dokumentacioni i dosjeve në sistem dhe rezultoi sa më poshtë vijon:

Nr.	Ndërtesë akomoduese në funksion të turizmit dhe argotizmit	Z. P. H. L.
1	Resort agroturistik, Peshtanë.	0Z0 SHPK me NIPT L8í í .10
2	Bujtinë 2 kate + 1 kat nëntokë.	0G-AL 20190 SHPK me NIPT L9í í 1A
3	Thertore rajonale 0I.0, Tepelenë	I. SHPK, NIPT L9í í 1E
4	Stallë lopësh	Fermer F. H.
5	Strukture akomoduese në funksion të turizmit	E. Z.
6	Rikonstruksion dhe shtese kati	A. M.

Në total janë 7 leje ndërtimi të lëshuara nga Bashkia Tepelenë për periudhën 2021-2022 me sipërfaqe mbi 250 m², nga të cilat janë përgjedhur për t'u audituar 3 leje ndërtimi, bazuar mbi analizën e rrishtit si objekte mbi 250 m² dhe problematikat që janë konstatuar janë si më poshtë vijon.

Leja e ndërtimit me objekt: 0Ndërtesë akomoduese në funksion të turizmit dhe agroturizmit me zhvillues P. L., në Tepelenë. Aplikimi për leje është bërë në datë 10/08/2021.

Titulli i Gjetjes 1:	Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese
Situata:	Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se planvendosja nuk përmban të gjitha detajet e nevojshme.
Kriteri:	VKM nr. 408, datë 13.05.2015 neni 15 pika c Plani i vendosjes së

	ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuesesi dhe Kushtet Teknike të Projektimit KTP.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e të disa prej elementëve të nevojshëm tek planvendosja si numri i kateve të objekteve kufitare përbën risk në mosrespektim të distancave të lejuara nga objektet e tjera përreth.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Tepelenë
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Nga DPKZHT të merren masa për të mos pranuar nga aplikuesit për leje ndërtimi planvendosje pa të gjithë elementet e nevojshëm.

Leja e ndërtimit me objekt: ÷Strukturë hoteleri turizëm dhe shërbime 1k,3k,4k me 1-3 kate nëntokë ÷ me zhvillues ÷Z.÷ SHPK, në Peshtan, Tepelenë.
Leja e ndërtimit është miratuar në datë 10/ 06/ 2021.

Leja e ndërtimit me objekt: ÷BUJTINË 2 KATE + 1 KAT NËNTOKË,me zhvillues ÷G.-A. 2019÷ sh.p.k, adresë fshati Dukaj, Bashkia Tepelenë.

Titulli i Gjetjes 2:	Mungon Vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi sipas VKM nr.1162, datë 24.12.2020
Situata:	Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mungon Vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi i cili përfshin studimin gjeologjik,sizmik,kundër rrezatimit,studimin hidrik të zonave ku do ndërtohet.
Kriteri:	Vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi sipas VKM nr.1162, datë 24.12.2020, ÷Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve të cilat kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ leje ndërtimi÷.
Ndikimi/Efekti:	Lëshimi i lejeve të ndërtimit pa u pajisur me Vërtetim për Riskun rrezikon të lejohen ndërtime në zona të cilat sipas studimeve gjeologjike,sizmike,hidrike apo rrezatimit mund të jenë të zona jo të përshtatshme për tu zhvilluar.
Shkaku:	Mund të jenë zona me sizmicitet të lartë,formacione toke jo të qëndrueshme,zona me rrezatim të lartë,zona të rrezikuara nga përmytjet etj..
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Nga DPZHT Bashkia Tepelenë të merren masa mos të lëshohen leje ndërtimi pa u pajisur fillimisht me Vërtetim për Riskun.

Leja e ndërtimit me objekt: ÷Strukturë hoteleri turizëm dhe shërbime 1k,3k,4k me 1-3 kate nëntokë ÷ me zhvillues ÷Z.÷ SHPK, në Peshtan, Tepelenë.
Leja e ndërtimit është miratuar në datë 10/ 06/ 2021.

Leja e ndërtimit me objekt: ÷BUJTINË 2 KATE + 1 KAT NËNTOKË,me zhvillues ÷G.A.2019÷ sh.p.k,adresë fshati Dukaj, Bashkia Tepelenë.

Titulli i Gjetjes 3:	Sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit nën tokë nuk paraqitet.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se mungon e pasqyruar sipërfaqja e

	ndërtimit nën tokë e cila nuk është pasqyruar as në projekt as në planvendosje.
Kriteri:	VKM nr. 408, datë 13.05.2015 neni 15 pika c Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuesesi dhe Kushtet Teknike të Projektimit KTP.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e elementeve të tillë në planvendosje ose projekt përbën risk për lëshim të lejeve jo konform rregullave dhe legjislacionit në fuqi.
Shkaku:	Neglizhencë nga ana e DPKZHT Tepelenë
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Nga DPKZHT të merren masa për të mos pranuar nga aplikuesit për leje ndërtimi planvendosje pa të gjithë elementet e nevojshëm.

Për sa është trajtuar më lart (pika II.2.5, të Programit të auditimit), është mbajtur Akt konstatimi nr. 7 datë 13.05.2022, protokolluar në Bashkinë Tepelenë me nr. 484/8, datë 13.05.2022. Mbi këtë Akt konstatimi është paraqitur observacioni me shkerës nr. 484/17, datë 10.06.2022, protokolluar në KLSH me nr. 261/5, datë 16.06.2022.

Pretendimi i subjektit:

Drejtori i DPKZHT nuk ështëpërfshirë në procedurat e prokurimit, nuk ka dijeni në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillohen, dhe për këtëarsye nuk ka se si të hartojë detyra projektimi.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Përsa është observuar nga Drejtori i Drejtorisë sëPlanifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të territorit, konfirmojmë se pas shqyrtimit të argumenteve të sjella, u rivlerësua konstatimi i grupit të auditimit, i cili për nga përmbajtja nuk do të ketë ndryshim, por përsa i përket përgjegjësisë, observacioni i paraqitur merret në konsideratë dhe është reflketuar në pjesën takuese të Raporti

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Titullari i Bashkisë Tepelenë z. T.P. dhe Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave ka rezultuar se:

a. Për vitin 2020, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore nga 42,500,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 37,591,000 lekë ose 88 % me një diferencë në vlerën 4,909,000 lekë, ku të ardhurat nga taksat nuk janë realizuar në vlerën 4,240,000

lekë, ose 20% të planifikimit, të ardhurat nga tarifatat nuk janë realizuar në vlerën 669,000 lekë, ose 3.4% të planifikimit.

b. Për vitin 2021 të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore nga 52,500,000 lekë të parashikuara, janë realizuar, në vlerën 55,280,000 lekë, ose 105%, por të ardhurat nga taksat mbi ndërtesën nuk janë realizuar në vlerën 3,218,000 lekë, ose 57% të planifikimit, të ardhurat nga tarifatat për ndriçimin nuk janë realizuar në vlerën 667,000 lekë, ose 32%, të ardhurat nga qira kullote nuk janë realizuar në vlerën 3,359,000 lekë ose 60%.

Kjo situatë tregon një nivel të kënaqshëm në vlerë absolute të treguesve të buxhetit, por pamjaftueshmëri të angazhimit të strukturës së tatim taksave në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre, si rrjedhojë e:

-Mungesës së kadastrës fiskale për taksën e pronës (ndërtesë) për shkak të mungesës së burimeve njerëzore apo agjentëve tatimorë pengon vjeljen e taksës familjare.

-Vështirësi haset në vjeljen e taksës së tokës bujqësore ndaj fermerëve për shkak të mos organizimit të duhur të punës për vjeljen e taksës. Kjo sjell të ardhura të munguara nga viti në vit në buxhetin e Bashkisë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.2, faqe 20-41, të Projekt Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, duhet të marrë masa të menjëhershme, për koordinimin e punës midis sektorëve, bashkëpunimin me struktura të tjera si QKB, Drejtoria e Tatimeve Gjyrokastër, Zyrtat e Gjendjes Civile, DRSHTRR, etj. me qëllim:

1. Kryerjen e rakordimeve me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjyrokastër, (në cilësinë e agjentit tatimor) për numrin e subjekteve që duhet të paguajnë, si dhe të ardhurat që ato kanë realizuar brenda një viti ushtrimor, si dhe kryerjen e rakordimeve 6-mujore mbi realizimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;

2. Marrjen e të dhënave mbi bizneset në QKB, që në fazën e planifikimit, mbi numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit ushtrimor mbyllën ose regjistruan, dhe bazën e të dhënave për subjektet, të cilët në bazë të aktivitetit dhe xhiros vjetore, do të jenë objekt për pagesën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin;

3. Marrjen e masave për evidentimin e resurseve, analizimin dhe planifikimin e të ardhurave nga taksat kombëtare;

4. Marrjen e masave për kryerjen e rakordimeve me Zyrën e Gjendjes Civile nga ana e Sektorit të Tatim Taksave Vendore, për të nxjerrë numrin real të familjeve në Bashkinë Tepelenë, si dhe marrjen e masave për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të njoftimit Vlerësimit, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të krijuara nga mos shlyerja e taksave dhe tarifave vendore, rezultoi se detyrimet kundrejt Bashkisë Tepelenë, për shkak të mospagimit të taksave dhe tarifave vendore, në vitin 2022, kanë pësuar një rritje në krahasim me fillimin e periudhës, nga 21,455,168 lekë në 31,886,454 lekë, ndërsa në vitin 2021 këto detyrime paraqiten me ulje nga 31,886,454 lekë në fillim të periudhës në 10,431,286 lekë në fund të periudhës ushtrimore 2022.

Nga auditimi mbi marrjen e masave shtrënguese për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, nga bizneset, nga ana e zyrës së planifikimit të të ardhurave, pas njoftimit për bllokim llogarish bankare, nuk kanë vazhduar më tej procedurat për të dërguar shkresa për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për vendosjen e

barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Gjithashtu, nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 04.12.2014.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.2, faqe 20-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Tepelenë të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **31.886.454 lekë**, dhe të ndjek veprimet e mëposhtme:

-Të vazhdoj më tej procedurat për të dërguar shkresa për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

-Gjithashtu për të vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve dhe në kallëzim penal sipas kërkesave të nenit 89,90,91 dhe 93, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 për Procedurat tatimore në R.SHö ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

Brenda muajit Dhjetor 2022

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, Bashkia Tepelenë në cilësinë e palës qiradhënëse të aseteve në pronësi të saj, nuk ka miratuar programe pune për monitorim nga njësia e inspektimit në terren, lidhur me zbatimin e termave kontraktore si: mbjelljet e kulturave sipas llojit të përcaktuar në planet e biznesit dhe respektimit të afatit kohor të mbjelljeve, shoqëruar me kontrollin e shlyerjes së detyrimeve financiare për secilën kontratë.

Gjithashtu, Bashkia Tepelenë nuk ka aplikuar në asnjë nga rastet e 31 kontratave efektive penalitetet e mos respektimit të termave kontraktor, si dhe nuk ka dërguar asnjë njoftim të zgjidhjes së njëanshme të kontratës së qiradhënies së aseteve në pronësi të saj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.2, faqe 20-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa për të miratuar programe pune për kryerjen e monitorimeve nga njësia e inspektimit në terren lidhur me zbatimin e termave kontraktor si: mbjelljet e kulturave sipas llojit të përcaktuar në planet e biznesit dhe respektimit të afatit kohorë të mbjelljeve shoqëruar me kontrollin e shlyerjes së detyrimeve financiare për secilën kontratë.

-Bashkia Tepelenë në rastet e dhënies me qira të aseteve të aplikoj në kontratë në mënyrë eksplicite penalitetet e mos respektimit të termave kontraktor nga palët.

-Në rastet e mos respektimit të termave kontraktual, Bashkia Tepelenë të dërgojë njoftim të zgjidhjes së njëanshme të kontratës së qiradhënies së aseteve në pronësi të saj.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, të zhvilluara në vitin 2020 dhe 2021, mbi plotësimin e dokumentacionit specifik të kontratave të punëve publike, pjesë e dosjes së tenderit, u konstatua se nga Bashkia Tepelenë, nuk është hartuar Detyra e projektimit për objektin "Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonat dhe Rikonstruksion i rrjetit të jashtëm

dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmbjan, Bashkia Tepelenë". Ky fakt është konsideruar mangësi, pasi hartimi i detyrës së projektimit është hapi i parë dhe dokumentacioni që tregon parametrat fillestar dhe termat e referencës për të zbatuar projektin, si dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914/2014, neni 38 "Konkursi i projektimit", pika 2/a dhe Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", neni 23 "Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike", pika 14. Mungesa e detyrës së projektimit është cilësuar edhe në raportin mbi oponencën teknike të paraqitur nga Instituti i Ndërtimit, mbi këtë objekt. Realizimi i projektit është kryer nga studio projektimi, e cila duhet të bazohet dhe zbatohet detyrën e projektimit të dhënë paraprakisht.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.4, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandim: Titullari Bashkisë Tepelenë, në cilësinë edhe të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, duhet të marrë masa që në të ardhmen, të nxjerrë urdhra të specifikuar për Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, me qëllim hartimin e detyrave të projektimit si dhe në rast të mungesave të burimeve njerëzore, duhet të marrë masa për kryerjen e këtij shërbimi nga të tretë, me qëllim vënien e tyre në dispozicion të projektuesve.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit, të zhvilluara në vitin 2020, mbi sigurimin e oponencës teknike, për objektet e përcaktuara në Ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 6, dhe VKM nr.1055, datë 22.12.2010 "Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit", pika 3, ka rezultuar se:

- Për procedurën, me objekt òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Progonatò dhe òRikonstruksion i rrjetit të jashtëm dhe të brendshëm të ujësjellësit në fshatin Sinanaj, Dhëmbjan, Bashkia Tepelenë, me vlerë kontrate 105,375,894 lekë pa TVSH, oponenca teknike e kërkuar nga AK, në cilësinë e investitorit, me shkresën nr. 2979, datë 29.12.2020 dhe e realizuar nga Instituti i Ndërtimit bazuar në Aktmarrëveshjen nr. 2033/1, datë 23.12.2020, nuk është kryer në kohën e duhur dhe në funksion të asaj ç'ka kërkon ligji dhe VKM. Kërkesa për marrjen e këtij shërbimi nga Bashkia Tepelenë, është përtej afateve kohore, duke shkaktuar përdorim pa efektivitet të fondeve, në masën e pagesës së këtij shërbimi.
- Nga Bashkia Tepelenë, nuk është kërkuar oponencë teknike për 4 objekte gjatë vitit 2021, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 120/2020 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8402/1998 òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 6, si dhe po sipas përcaktimeve të këtij ligji neni 15, ndaj subjekteve aplikohet penalitet, i cili sjell përdorim pa efektivitet të fondeve buxhetore të Bashkisë Tepelenë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.4, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë, të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësi, si dhe me qëllim shmangien e rasteve të tilla, të marrë masa për hartimin e gjurmës së auditimit/hartës së proceseve, për òPërcaktimin dhe miratimin e procedurave mbi marrjen e oponencave teknike ò për objektet që do të ndërtohen në vazhdimësi, ku të përcaktohen qartë, strukturat përgjegjëse, grupet apo specialistët përkatës që do të kryejnë këtë proces, si dhe të përcaktohen qartë periudha kohore mbi kërkesën dhe marrjen e këtij shërbimi, nga të tretët.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, në lidhje me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Tepelenë, pasi u vlerësuan 5 komponentët, bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin me ndryshime, bazuar në nenin 20 për Mjedisi i kontrollit; nenin 21 për Menaxhimi i riskut, nenin 22 për Aktivitetet e kontrollit, nenin 23 për Informimi dhe komunikimi dhe nenin 24 për Monitorimi, rezultuan këto mangësi:

Komponenti 1. "Mjedisi i kontrollit"

- Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), për vitin 2020 dhe 2021, nuk ka kryer takimet periodike, për rishikim të risqeve, menaxhim të aktiveve, si dhe analizën mbi arritjen e objektivave.
- Nuk janë miratuar procedura dhe mekanizma, të cilat ju dedikohen ankesave për korrupsion, si dhe nuk ka procedura mbi sinjalizuesit dhe mbrojtjen e tyre.
- Njësi nuk ka nja program trajnimi të dedikuar për integritetin dhe sjelljen etike.
- Nuk ka plan monitorimi për objektivat strategjike.

Komponenti 2. Menaxhimi i riskut"

- Nuk është hartuar Regjistri i riskut në nivel institucional, për vitin 2020 dhe 2021 për pasojë, nuk është kryer asnjë proces tjetër pasues.
- Titullari në cilësinë e NA, as nuk e ka kryer funksionin e koordinatorit të riskut, si dhe as nuk e ka deleguar këtë funksion tek një zyrtar i nivelit të lartë drejtues.
- Nuk është mbledhur GMS për caktimin e nivelit të lejueshëm të riskut, si dhe për shqyrtim dhe rishikim të riskut.

Komponenti 3. Aktivitetet e kontrollit:

- Nuk ka rregulla të miratuara për komunikimin elektronik, apo sisteme të ndryshme online edhe për faktin se nuk ka ecuri në lidhje me përdorimin e teknologjisë së informacionit në ushtrimin e veprimtarisë.
- Nuk ka gjurmë auditimi dhe hartë procesesh (Aneksi nr.3 dhe nr.4 i Manualit) për të gjitha aktivitet kryesore të Bashkisë, si një masë parandaluese dhe minimizuese të risqeve të cilat mund të cenojnë arritjen e objektivave institucionalë. Harta e proceseve të punës është paraqitur vetëm për procedurat e prokurimit në vlerë të vogël, ndërsa nga strukturat e tjera të Bashkisë Tepelenë, nuk është hartuar harta e proceseve të punës, nga ku të përshkruhen dhe dokumentohen me hollësi: - procesi, nën proceset, objektivi i procesit, struktura përgjegjëse, përshkrimi i procesit, njësitë dhe strukturat që përfshihen në proces, kuadri ligjor dhe afati kohor (sipas aneksit 2 Manuali i proceseve të punës).
- Nuk janë përcaktuar dhe miratuar gjurmët e auditimit për procedurat dhe operacionet e njësisë, sipas përcaktimeve në Manualin e MFK. Mos përcaktimi i hartës së proceseve dhe gjurmës së auditimit është në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK dhe Manualin në zbatim të tij dhe është përgjegjësi e titullarit, pasi është personi përgjegjës që duhet të urdhërojë përgatitjen e gjurmës së auditimit nga strukturat organizative që janë përfshirë në proces.

Komponenti 4: Informacioni dhe komunikimi.

- Përsa i përket komunikimit të brendshëm, nuk janë identifikuar, hartuar dhe miratuar llojet e raportimit brenda strukturave të bashkisë, në funksion të monitorimit të realizimit të objektivave strategjike dhe vjetorë, të përcaktuara në planet përkatëse.

Komponenti 5 "Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm"

- Sistemet e raportimit, nuk janë monitoruar nga grupi për menaxhimin e çështjeve të riskut të brendshëm.
- Gjithashtu, nga Auditimi i Brendshëm, nuk është audituar në drejtim të monitorimit të riskut si një prej dy metodave kryesore të këtij procesi, si dhe nuk janë vendosur rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku të specifikohet periodiciteti i verifikimit të këtyre sistemeve, si dhe procedurat për marrjen e masave riparuese.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 9-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi

Titullari i Bashkisë, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues dhe Kryetarit të Grupit të Menaxhimit Strategjik, me qëllim përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit dhe specifikisht 5 komponentëve të tij, të marrë masa për:

- Mbledhjen e GMS, të paktën 4 herë në vit, me qëllim identifikimin, monitorimin, rishikimin e risqeve dhe marrjen e masave për minimizimin e tyre, duke hartuar dhe miratuar aktivitete kontrolli shtesë.
- Ngritjen e një grupi pune me qëllim hartimin e gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve, për aktivitetet kryesore të veprimtarisë, ku do të veçonim, identifikimin e subjekteve taksapaguese, përlllogaritjen e detyrimeve, monitorimin dhe vjeljen e tyre.
- Miratimin e formateve dhe informacionit që struktura të ndryshme të Bashkisë, duhet të përgatisin dhe raportojnë, në lidhje me përmbushjen e objektivave strategjikë dhe vjetorë, ku të jetë përcaktuar: lënda, indikatorë të matshëm, afatet, strukturat përgjegjëse, realizuese dhe monitoruese.
- Vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet kontrollit drejtues dhe menaxherial, si kontroll parandalues, si dhe nëpërmjet strukturës së Auditit të Brendshëm në Bashki, si kontroll pas faktit.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga Grupi i auditimit u vlerësua veprimtaria e Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Tepelenë, bazuar në Ligjin nr. Ligjin nr. 114/2014, 22.10.2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, i ndryshuar; Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, etj., ku rezultuan mangësitë e mëposhtme:

- Mbi dokumentacionin e dosjeve provizore dhe të përhershme të auditimit, u evidentua se nuk ka gjurmë mbi kundërshtitë dhe qasjen e subjektit të audituar kundrejt gjetjeve dhe rekomandimeve të auditit; Mungon Procesverbali i takimit përmbyllës; Mungon Plani i veprimit dhe programi i masave për zbatim të rekomandimeve, sipas modelit të përcaktuar në MAB, Formati nr.10 "Model plan veprimi i plotësuar nga grupi i auditimit dhe subjekti i audituar", si dhe janë mbajtur akt konstatime dhe procesverbale, dokumente të cilat nuk cilësohen të nevojshme në dokumentacionin e dosjes së auditit të brendshëm.
- Në vlerësim të raportimit që Njësia e Auditit të Brendshëm, bën në Drejtorinë e Harmonizimit të Brendshëm në MFE dhe konstatimeve të rezultuara, nga shqyrtimi i dosjeve dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, u evidentuan se ka raportime të bërë në këtë strukturë, të cilat nuk janë të mbështetura, të argumentuara dhe të sakta.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 9-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandim: Titullari i Bashkisë Tepelenë dhe Sektori i Auditit të Brendshëm, duhet të marrin masa që në të ardhmen të korrigjojë mangësitë e mësipërme, si dhe të raportojë në mënyrë të saktë dhe transparente, mbi aktivitetin vjetor, në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të lidhura nga Bashkia Tepelenë dhe subjekteve private, me objekt dhënien me qira të aseteve të Bashkisë Tepelenë, ka rezultuar se:

-Formulimi i kontratave të qirasë me këto subjekte, në disa raste, vendos në kushte të pafavorshme qiradhënësin (bashkia) në raport me qiramarrësin, duke mos përcaktuar qartë kushtet kontraktuale, dhe penalitetet në rastet kur shkelet ajo nga qiramarrësi.

-Kontratat e qirasë të lidhura me subjektet qiramarrëse të aseteve pronë e bashkisë, në 7 raste nuk kanë parashikuar si klauzolë aplikimin e kamatë vonesës apo penalitetet, në rastet e mos pagimit në afat të qerasë, si dhe në 4 raste nuk kanë parashikuar zgjidhjen e njëanshme të kontratës në rastin e shkeljes së afatit të shlyerjes së qerasë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.2, faqe 21-40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të kontratave me objekt qiradhënien e aseteve, me qëllim sigurimin e zbatimit të këtyre kontratave si dhe sigurimin e vjeljes së të ardhurave të programuara nga ky zë i të ardhurave vendore.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tepelenë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 05.01.2021 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjiellës Kanalizime Tepelenë SHA me NUIS òK29009502Gò e cila është shoqëri aksionere me objekt aktiviteti òShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyreò. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqiò. Numri i aksioneve është 1,00 me vlerë nominale 510,086,359 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 510,086,359 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Tepelenë në òUjësjiellës Kanalizime Tepelenë SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2021, më konkretisht në llogarinë 26 òPjesëmarrje në kapitalet e vetaò që përfaqëson aksionet me vlerë kontabël (kosto) 510,086,359 lekë dhe investitori është Bashkia Tepelenë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 40-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues, në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, të përfshihet sistemimi në kontabilitet, mbi regjistrimin e pjesëmarrjes, sipas përqindjes së përcaktuar në aktet ligjore, në kapitalin aksionar të òUjësjiellës Kanalizime Tepelenëò SHA, me vlerë kontabël 510,086,359 lekë.

Me mbylljen e Pasqyrave financiare të vitit 2022

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga objektet inventari të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 391,047,353 lekë, objektet nuk janë

pajisur me titull pronësie, nuk janë regjistruar në hipotekë, konkretisht sipas llogarive paraqiten si më poshtë:

- llog. 210 òToka troje terreneo, 9 elementë në vlerën neto 74,573,778 lekë
- llog. 211 òPyje plantacioneo, 2 elementë në vlerën neto 196,200 lekë,
- llog. 212 òNdërtesa e konstruksioneo, 77 objekte me vlerën neto 316,277,375 lekë
- llog. 213 òRrugë, rrjete, vepra ujoreo, 85 objekte me vlerë neto 727,482,471 lekë

Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 òPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorialo, Kreu VI òTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshmeo dhe VKM nr.433, datë 08.06.2016 òPër transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkiveo.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 40-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë të marrë masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së Aktiveve Afatgjata Materiale për llogari të Bashkisë Tepelenë.

Menjëherë

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e ofertave ka rezultuar se në 3 procedura prokurimit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) ka kualifikuar, Operatorët Ekonomikë (OE), të cilët kanë paraqitur ofertë ekonomike anomalisht të ulët. KVO, nuk e ka identifikuar këtë fakt, nuk ka kërkuar sqarime nga OE, si dhe nuk ka lënë gjurmë në procesverbalin përkatës, duke vepruar në kundërshtim me VKM nr. 285/2021, nenin 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që gjatë zbatimit të këtyre kontratave, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, të ndjekë me rigorozitet zbatimin e tyre, me qëllim shmangien e problematikave eventuale si në zbatimin e afateve, po ashtu dhe të cilësisë së punimeve.

Në vijimësi përgjatë zbatimit të kontratave

12. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i Procesverbaleve, në të gjitha procedurat e audituara, është evidentuar se nga Njësia e Prokurimit, nuk janë dhënë argumente të mjaftueshme, mbi përcaktimin e kërkesave që duhet të plotësojnë OE, në përmbushje të kriterëve, veçanërisht atyre teknike.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të dosjeve të prokurimit është evidentuar se në të gjitha rastet, ka patur ndërhyrje nga procesi i monitorimit të APP, ku tërhiqet vëmendje dhe rekomandohet që Autoriteti Kontraktor (AK), Bashkia Tepelenë, duhet të argumentojë kërkesat e vendosura, si dhe duhet ti përcaktojë ato në raport me objektin dhe madhësinë e kontratës, pasi vendosja e kriterëve jo të përshtatshme, sjell kufizim

të operatorëve ekonomikë në garë. Në lidhje me raportet e monitorimit të APP-së duhet të evidentojmë faktin se për shqyrtimin e tyre, AK ka zbatuar procedurat e përcaktuara, por në lidhje me pranimin e vërejtjeve dhe propozimeve të APP-së, cilësojmë se jo në të gjitha rastet janë pranuar rekomandimet e APP-së, si dhe jo në të gjitha rastet janë dhënë argumentet e duhura nga NJP, për moszbatim të tyre. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 për prokurimet publike, neni 77, pika 1 dhe VKM nr. 285/2021, neni 78.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 54-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

